

Revistë edukative-kulturore

ETIKA

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den
Europa: 2 Euro

Shtator 2010 • Numri: 30 • E përmuajshme



Dituria
dhe **EDUKATA**

EDITORIAL

Orientimi drejt një jete fetare në të cilën është shmangur dimensionin e diturisë, lind fanatikë të verbër, ndërsa orientimi drejt diturisë së thatë, në të cilën anashkalohet dimensionin e dashurisë, lind besimin e pashpirt. Asnjëra prej këtyre të dyjave nuk është ajo që kërkohet: as interesi injorant i privuar nga dituria, as dituria e thatë e privuar nga dashuria dhe emocioni. Ajo që vlen me të vërtetë është formimi i një personaliteti dhe identiteti të fuqishëm Islam, ku zë vend edhe dashuria, edhe dituria, sepse feja nuk është një kauzë që i sjell lumturinë dhe rehatinë lëkurës dhe trupit, por përkundrazi, e bën shpirtin dhe thellësitë e tij mbizotërues ndaj trupit dhe jetës. Gjithashtu, duke lexuar librin e Gjithësisë, duhet të shohësh veprën e Krijuesit të Madhëruar tek krijesat dhe t'i duash krijesat për hir të Krijuesit.

Gjatë gjithë historisë njerëzore, ata që kanë fituar zemrat e njerëzve janë ata që u kanë folur zemrave. Këtë të vërtetë, Mevlana e shpreh kështu: *"Fryma ime ka ndezur shumë shpirtin në këtë botë, por fjalët e mia të vdekshme nuk kanë arritur në veshin e askujt. Veshët mund të kuptojnë vetëm sipërfaqen e fjalëve të mia, po kush do t'i kuptojë vajtimet që shkëputen dhe dalin nga shpirti im?"*

"Shekuj pas meje, këto fjalë do të bëhen të famshme si tregimi i Jusufit, sepse zemra nuk kalbet nën tokë. Dhe unë këtë e thashë nga shpirti dhe jo nga një copë mishi si mëlçia."

Edukata shpirtërore dhe fetare i shpëton njerëzit nga injoranca dhe i mbart ata në dritën e dijes. Kjo edukatë i bën të kryejnë vepra me të cilat do të fitonin lumturinë e botës tjetër, duke i orientuar njerëzit drejt së mirës, së bukurës dhe qëllimeve të drejta, duke i rregulluar rregullat e duhura dhe duke hequr nga rruga arsyet që pengojnë qëllimet e tyre të drejta.

Qëllimi i edukatës është frenimi dhe disiplinimi i ndjenjave të natyrshme kafshërore dhe parandalimi i epsheve të ndryshme, të cilat i çojnë njerëzit në imoralitet. Gjithashtu synon zhvillimin e cilësive të përsosura njerëzore dhe pakësimin e mangësive.

Do të lexoni:



- Hasan Kamil Jëllmaz / 4** Dituria dhe edukata
- Nexhat Ibrahim / 8** Muhammedi a.s., sintezë unikale e vlerave
- William C. Cittick / 10** Qëllimi i arsimit Islam
- Islam Dizdari / 14** Sheh Ahmed Shkodra "Mendimi i tij mistik"
- /18** Këshilla të arta nga Kurani Famëlartë
- Rrustem Spahiu / 22** Edukata kreative dhe mësimi
- Yashar Kandemir / 24** Trego mirëkuptim
- Ahmet Tashgetiren / 27** Çështja e formimit të njeriut Islam
- /30** Një ajet
- /31** Një hadith

Hasan Kamil Jëllmaz /
Dituria dhe edukata



William C. Cittick /
Qëllimi i arsimit Islam



Ahmet Tashgetiren /
Çështja e formimit të njeriut Islam



Viti: V | Numri: 30 | Shtator 2010

Administrator i Progresi botime:
Shuajip Bashhan
bashan43@hotmail.com
+355 69 20 76768

Drejtor & Kryeredaktor:
Alban Kali
albankali@yahoo.com
+355 69 24 23989

Përkthyesit:
Alban Kali / Evans Drishti
Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha
Redaktor letrar:
Shpëtim Kelmendi
Redaktor gjuhësor:
Ma. Irida Hoti

Dizajn - Grafik:
Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com
Për artikuj
e-mail: revistaetika@progresibotime.com
e-mail: kosova@progresibotime.com
e-mail: maqedoni@progresibotime.com
Adresa:
L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi

Shtator 2010

32

Osman Nuri Topbash /
Hazreti Aliu (r.a.)



Osman Nuri Topbash /32

Mr. sci. Flamur Sofiu /40

Hazreti Aliu (r.a.)

Qëndrimi i sheriatit Islam
ndaj lotos, bixhozit dhe
lojrave të fatit

44

Mr. Abdulkadër Durguti /
Vlera e diturisë dhe e veprës në Islam



Mr. Abdulkadër Durguti /44

Fatmir Hadri / 46

Vlera e diturisë
dhe e veprës në Islam

Ditura pasuria
më e madhe në botë

Hutbe të zgjedhura / 48

Mr. Artur Tagani / 50

Fitër Bajrami

Kontributi i Bejtu-l Hikmes

Mag. Ermal Nurja / 52

Dokumenta osmane mbi
Shqipërinë mesjetare

Familja / 54

Sa mund ta dojë nëna
fëmijën e saj?

Shëndeti / 56

Mosha e vërtetë e trupit e
ndryshme me atë të jetës sonë

Teknologji / 58

ICare Mobile pajisja që do të
mbrojë fëmijët nga celularët

52

Mag. Ermal Nurja /
Dokumenta osmane mbi Shqipërinë mesjetare



PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Shkodër / Albania
Tel: +355 22 254 634
Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 441 63 651

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë

Abonim (një vjetor) : 1500 Lekë

Kosovë: 1 Euro

Abonim (një vjetor): 10 Euro

Maqedoni: 60 DEN

Abonim (një vjetor): 720 DEN

Europë: 2 Euro

Abonim (një vjetor): 24 Euro



Dituria dhe edukata

Hasan Kamil Jellmaz

Se ta quajmë si të duam, dituri dhe edukatë ose edukim dhe arsim, por duhet të dimë se në formimin e personalitetit njerëzor, sa është i rëndësishëm përfitimi i diturisë, po aq i rëndësishëm është edhe mësimi i edukatës dhe tezkijes¹. Në ajetet e Kuranit, ku tregohen detyrat e profetëve, me shprehjen “që ata t’ua mësojnë juve librin” synohet arsimimi dhe dhënia e diturisë, ndërsa me fjalën “tezkije” synohet edukata.

Në procesin e formimit të njeriut është e natyrshme që arsimimi dhe edukimi të gjenden së bashku. Mirëpo, kur bëhet fjalë për jetën fetare dhe sensibilitetin Islam, është e detyrueshme që dituria dhe edukata të jenë së bashku.

Dituria e thatë dhe e papërpunuar nuk mjafton në formimin e personalitetit njerëzor. Njerëzit kanë nevojë ta thithin diturinë dhe me shembuj të ndryshëm ta shkrijnë në zemër e ta zotërojnë atë. Edukata fetare duhet të merret duke u ushqyer me dashuri dhe vlera shpirtërore dhe jo duke i imponuar ato. Edukata fetare dhe shpirtërore është një transmetim i fesë në formën e trashëgimisë kulturore dhe civilizimit, nga njëri brez

në tjetrin. Me qëllim që brezat e rinj ta zotërojnë këtë trashëgimi ashtu siç duhet, është e nevojshme që ajo të jepet në përputhje me kushtet e edukatës fetare.

Edukata është kthimi i diturive të përfituara me anë të arsimit në një gjendje shpirtërore me të cilën synohet arritja e të vërtetës. Shkurtimisht, më parë të mësosh pastaj ta jetosh (atë dije).

Më shumë se dituri, feja është çështje dashurie. Në themel të dashurisë qëndron interesimi dhe orientimi. Në natyrën njerëzore ekziston një orientim drejt Krijuesit të Madhëruar, drejt fuqisë absolute dhe një interesim i natyrshëm ndaj jetës fetare. Mirëpo, është shumë e domosdoshme që ky interesim të kthehet në dashuri dhe të ushqehet me dituri.

Orientimi drejt një jete fetare në të cilën është shmanhur dimensionimi i diturisë, lind fanatikë të verbër, ndërsa orientimi drejt diturisë së thatë, në të cilën anashkalohej dimensionimi i dashurisë, lind besimin e pashpirt. Asnjëra prej këtyre të dyjave nuk është ajo që kërkohet: as interesi injorant i privuar nga dituria, as dituria e thatë e privuar nga dashuria dhe emocioni. Ajo që vlen me të

1. Procesi i pastrimit të zemrës.

vërtetë është formimi i një personaliteti dhe identiteti të fuqishëm Islam, ku zë vend edhe dashuria, edhe dituria, sepse feja nuk është një kauzë që i sjell lumturinë dhe rehatinë lëkurës dhe trupit, por përkundrazi, e bën shpirtin dhe thellësitë e tij mbizotërues ndaj trupit dhe jetës. Gjithashtu, duke lexuar librin e Gjithësisë, duhet të shohësh veprën e Krijuesit të Madhëruar tek krijesat dhe t'i duash krijesat për hir të Krijuesit.

Gjatë gjithë historisë njerëzore, ata që kanë fituar zemrat e njerëzve janë ata që u kanë folur zemrave. Këtë të vërtetë, Mevlana e shpreh kështu: *“Fryma ime ka ndezur shumë shpirta në këtë botë, por fjalët e mia të vdekshme nuk kanë arritur në veshin e askujt. Veshët mund të kuptojnë vetëm sipërfaqen e fjalëve të mia, po kush do t'i kuptojë vajtimet që shpirti im?”*

“Shekuj pas meje, këto fjalë do të bëhen të famshme si tregimi i Jusufit, sepse zemra nuk kalbet nën tokë. Dhe unë këtë e thashë nga shpirti dhe jo nga një copë mishi si mëlçia.”

Fushën e fesë duhet ta ndajmë nga shkenca pozitive dhe filozofia. Nëse shkenca pozitive e njeh objektin me anë të shqisave dhe eksperimenteve, filozofia hap krahët drejt thellësive të mendjes. Me këto kërkohet zgjidhja e çështjeve metafizike dhe e disa problemeve brenda kallëpeve kufizuese të mendjes, ndërsa bota e fesë është një përrua dashurie, emocioni dhe frymëzimi që rrjedh nga shpallja hyjnore. Sigurisht, feja nuk i refuzon shqisat e mendjes dhe i koncepton ato si elemente të jashtëm rregullatorë të jetës fetare. Shqisat dhe mendja nuk mund ta projektojnë njeriun as në thelbin e vet dhe as në thelbin e fesë. Feja është vepër e dashurisë. Aty ku nuk ka dashuri, nuk mund të ekzistojë e vërteta, por vetëm një imitim i saj. Mendja është një fener, ndërsa dashuria është një diell. Feneri i mendjes na duhet derisa të lindë dielli i dashurisë dhe kur dielli i dashurisë të lindë, feneri i mendjes nuk na duhet më.

Kurani urdhëron që thirrja për në rrugën e vërtetë të bëhet me urtësi dhe këshilla të bukura, ndërsa profeti ynë i dashur na urdhëron që të përgëzojmë. Madje Kurani dëshiron që edhe Faraonit t'i drejtohen me “kaul-i lejjin”, me gjuhë të ëmbël.

Askush nuk ka të drejtë që botëkuptimin e edukatës dhe manifestimit Islam ta shfaqë si agresivitet, duke u nisur nga termi “xhihad”, sepse xhihad do të thotë:



“Largim i pengesave midis Islamit dhe njeriut”. Pra, lipset përçimi tek njeriu i botës së bukur dhe mëshiruese të Islamit. Përçimi i një mirësie prej zemrës dhe jo prej gjakut dhe urrejtjes, sepse fjala “xhihad” vjen nga rrënja “xhehd” dhe “xhuhd”, ndërsa xhehd dhe xhuhd nënkuptojnë punën dhe mundin trupor, punën mendore dhe shpirtëror për arritjen e një ideali ose kauze. Dhe sigurisht që askush nuk ka të drejtë të gjykojë apo të përziejë gjakun në këtë çështje, pa vlerësuar këto.

Në fakt, po ta shohim nga ky kuptim, edhe tasavvufi është një xhihad. Kjo për arsye se thelbësorja në të është *“largimi i pengesave midis njeriut dhe mirësisë”*, sepse mirësia është ta adhurosh Allahun sikur e sheh Atë. E si mund të mbajë era gjak një koncept i tillë mirësie dhe bukurie që ka në themel këtë botëkuptim?

Edukata shpirtërore dhe fetare i shpëton njerëzit nga injoranca dhe i mbart ata në dritën e dijes. Kjo edukatë i bën të kryejnë vepra me të cilat do të fitonin lumturinë e botës tjetër, duke i orientuar njerëzit drejt së mirës, së bukurës dhe qëllimeve të drejta, duke i treguar rregullat e duhura dhe duke hequr nga rruga arsyet që pengojnë



qëllimet e tyre të drejta.

Qëllimi i edukatës është frenimi dhe disiplinimi i ndjenjave të natyrshme kafshërore dhe parandalimi i epsheve të ndryshme, të cilat i çojnë njerëzit në imoralitet. Gjithashtu synon zhvillimin e cilësive të përsosura njerëzore dhe pakësimin e mangësive.

Njeriu, ashtu si nuk mund të zhvillojë aftësitë që i janë falur pa ndikime të jashtme, nuk mund të zhvillojë as dituritë e tij në lidhje me Krijuesin e Madhërishëm pa një ndikim të jashtëm. Edukata nxjerr në pah aftësitë e lindura të njeriut dhe e ndihmon t'i zhvillojë këto aftësi.

Cilësitë e mira si: dashuria për fenë dhe sakrifica në rrugë të fesë, gjenden tek ata që zotërojnë ndjenja fetare. Edhe fjala e poetit që thotë *"Ai që veten njeri e ndjen nuk lodhet në shërbim të të Vërtetit"*, nënkupton pikërisht këtë. Edukata fetare i tregon njeriut rrugën që të çon në dashurinë hyjnore dhe e pajis atë me mënyrat dhe rrugët e zotërimit të saj.

Njeriu është një qenie që lind e pajisur me ndjenja fe-

tare dhe kjo cilësi e njeriut pranohet nga të gjithë njerëzit e dijes dhe shkencës. Paskali thotë: *"Shpirti i njeriut e di se nëse nuk do të ishte Zoti, çdo gjë do të degjeneronte dhe shkatërrohej. Nëse s'do të ishte Ai, në çështjet e trupit do të zotëronte epshi, në çështjet e shpirtit sendërzimi i tij dhe në urtësi do të zotëronte mendjemadhësia. Shpirti i njeriut e di se urtësia, e cila vjen vetëm prej Zotit, përshtatet me ndodhitë në sajë të vullnetit të Tij, sepse, çdo gjë që Zoti dëshiron është e mirë. Shpirti i njeriut e di se mirësia dhe lumturia janë as jashtë nesh dhe as brenda nesh, por tek besimi tek Zoti. Shpirti i njeriut në mënyrë intuitive kërkon nga Zoti që Ai ta mësojë njeriun që ai ta njohë Atë, të bëhet shërbyesi i Tij dhe gjithmonë ta mësojë atë që të mos dashurojë asgjë tjetër më shumë se Atë."*

Ndërsa Tolstoi thotë kështu: *"Nëse nuk do të kishte Zot dhe jetë të amshueshme, njerëzit do të detyroheshin ta përkuptonin me mallkim ditën që lindën, për shkak të dhembjeve dhe vështirësive të pafundme."*

Ajo që e lidh njeriun me jetën ose ia bën jetën të kuptimtë, është besimi në Allahun dhe dëshira për jetën e amshueshme dhe kjo është një çështje e dijes dhe edukatës. Në këtë çështje jo vetëm dituria ka vlerë dhe ndikim të rëndësishëm në plotësimin e personalitetit. Edukata shpirtërore i siguron njeriut shumë dobi shpirtërore dhe shoqërore. Disa nga këto mund t'i radhitim kështu:

1 - Edukata shpirtërore e bën njeriun të njohë më parë veten e pastaj Zotin e tij. Urdhri në ajetin e parë të Kuranit: ***"Lexo me emrin e Zotit tënd i Cili krijoi (gjithçka)!"*** nxjerr menjëherë në pah e me shprehje të qartë rrugën e dijes dhe mënyrën e njohjes së Zotit. Në përbërje të këtij ajeti qëndron dija, krijuesi dhe krijesa, pra njeriu. Kjo përbërje i tregon njeriut vendin e tij në Gjithësi.

2 - Edukata fetare, duke rregulluar jetën e individit, bën të mundur që mendja dhe zemra të fitojnë vendosmëri dhe i jep më shumë kuptim kësaj bote. Në sajë të edukatës fetare njeriu mëson të përdorë kohën në mënyrë të rregullt, duke kuptuar nivelin në të cilin duhet të jenë marrëdhëniet me Allahun, njerëzit dhe me gjithë krijesat e tjera. Kështu që edhe rendi i shoqërive që i kanë individët e saj të rregullt është më i sigurt.

3 - Feja injekton edhe tek individit edhe tek shoqëria, të mirën të drejtën, të bukurën dhe ia lehtëson rrugën


për tek ato. Jeta individuale nuk duhet të ngrihet mbi jetën shoqërore, por nga ana tjetër as vlerat e rregullat shoqërore nuk duhet të ngrihen para ekzistencës dhe vlerave të individit. Përndryshe, lumturia e njërës palë mund të lërë në hije palën tjetër. As individi nuk duhet të sakrifikohet për shoqërinë, por as shoqëria për individin. Dhe këtë botëkuptim e kultivon më së miri edukata shpirtërore që zhvillohet me një vetëdije të lartë fetare.

4 - Nëse edukata fetare jepet duke integruar deri në një farë mase të gjitha institucionet shoqërore, do të ketë ndikim në çështje si realizimi i drejtësisë shoqërore në bashkësi dhe vendosjen e vlerave shoqërore, duke mos i dhënë mundësi veprimi gjërave që refuzojnë vlerat e shoqërisë.

5 - Të gjithë ata që bëjnë jetë shoqërore përballen në çdo orë të ditës me probleme të ndryshme. Një bashkëshort ose bashkëshorte e vështirë, fëmijë të pabindur, probleme ekonomike e shëndetësore, si dhe plot probleme të tjera të cilat vazhdimisht e pa ndërprerje e mbysin botën e brendshme të njeriut në vështirësi dhe dhembje. Por në natyrën e njeriut ekziston gjithmonë pasioni për t'u larguar prej vështirësive e dhembjeve e për t'u qasur ndaj gëzimeve e dëfrimeve. Transformimi i dhembjes në gëzim, ose pakësimi i ndikimit të saj, varet nga shkalla e fuqizimit të botës sonë të brendshme me frymëzim dhe edukatë shpirtërore. Besimi arrin të pakësojë dhembjet, duke i dhënë njeriut forcë për të përballuar këto lloj vështirësish. Madje, duke menduar në lidhje me shpërblimin që do të arrihet për dhembjet e shkaktuara nga hidhërimet, me kalimin e kohës ndodh që këto dhembje të transformohen në gëzim. Njeriu që beson se çdo ngjarje ndodh me vullnetin Allahut të Madhëruar, ndjen në shpirtin e tij një forcë të pakufishme e kësioj, ndonëse kushtet përreth tij mund të jenë negative, ai arrin të gjejë prapëseprapë mundësinë e shpëtimit.

6 - Gjatë edukimit fetar mund të edukohen njerëz me nivel më të mirë nga ana e shëndetit shpirtëror, nëse edukimi zhvillohet duke pranuar se feja nuk ka përplasje me shkencën dhe se shkenca nuk kundërshton bazat fetare.

Shkenca dhe feja nuk e kundërshtojnë njëra-tjetrën, përkundrazi ato janë grupe vlerash që mbështetin njëra-tjetrën. Mirëpo, vlerësimet e gabuara dhe të pavend



të disa njerëzve, herë - herë i kanë vënë kundër njëra-tjetrës këto dy institucione. Shkenca dhe feja nuk janë dy kalorës që vrapojnë në të njëjtën korsi. Megjithatë, ndonjëherë rrugët e tyre kryqëzohen, ato janë dy institucione që kanë fusha dhe mënyra të ndryshme veprimi. Edhe pse pozitivizmi i shekullit të 19. është munduar ta privojë dhe ta dëbojë fenë nga jeta shoqërore, nuk ka mundur t'ia dalë dot mbanë. Kështu që shkenca dhe feja duhet t'i lënë përplasjet dhe që të dyja duhet të vazhdojnë rrugën e tyre në shërbim të njerëzimit.

Mendojmë se, ashtu sikundër shkenca, duhen rishikuar edhe marrëdhëniet e shtetit me fenë. Sidomos duke pasur parasysh kushtet e reja të kohës në të cilën jetojmë. Nëse feja është një institucion dhe edukata fetare një nevojë, atëherë duhet të jetë detyra e shtetit që ajo (feja) të mësohet nga burime të sigurta dhe me mënyra të përshtatshme edukimi. Shteti duhet të përgatisë bazat për konceptimin e një "edukimi fetar më të shëndetshëm" dhe jo "privimin nga edukimi fetar". Ky duhet të jetë edhe kuptimi i vërtetë i laicizmit.



MUHAMMEDI A.S., SINTEZË UNIKALE E VLERAVE

Nexhat Ibrahim

Ne themi për njeriun se është *i mirë* duke u bazuar në parimet e përgjithshme pozitive të urdhëruara nga Krijuesi, por edhe kur themi se është *i keq* bazohemi në parimet e përgjithshme të urdhëruara po ashtu nga Krijuesi. Ndonjëherë e vlerësojmë njeriun në bazë të këtyre koncepteve, e herëherës përpiqemi ta identifikojmë nëpërmjet koncepteve të caktuara. Nëse do t'i bënim një analizë personalitetit të Muhamedit (a.s.) pa dyshim që do të gjenim në të konceptet bazë të njerëzores, por njëkohësisht, nëse do t'i analizonim një e nga një konceptet e caktuara, do të gjenim në to Muhamedin (a.s.) shembull të njerëzisë dhe manifestim e demonstrim praktik të parimeve hyjnore në botën e krijuar.

Në vazhdim do të trajtohen tre konceptet themelore islame: islami, imani, ihsani, duke dhënë momente të manifestimit të tyre përgjatë historisë.

A. ISLAM-I

Islami është emri me të cilin njihen të gjitha fetë e shpallura nga Allahu, që nga Ademi (a.s.), por në mënyrë të veçantë me këtë emër njihet shpallja e fundit dërguar Pejgamberit të Allahut, Muhamedit (a.s.). Në aspektin gjuhësor shprehja *Islam* do të thotë dorëzim, nënshtrim ndaj urdhrave të

Zotit, dorëzim ndaj vullnetit të Tij. Do të thotë nënshtrim, bindje dhe dëgjim, mirësi dhe dëlirje nga të këqijat (mekatet) e dukshme dhe të padukshme.

Sipas terminologjisë së fesë, shprehja *Islam* do të thotë Njësi e Allahut, nënshtrim ndaj urdhrave të Tij, dëgjueshmëri dhe bindje ndaj Atij. Kjo fe quhet *Islam* në çdo kohë, sepse në këtë mënyrë realizohet bindja dhe nënshtrimi i krijesës ndaj Krijuesit të saj.¹ Edhe pse ekziston dallim ndërmjet imanit dhe islamit, këto të dyja "janë të lidhura njëra me tjetrën sikurse është e lidhur jashtësia (shpina) me brendësinë (barkun)"², apo sikurse është e lidhur fara me frytin. Imani është fara, kurse islami është fryti. Në aspektin teorik, islami (ligji) përfshin parimet e njohura, të njësisë së Zotit të Lartmadhëruar, të vlerës së Pejgamberit (a.s.) dhe të namazit, agjërimit, zekatit dhe haxhit.³

Disa të tjerë e shpjegojnë *islamin* si demonstrim praktik, historik të imanit, i cili manifestohet në jetën praktike të njeriut, në moralin e tij, në mirësjelljen e tij, në planifikimin dhe përdorimin e kohës, të energjisë dhe të aftësisë.⁴ *Islam*

1. Abdul Medžid Aziz Ez Zindani, Jednoća Stvoritelja, Sarajevë, 1998, fq. 336.

2. Imam Ebu Hanifeh, Fikh'ul-ekber, Zëri Islam, Prizren, 2005, fq. 92.

3. Frithjof Schuon, Dimenzije islama, Sarajevo, 1996, fq. 91-92.

4. Për aspektet e shprehjes islam shih: Mewsu'at'ul-edjani, botimi I, Bejrut,

do të thotë ligj, të cilit i përgjigjet monoteizmi i Musait (a.s.). Iman do të thotë besim dhe i përgjigjet monoteizmi i Ibrahimit (a.s.). Ndërsa ihsan do të thotë rrugë dhe i përgjigjet monoteizmi i Isait (a.s.). Në monoteizmin ibrahimian parimi i ligjit (islam) dhe i rrugës (ihsan) janë tretur në parimin e besimit (iman). Në *musaizëm*, parimi i ligjit (islamit) është dominant ndaj dy parimeve të tjera. Në *isaizëm*, dy parimet e tjera janë shkrirë në parimin e rrugës (ihsanit). Ndërsa Islami i përfshin të tre parimet, njërin përkrah tjetrit dhe në një ekuilibër të përkryer.⁵

B. IMAN-I

Nocioni *iman* në aspektin gjuhësor do të thotë: besim, pranim. Ndërsa sipas terminologjisë së fesë islame do të thotë: Të besosh në Allahun, në Melekët e Tij, në Librat e Tij, në Pejgamberët e Tij, në Ditën e fundit dhe në caktimin e së mirës e së keqes dhe në pejgamberinë e Muhamedit (a.s.), apo siç shprehet në lidhje me këtë F. Shuon, Imani (besimi) përfshin dy dëshmi: atë të njësisë së Zotit dhe të vlerës së Muhamedit (a.s.).⁶ Këtë kuptim shprehja *iman* e ka nëse përmendet në kontekst të fesë islame dhe të gjithë ata që përmbushin këtë kërkesë quhen mu'min (besimtarë). *Iman* shpreh edhe fenë në tërësi, kur theksohet në mënyrë të pavarur nga fjala *islam*.⁷

Imani përfshin çështjet e shpirtit në dallim nga *islami*, i cili është manifestimi fizik i ritualeve fetare. Edhe pse shprehja *islam* dhe *iman* janë të ndryshme, ato janë të pandashme, sepse vetëm një *iman* i mirëfilltë kërkon nënshtrim e përkushtim dhe se nënshtrimi dhe përkushtimi i mirëfilltë janë pasojë e *imanit* të vlefshëm.⁸

Imam Ebu Hanife pohon se "*imani është deklarimi me gjuhë dhe besimi me zemër*" dhe ai "*nuk zmadhohet as nuk zvogëlohet*."⁹ Sipas Ebu Hanifes, imani është koncept i pandarë, tërësia e tij është e barabartë tek të gjithë njerëzit që e kanë pranuar. Kësaj tërësie nuk mund t'i mohojnë asnjë element (kusht), në rast mohimi të njërit prej kushteve të saj, shkatërrohet e gjithë struktura harmonike.¹⁰

C. IHSAN-I

Nocioni *ihsan* në gjuhën arabe do të thotë: bamirësi, bukur, dhe paraqet planin e brendshëm të fesë islame. Me *Ih-*

san kuptojmë përsosmërinë e veprave, saktësinë e tyre, gjë që është e kundërta e të keqes.

Sipas terminologjisë së fesë islame, *ihsan* do të thotë: zbulimi i jashtësisë me ibadet dhe i brendësisë me përkushtim të singertë.¹¹

Ihsani është shkalla më e lartë e Islamit, ndërsa thelbi i ihsanit është dashuria ndaj Allahut. Njëkohësisht, ihsani nënkupton bukurinë, bamirësinë dhe virtytet më të larta, përkushtimin e thellë, dashurinë e singertë, besnikërinë e mirëfilltë dhe sakrificën. *Ihsani* (rruga) paraqet pozicionin e mesëm dhe qenësor, që konsiston në të përmendurit e Zotit (dhikr'ull-llah).¹²

Në qenësinë e tij, virtyti i ihsanit është aktiv dhe kërkon aktivitet përballë të këqijave. Ai që aplikon ihsanin, pra muhsini, nuk qëndron indiferent para veprimeve kundër-islame, e prandaj vetëm këto meritojnë të gjenden nën mbrojtjen e Allahut. Institucioni i ihsanit ndërton sistem politik, ekonomik, shoqëror; përcakton marrëdhënien e individit me shtetin dhe atë të shtetit me individin, ndërton marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kombëtare në kohë paqeje dhe luftë.¹³

Ihsani nënkupton faktin që njeriu duhet t'i kryejë rregullisht detyrat dhe obligimet ndaj vetvetes, ndaj bashkësisë, ndaj fqinjve e sidomos ndaj Allahut (xh.sh.), si dhe t'u jetë mirënjohës njerëzve për të mirat që i kanë bërë.¹⁴ Të gjitha këto janë një shprehje e besimit të pastër në Allahun (xh.sh.) dhe rruga për të fituar simpatinë dhe shpërblimin e Allahut (xh.sh.).

Imam Neveviu në lidhje me pjesën e hadithit "*ta adhurosh All-llahun, sikur e sheh Atë...*", thekson se aty paraqitet një bazë themelore e besimit islam. Pasi, një nga bazat e mësimi islam, është adhurimi i Allahut sikur e sheh Atë. Kjo gjendje shpirtërore, është nivel i lartë sinqeriteti i njerëzve të devotshëm dhe thesar i pashterrshëm moral e shpirtëror i besimtarit.¹⁵

E tërë kjo përbën një tërësi të pandashme që quhet **islam**,¹⁶ ndonëse në kontekste të ndryshme, mes këtyre nocioneve dalin në pah disa specifika të vogla të cilat janë shprehje e rrethanave të ndryshme.

Pavarësisht se të gjithë pejgamberët i zotërojnë të gjitha cilësitë pozitive, Ibrahim (a.s.) është profilizuar në virtytin e besimit, Musai (a.s.) në profilin e ligjit dhe Isai (a.s.) në profilin e rrugës. Muhamedi (a.s.) është sintezë i të gjithë këtyre, ndërsa profili i tij si i dërguar për të gjithë njerëzit dhe të gjitha kohërat, është universal.

2001/1422, fq. 80-82.

5. Gjerësisht: Frithjof Schuon, Dimenzije islama, Sarajevo, 1996, fq. 91-92.

6. Frithjof Schuon, po aty, fq. 92.

7. Ez Zindani, po ashtu, fq. 337 ose përkthimin shqip.

8. Mehmed Handzic, Izabrana djela, VI, Sarajevo, 1999, fq. 374.

9. Imam Ebu Hanifeh, Fikh'ul-ekber, Zëri Islam, Prizren, 2005, fq. 78-79.

10. Një dijetar tjetër, Halid-i Bagdadi pohon: "Nuk ekziston pak apo shumë iman. Besimi që zvogëlohet dhe zmadhohet nuk quhet iman, por parashtrim dhe iluzion. Të kesh iman më të fortë apo më të dobët, do të thotë të bëhet më shumë apo më pak ibadet." Sipas: Imam Ebu Hanifeh, Fikh'ul-ekber, Zëri Islam, Prizren, 2005, fq. 79.

11. Ez Zindani, po aty, str. 337.

12. Frithjof Schuon, po aty, fq. 92.

13. Muhamed Kutub, Shkëndija pejgamberike, Shkup, 2002, fq. 93-110.

14. Sahih'ul-Buhari, op. cit., fq. 74.

15. Ibid., fq. 74.

16. Mewsu'at'ul-edjani, po aty, fq. 47-48.



Qëllimi i arsimit islam

William C. Chittick

Nocionet e 'arsimit' janë të skalitura në vlerat dhe qëllimet e shoqërisë moderne. Individët kuptohen sipas roleve të tyre në shoqëri, ndërsa qëllimet njerëzore përkufizohen në terma ideologjike. Me 'ideologji' nënkuptoj skema të përmirësimit të gjendjes njerëzore, mbështetur në hamendjet e mendimit modern të zhvilluara në shekullin XVIII, pra në periudhën e njohur si Iluminizëm.

Stili i ri i të menduarit që u shfaq gjatë Iluminizmit i kundërshtoi të gjitha nocionet tradicionale të së vërtetës, të autoritetit, të hierarkisë dhe të natyrës njerëzore. Ai përgatiti terrenin për sisteme të ndryshme të vëna në jetë gjatë periudhës moderne, në përpjekje për ta trajtësuar shoqërinë sipas idealeve humaniste si: demokracia, socializmi e marksizmi, me të gjitha larmitë dhe degëzimet e tyre. Ndër më të spikaturat e këtyre degëzimeve janë lëvizjet moderne islamiste, të cilat janë njëloj si sistemet e tjera ideologjike, në orvatjen për të imponuar një sistem abstrakt të bërë nga njeriu mbi shoqërinë.

Çdo ideologji fillon me presupozime të caktuara mbi natyrën njerëzore, të cilat nuk bashkëndahen nga mendimi paramodern. Qeniet njerëzore kuptohen në termat e gjetjeve

të shkencës moderne, të cilat përjashtojnë *de facto*, në mos *de jure*, çdo mundësi transhendente, çdo nocion profetësie e shpalljeje, si dhe çfarëdo shqyrtimi serioz të jetës së amshueshme. Duke e lexuar Iluminizmin nëpërmjet termave islamë, mund të themi se ai përbën një stil të ri mendimi, bazuar në kundërshtim të tre parimeve themelore të mendimit islam: Unitetit Hyjnor (*teuhid*), Profetësisë (*nubuëë*) dhe Kthimit te Zoti (*ma'ād*). Me fjalë të tjera, nocionet moderne mbi natyrën njerëzore bazohen në kundërshtimin e të vërtetave që kanë formuar gjithmonë bërthamën e të kuptuarit të myslimanëve.

Nuk dua të nënkuptoj që këto të vërteta themelore islame janë thjesht islame; ato i ndan çdo qytetërim paramodern, e jo më pak i krishteri. Me fjalë të tjera, botëkuptimi i qytetërimeve paramoderne e njëjtte teuhidin, unitetin e Realitetit të Përfundëm. Ato ishin të bindura gjithashtu, se përsosja njerëzore nuk arrihej dot pa nismën e atij Realiteti, pra pa ndihmën e figurave të njohura si profetë, avatarë, buda ose të urtë. Gjithashtu, botëkuptimet paramoderne pohonin se mënyra jonë e të ekzistuarit në këtë jetë është thjesht etapë e bërjes së njeriut dhe se çdo njeri është deri diku përgjegjës

për mënyrën e ekzistencës së vet pas vdekjes.

Shkurt, çdo diskutim i 'arsimit' në kontekstin e mësimave islame, duhet të nisë me faktin se nocionet e arsimit në kohët moderne bazohen në konceptet e natyrës njerëzore të rrënjëzuara në Iluminizëm. Këto koncepte janë thellësisht të papërputhshme me nocionet islame mbi natyrën njerëzore. Për rrjedhojë, arsimi modern që u shërbeu nevojave të ideologjive të shteteve moderne, është thellësisht i papërputhshëm me arsimin islam, i cili u shërben nevojave të shpirtit njerëzor, gjatë kërkimit për t'iu rikthyer Zotit në mënyrën më të mirë të mundshme.



'Islame' është ajo gjë e cila bazohet në mësimet e Kuranit dhe të Profetit Muhamed. Asnjë fjalë arabe e burimeve të hershme nuk përkon me nocionin tonë modern të arsimit. Sigurisht, Kurani dhe literatura e Hadithit janë plot me këshilla e nxitje për të kërkuar diturinë dhe për të përmirësuar veten nëpërmjet përputhjes ndaj normave nga Zoti dhe Profeti i Tij. Por dija dhe përmirësimi kuptohen gjithmonë në terma të një synimi të posaçëm dhe ky synim është që të bëhemi plotësisht njerëzor në këtë botë e të arrijmë lumturi të përjetshme në tjetrën. ***Dija nuk ka vlerë në vetvete dhe për vete***, sepse përndryshe, Profeti nuk do ishte lutur: *"O Zot, kërkoj strehë ndaj dijes që s'ka dobi."*¹

Fjala 'edukoj', vjen nga një rrënjë latine që do të thotë me udhëheqë, me tërheqë. Mund të debatohet se në të vërtetë Kurani ofron një nocion disi paralel, i cili ndodhet në zemrën e lutjes islame. Sureja el-Fātiha, e recituar shumë herë në ditë nga një mysliman ushtrues, sillet rreth fjalisë (Na udhëzo në Rrugën e Drejtë). Rruga e Drejtë është udha që shpie në lumturinë dhe plotninë njerëzore. Me fjalë të tjera, rruga që çon në 'sukses'. Mirëpo, sukcesi përkufizohet jo në terma të kësaj bote, po përkundrazi, në termat e një tjetër bote shumë më reale e të përhershme.

Sipas traditës, Fātihaja ngërthen mesazhin e tërë Kuranit. Ajo shenjon qartë tre parime që përbëjnë themelin e botë-kuptimit islam. Më lejoni të sugjeroj se si janë gdhendur këto tre nocione të kësaj sure.

Përgjithësisht, teuhīdi shprehet në mënyrë më të thukët në formulën kuranore: *la ilahe il-la'Llah* ("nuk ka zot përveçse Zoti"). Kjo formulë është parë gjithmonë të nënkuptojë që e tërë ekzistenca vjen nga Zoti, se i gjithë realiteti mbahet vazhdimisht nga Zoti dhe se të gjitha gjërat përfundimisht kthehen te Ai. Çdo cilësi pozitive e ndeshur në botë dhe në veten tonë mund të jetë veçse pasqyrim i zbehtë i cilësive të Zotit. Vetëm Zoti është vërtetësisht i mirë, vetëm Zoti është




të vërtetësisht i bukur, vetëm Zoti është vërtetësisht i fuqishëm, vetëm Zoti është vërtetësisht i pavarur, e kështu me radhë duke vazhduar me përmendjen e tërë listës së emrave hyjnorë. Shkurt, teuhīdi nënkupton se nuk ka asgjë vërtetësisht reale përveç Zotit.

Fātihaja fillon me vargun (Lavdërimi i përket Zotit), gjë që përbën thjesht një pohim të teuhīdit: se askush nuk është i denjë për lavdërimi përveç Zotit, sepse nuk ka asgjë që është vërtetësisht e mirë përveç Zotit. Po kështu, teuhīdi shprehet edhe në pohimin (Vetëm Ty të shërbejmë e veç prej Teje kërkojmë ndihmë). Nuk ka zot përveç Zotit, ndaj nuk ka asnjë të denjë për t'i shërbyer dhe asnjë që mund të sigurojë ndihmë të vërtetë përveçse prej Tij. Vini re se kjo fjali mbahet zakonisht si vendosëse e një ideali: myslimanët duhet t'i shërbejnë vetëm Zotit e të kërkojnë ndihmë vetëm prej Tij. Mirëpo, nëse vërejmë më kujdes, do të shohim se ajo përbën edhe pohim faktual. Uniteti i Realitetit kërkon që çdokush, mysliman apo jo, duhet t'i shërbejë dhe t'i kërkojë ndihmë Zotit në rrjedhën e jetës së vet. Meqë ka vetëm një Realitet të vërtetë, të gjitha gjërat veprojnë në përputhje me atë Realitet: të gjitha gjërat janë me përkufizim shërbëtore të atij Realiteti. Kur njerëzit kërkojnë ndihmë, ata në të vërtetë kërkojnë ndihmë nga ai Realitet i vetëm, qofshin apo jo të ndërgjegjshëm për këtë fakt.

Kjo na sjell në parimin e dytë të mendimit islam, të cilin Fātihaja e përmend haptazi duke përdorur foljen "me udhë-

1. Muslim, Dhikr 73; Ebū Dā'ūd, Edeb 61, Uitr 32; et-Tabrizī, *Mishkātu'l-mesābih* 524; el-Muttakī, *Kenzu'l-ummāl*, nr. 3609. (shën. përk.)



zue". Teuhidi mëson se "nuk ka udhëzues, përveçse Zotit". Siç e formulon Kurani, duke iu drejtuar Pejgamberit, (Nuk e udhëzon ti atë që do, por udhëzon Zoti kë do Ai) (28:56). Por megjithatë, Kurani thotë për Profetin: (Ti udhëzon në Rrugë të Drejtë) (42:52). Kjo do të thotë se Zoti udhëzon duke nisur profetë dhe funksioni i këtyre profetëve është t'i udhëzojë njerëzit në Rrugën e Drejtë, e cila shpie në lumturi të përjetshme.

Parimi i tretë i mendimit islam është Rikthimi te Zoti. Atë e nënkupton vetë nocioni i Rrugës së Drejtë, *es-siratu'l-mustekim*. Përse është e rëndësishme rruga? Sepse shpie në lumturi pas vdekjes. Midis tjerash, domethënien e saj e tregon edhe fakti se e ashtuquajtura "urë mbi Ferr" në Ditën e Ringjalljes, quhet gjithashtu *es-sirat*. Ata që arrijnë ta kalojnë Urën pa rrëshqitur në Zjarr, janë ata që kanë marrë udhëzimin për të ndjekur Rrugën e Drejtë në këtë jetë. Ata që dështojnë së kaluari Urën, janë ata që nuk e kanë ndjekur Rrugën e Drejtë - në vend të kësaj, siç thotë Fâtihaja, ata janë mes të shmangurve ose mes atyre që kanë fituar zemëratën e Zotit.



Siç e thashë më lart, fjala "arsim" do të thotë me udhërrëfye. Në latinisht, *ducere* do të thotë me udhëzue, me drejtue, me nxjerrë. Kur luten që të udhëzohen në Rrugën e Drejtë, myslimanët i kërkojnë Zotit t'i nxjerrë nga injoranca, urrej-tja, mëria dhe nga të gjitha tiparet e mbrapshta të karakterit, që pengojnë lulëzimin e plotësishmërisë dhe të virtytit. Këto tipare negative të karakterit janë të rrënjosura thellë në egon njerëzore. Arsyeja e kësaj është thjesht se njerëzit nuk janë Zoti, dhe vetëm Zoti është i mirë dhe i vërtetë. Siç thotë Kurani: (Njeriu u krijua i dobët). (4:28) Ademi ra nga parajsa për shkak të dobësisë së tij, që Kurani e quan "harresë" (*nisjān*) dhe "indiferencë" (*ghafle*). Harresa është e thurur në ekzistencën njerëzore. Për të dalë nga harresa, njerëzit

duhen *nxjerrë* prej saj: ata duhen *edukuar/arsimuar*. Askush nuk mund ta arrijë plotësinë e mundësisë njerëzore, diturinë, urtinë, virtytin dhe mirësinë e vërtetë, me përpjekjet e veta. Gjithkush ka nevojë për një edukues, i cili do t'i tregojë udhën e dijes dhe shpëtimit. Edukuesi është pikërisht "udhëzuesi" (*hādī*).

Në shoqërinë tradicionale islame, udhërrëfimi sigurohej nga dijetarët ('ulemā). Sipas një thënieje të shumëpërhapur (që shpesh i njihet Profetit), "Dijetarët janë trashëguesit e profetëve."² 'Ulemā janë, fjalë për fjalë, "ata me dituri", ku ekzistojnë lloje të ndryshme 'ulemāje, në varësi të llojit të diturisë që kanë trashëguar nga profetët. Ka tri sfera themelore të diturisë, çdonjëra nga të cilat përfshihet nga Kurani dhe trupëzohet te Profeti. Trashëguesi ideal i Profetit do t'i ketë aktualizuar të trija llojet e diturisë, por në të vërtetë shumica e 'ulemāve kufizohen mjaft në dijen e tyre. Sigurisht, asnjë nga 'ulemātë nuk mund të jetë udhëzues aq i plotë sa vetë Profeti. Tri llojet bazë të diturisë islame që duhen trupëzuar idealisht nga 'ulemātë, janë dija e të vepruarit të duhur, dija e Realitetit të Vërtetë dhe dija e përsosmërisë shpirtërore. "Dija e të vepruarit të drejtë" është lëmi i Sheri'atit dhe i jurisprudencës. "Dija e Realitetit të Vërtetë" është fusha e atyre 'ulemāve që studiojnë kelāmin, sufizmin teorik dhe/ose filozofinë. Këta dijetarë shpjegojnë mësimet kuranore mbi realitetin e Zotit, natyrën e kozmosit dhe bërjen e vetes njerëzore. Me fjalë të tjera, ky grup studion metafizikën, teologjinë, kozmologjinë dhe psikologjinë e përshtatshme. Sfera e tretë, "dija e përsosjes shpirtërore", trajton mënyrën e shndërrimit të brendshëm dhe përputhjen me normat e vendosura nga Zoti, jo vetëm në të vepruar e në të menduar, por edhe në qenien tonë të brendshme. Ky lëm është specialiteti i mjeshtrove sufi.

Thashë se arsimi modern është i papërputhshëm me arsimin tradicional mysliman. Me arsim tradicional mysliman nënkuptoj "udhëzimin në Rrugën e Drejtë", e cila shpie në të vepruarit të duhur, në të kuptuarit e drejtë dhe në shndërrimin e duhur të vetes. Me të shquar se arsimi islam fokusohet në arritjen e përsosmërisë njerëzore sipas normave Hyjnore e jo normave humaniste të Iluminizmit, mund të kuptojmë lehtë arsyen se përse arsimi modern shkatërron bazat mbi të cilat duhet ndërtuar arsimi islam. Më lejoni të tregoj disa pika në të cilat shfaqet konflikti ndërmjet arsimit islam dhe atij modern, sidomos në lidhje me parimin themelor të mendimit Islam, teuhidin.

Arsimi modern pretendon se bazohet në "shkencë" dhe se e merr autoritetin e vet nga të qenit "shkencor". Mendi-

2. Ebū Dā'ūd, vëll. III, f. 317, h. 3157; Tirmidhī, vëll. IX, f. 296, h. 2606; Ibn Māxhe, 'Ilm 81; Ibn Hanbel, *Musned*, vëll. V, f. 196; Darīmī, *Mukādime* 98; el-Bejhakī, *Shu'ab el-īmān*; Ibn Hibbān, *Sahīh*; el-Kulejñi, *Fadlu'l-ilm* 45, 57; etj. (shën. përk.)

mi shkencor karakterizohet nga fokusi i tij mbi shumësinë dhe studimin empirik të sferës së kapshme nga shqisat, qoftë nëse këto e arrijnë futjen në atë sferë drejtpërsëdrejti apo me anë të instrumenteve. Përbrendazi apo haptazi, mendimi shkencor hedh poshtë çdo lloj dijeje të paverifikueshme empirikisht. Kjo lloj qasjeje është me dobi për të ushtruar kontroll mbi mjedisin e njerëzit, siç vihet re qartë edhe nga mënyra me të cilën ajo përdoret nga qeveritë, ushtria e industria. Mirëpo, me të pretenduar se dija shkencore është e vetmja dituri e vlefshme dhe e ligjshme, nuk mund të bëhet më fjalë për shkencë, po për “shkencizëm”, besimin se vetëm shkenca lejon qasje tek e vërteta. Zakonisht shkencëtarët janë tepër të sofistikuar për të besuar në shkencizëm, pasi e kuptojnë se shkencizmi është qëndrim ideologjik, i cili nuk mund të demonstron empirikisht.

Megjithatë, shkencizmi është përbërës i fuqishëm i botë-kuptimit modern. Shumica e njerëzve besojnë në pretendimet për të vërtetën që ka shkenca, më shumë nga ç’u besojnë pohimeve për të vërtetën që bën feja. Ata besojnë se shkenca merret me dijen dhe realitetin objektiv, teksa kujtojnë se feja merret thjesht me sferën subjektive të opinioneve e ndjenjave. Besimi në shkencë është thellësisht i papërputhshëm me qasjen e diturisë islame. Në terma islam, e vetmja dituri e vërtetë, e vetmja dije absolutisht e besueshme dhe e vërtetë-sishme është teuhidi, fakti se nuk ka asgjë reale përveç Realitetit. Kjo është njohur gjithmonë si e vërtetë dhe si fakt, jo si besim. Ajo është “besim” vetëm për njerëzit e thjeshtë, të cilët e pranojnë mbi bazën e autoritetit, pa e kuptuar se ç’do të thotë. Për çdo person me intelekt të shëndoshë (*‘akl selim*), ajo përbën të vërtetën themelore përmes të cilës duhen kuptuar të gjitha të vërtetat dhe duhet ndërtuar e tërë dituria. Cilado formë e dijes që shpërfill teuhidin, injoron tërësisht të vërtetën e vetme nga e cila varet çdo e vërtetë.

Gjithkush e di se qytetërimi islam zhvilloi një sërë disiplinash shkencore në mënyra tejet të ndërlikuara, si matematika, astronomia e mjekësia. Mirëpo, këto disiplina ishin gjithmonë pjesë e një vizioni më të madh, dhe ky vizion ishte teuhidi. Botëkuptimi islam nisi me pohimin e realitetin e Zotit, Unitetin e Realitetit të përfundëm, rrënjëzimin e gjithçkaje te Zoti. Kjo nënkuptonte se të kuptuarit e drejtë të gjërave varej nga të kuptuarit e tyre në raport me Zotin, Realitetin e Përfundëm. Çdo dije mbi botën, që nuk e vendos atë në terma të Burimit të saj Transhendent, është në të vërtetë injorancë, sepse i pengon njerëzit që t’i shikojnë gjërat ashtu siç janë në të vërtetë.

Është mjaft e qartë se një intuizim i unitetit i nxit shkencëtarët e epokës moderne në kërkimin e tyre për teori gjithpërfshirëse të universit. Por gjithashtu, nuk mund të ketë kurrfarë dyshimi se teoritë që mbizotërojnë disiplinat shkencore dhe arsimore bashkëkohore, janë shpalosje e një pari-

mi të cilin mund ta quajmë *tekthir*. Teuhidi buron nga fjala *uahde* (njëshmëri) dhe nënkupton të pohuarit e njëshmërisë së Zotit, të deklaruarit e unitetit të Realitetit të Përfundëm. *Tekthir* buron nga fjala *kathra* (shumësi) dhe nënkupton pohimin e shumësisë së realitetit. Në një këndvështrim tekthiri e mohon teuhidin, fshehtazi ose edhe haptazi. Në vend të *Një* Realiteti, ai shtron shumë realitete. Rezultati përfundimtar është shpërhapja e dijes njerëzore, shtimi i disiplinave shkencore e akademike, shumësia e synimeve njerëzore, dhe një mospajtim, përçarje, çintegrim, konflikt e shthurje pa fund.

Tekthiri nuk është medoemos i keq. Nganjëherë, filozofët myslimanë e përdornin këtë fjalë për të treguar vetë aktin me anë të të cilit Një Zot krijon një botë shumësie. Mirëpo, detyra njerëzore është t’i ikë tekthirit, të shohë tej shumësisë dhe përçarjes që sundon sferën e dukshme. Njerëzit ftohen të vendosin teuhidin, i cili nënkupton prurjen e unitetit, harmonisë, barazpeshës, drejtësisë dhe paqes. Megjithatë, ata thërriten që ta arrijnë këtë në vetë jetët e tyre. Askush nuk mund të sjellë harmoni, barazpeshë dhe paqe në botë, nëse nuk ndodhet në paqe me Zotin. Fakti që teuhidi duhet të fillojë me individin, na shpie drejt njerëzit prej dallimeve elementare ndërmjet mendimit tradicional dhe sistemeve ideologjike moderne. Islami ka mësuar gjithnjë se çdo individ është përgjegjës para Zotit. Pa plotësuar përgjegjësitë vetjake, nuk jetohej sipas normave të Zotit. Përkundrazi, mendimi modern pohon se një shoqëri e harmonishme mund të ndërtohet njëherazi, duke i imponuar asaj një sistem. Kur të gjithë i përputhen sistemit të imponuar - të shpikur nga ideologët e të imponuar nga burokratët - shoqëria do të jetë e harmonishme. Me fjalë të tjera, shoqëria tradicionale thotë: “Fillo me veten!”; mendimi modern thotë: “Reformo të tjerët!”

Shkurt, teuhidi është vizion që duhet arritur nga çdo qenie njerëzore. Ai përbën detyrën e individëve. Rruga për ta arritur atë quhet Udhë e Drejtë. Ata që i çojnë njerëzit në Udhë të drejtë janë pikësëpari Zoti, pastaj profetët, pastaj trashëguesit e profetëve. Megjithatë, nuk është e mundur që thjesht të ndjekim mësuesit. Ajo që kupton mësuesi juaj nuk ju ndihmon, përveç nëse e kuptoni edhe ju. Është përgjegjësia e çdo myslimani që të kërkojë dijen e tij dhe të kuptuarit e tij vetjak. “*Kërkimi i diturisë është i detyrueshëm për çdo mysliman e myslimane*” ka thënë Profeti. Dhe ky kërkim, na tregon ai, zgjat “nga djepi gjer në varr”. Pa ngulmimin për të kuptuar, njerëzit do mbeten injorantë e harrues, pavarësisht se sa mund të kenë zotëruar shkencën e inxhinierinë, filozofinë dhe sociologjinë, ose cilëndo disiplinë tjetër të rrënjëzuar në *tekthir*.

vijon...

Përktheu Edin Lohja

SHEH AHMED SHKODRA

"Mendimi i tij mistik"

Islam Dizdari

*D*uke lexuar librin "Sheh Ahmed Shkodra, jeta dhe veprimtaria", m'u duk e arsyeshme të flas për mistikën në veprën e autorit. Para se të parashtroj disa probleme lidhur me temën që kam marrë përsipër të trajtoj, më duket se është e nevojshme të sqaroj dy çështje.

Së pari, Sheh Ahmed Shkodra nuk është teoricien i mistikës islame, ai nuk i ka vënë vetes të parashtrojë probleme teorike në këtë fushë. Ai është udhëheqës shpirtëror, është sheh i tarikatis Alie Rufai në Shkodër, pra është drejtues praktik i veprimtarisë së pasuesve të tij. Gjatë kësaj veprimtarie, por edhe në shkrimet e veta, ai është bazuar dhe udhëhequr nga ide mistike që e kanë burimin plotësisht në Kur'anin famëlartë e në hadithet e Profetit Muhamed a.s.

Së dyti, autori shkruan në gjuhën shqipe, dhe këtë e bën në një periudhë kur letërsia fetare islame në gjuhën amtare ishte fare pak e lëvruar. Autori ishte i pajisur me një kulturë të lartë islame, zotëronte disa gjuhë të huaja orientale, por ta themi hapur: si shumë bashkëmoshatarë dhe kolegë të tij, ai e kishte më lehtë të shkruante në bazë të gjuhës dhe të kulturës që mbizotëronte në atë kohë, nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX. Si rrjedhojë, gjinitë që lëvron, stili dhe mënyra e të shprehurit në gjuhën shqipe, janë fillestare dhe disi të paarrira. Megjithatë, ndonëse nuk janë të shprehura bukur dhe me elokuencën e mjaftueshme, idetë e tij kuptohen qartë. Ai ka meritën se shkruan në gjuhën shqipe, fillimisht me alfabetin arab e pastaj me atë latin. Ky fakt ka rëndësi themelore. Tashmë kish nisur të konsolidohej nevoja e shkrimit të shqipes me alfabetin latin, gjë që nuk ishte aspak e lehtë për autorët.

Të gjitha këto i theksova për të nxjerrë në pah se trajtimi i problemeve mistike nga Sheh Ahmeti nuk është bërë në

një parastresë të veçantë teorike, por as me elokuencën e mjaftueshme, gjë që ka vështirësuar shpërfaqjen e ideve që na interesojnë të parashtrojmë këtu.

Së pari, dua të theksoj se Sheh Ahmeti ishte një personalitet i kulturës islame për kohën. Ai udhëhiqej nga mësimet e Profetit a.s., sipas të cilave dijetarët shpirtërorë të fesë islame janë me të vërtetë trashëgimtarët e profetëve, e profetët nuk lanë trashëgim të holla e para, por lanë trashëgim diturinë. Pra, ai që ka marrë dijen, ka marrë pjesën më të mirë e më të dobishme. Sheh Ahmeti ishte shembulli i lartë i një dijetari, i cili iu përvesh me vullnet të pashoq përvetësimit të diturisë së trashëguar nga profetët, gjë e cila i shërbeu ngritjes dhe formimit të tij shpirtëror.

Me sa vërehet nga e gjithë veprimtaria e Sheh Ahmetit, ky lartësim shpirtëror kaloi në tri shkallë: pastrimi fizik, reformimi mendor dhe pastrimi e edukimi moral.

Një trup i shëndoshë i aftë për punë të mbara, një mendje e ndritur dhe e ushqyer me dituritë më të larta, kanë si nevojë e si kusht të domosdoshëm një zemër të pastër, një formim të plotë moral. Bindjet e larta morale, zemra e ushqyer nga ky moral udhëheq dhe drejton mendjen e ndritur e të gjitha fuqitë fizike të njeriut drejt një veprimtarie që është në përputhje me mësimet e Kuranit të madhëruar e me traditën e shquar profetike. I udhëhequr nga këto parime të larta, Sheh Ahmeti u fut që në rininë e vet në një luftë të pandërprerë me vetveten kundër veseve dhe pasioneve të ulëta që kaplojnë e nxisin fuqitë trupore të qenies njerëzore, kundër epsheve që e shtyjnë njeriun t'u bjerë ndesh arsyes dhe bindjeve morale. Kështu, shkallë shkallë, ai u shndërrua në shembullin e përkryer të një njeriu me zemër të pastër, që u rri larg interesave materiale, gjë e cila bëri të mundur

që brenda tij të lulëzojë drita e virtytit e ai të hidhet me entuziazëm të zjarrtë në lartësimin e botës së vet shpirtërore. Ai u pajis me fuqi shpirtërore të larta e të paepura për të përballuar vështirësitë e jetës e të punës. Në këtë shkallë diturie e lartësimi, shpirti i tij u ndriçua nga drita hyjnore dhe ai iu përkushtua me tërë qenien e shpirtin e vet, adhurimit të të Madhit Zot. Të gjithë bashkëkohësit që e kanë njohur, kanë vënë re tek Sheh Ahmeti, burrin e hijshëm, kujdesin e tij në paraqitjen fizike, pastërtinë e bukurinë trupore, veshjen modeste por që e lartësonte portretin e tij para të gjithëve, gjë e cila kishte ndikim aq të fortë, sa njerëzit mund ta nderonin e t'i bindeshin qoftë dhe vetëm nga pamja që kishte. Të gjithë e vërenin qartë se në zemrën e tij vlonte një dashuri e zjarrtë për Zotin e mëshirshëm, një dashuri pa masë e kufi, dashuri e pastër, e kulluar, e lartë, e shenjtë. Me tërë veprimtarinë dhe shkrimet që ai ka lënë gjatë udhës së tij në të ngjiturit e shkallëve diturisë, Sheh Ahmeti u bë një shembull i ndritur për pasuesit e tij, tek të cilët ndikoi fuqishëm për shërimin e sëmundjeve morale, që janë shoqëruese të pashmangshme të njeriut. Sheh Ahmeti është një provë e thënies Profetike: “Dijetarët shpirtërorë të fesë islame të cilët s'i ndahen të vërtetës, nuk kanë për të munguar asnjëherë”. Kjo është një nga mirësitë e panumërta që Zoti i madhnueshëm i ka dhuruar bashkësisë islame të Profetit a.s.

Ai nuk qe vetëm një njeri i ditur e me virtyte të larta, jo vetëm kaq, por një njeri i cili diturinë dhe pastërtinë e vet morale donte ta shikonte tek të gjithë, ta përhapte tek të gjithë. Prandaj ai punoi tërë jetën për t'i pajisur njerëzit me sjellje fisnike, me cilësi të larta morale, luftoi për t'u pastruar zemrat e për t'ua ndriçuar shpirtat. Kjo bëri që të gjithë të kërkonin tek ai mbështetje e lidhje shpirtërore. Natyrisht, në këto kushte, Shehu i nderuar e ndiente veten gjithnjë në kërkim, gjithnjë në rrugën e përpjekjeve për t'iu afruar dritës Hyjnore, dashurisë pakufi për Zotin e Madhnueshëm. Ai predikonte me bindje të thellë dhe zbatonte në praktikë me përpikmëri dhe pa asnjë neglizhencë shartet e imanit, shtyllat e besimit, moralin e lartë islam, të cilat i kryente me një devotshmëri të pashoqe. Para kësaj autoriteti thyheshin kundërshtitë dhe fashiteshin kritikë. Sheh Ahmeti lartësonte pa pushim Allahun famëlartë përmes zikrit, gjë të cilën ua këshillonte pa pushim edhe muridëve të tij. Kjo ishte një udhë veprimi sipas të cilës muridi (dervishi) duhet të ishte i gjithnjë i lidhur me Zotin xh.sh., me Profetin a.s. dhe me prijësin e vet, shehun. Përmes zikrit ai synonte të pastronte shpirtin e besimtarëve, t'i lartësonte ata, t'ua shtonte në zemër dashurinë për Zotin, duke i bërë të kujtojnë me respekt Madhërinë e Tij. Ai e përsëriste shpesh thënien se me zikër ngjallet e këndellet zemra, ashtu sikurse ngjallet bima nga shiu. Zikri është ushqim i shpirtit, ndriçim i zemrës dhe shkël-



qim i mendjes. Me zikër shlyhen mëkatet, zhduket frika nga zemra e njeriut dhe çilen portat e mëshirës. Ai citonte shpesh ajetin e dhjetë të sures 62 “El xhuma”, që thotë: “Përmende shpesh Allahun, që të gjeni shpëtim”. Përmbi gjithçka zikri, përmendja e Zotit të Madhnueshëm, shkëlqen si kurorë. Ai i porosiste besimtarët që të bënin zikër, të përmendnin Allahun dhe të nderonin emrin e Tij në çdo kohë. Nderimi dhe adhurimi i Zotit nuk ka një kohë të caktuar. “Përmendeni Zotin në çdo gjendje që të jeni”. Njeriu në çdo çast mund të jetë në këto katër gjendje:

- I bindur në urdhër e në porosi të Zotit.
- I kapërthyer nga mëkatet.
- I lumtur me të mirat që i ka falur Zoti.
- Në ngushticë e në mjerim.

Në qoftë i bindur e i shtruar ndaj urdhrave dhe porosive të Zotit xh.sh., duhet të përmendë Allahun që e ka sjellë në këtë rrugë të mbarë për t'iu nënshtruar urdhrave të Tij.

Në qoftë i kapërthyer nga mëkatet, duhet të kujtojë Zotin duke i kërkuar falje, pasi të jetë penduar për mëkatet e tij.

Në qoftë i lumtur e i mbushur me të mirat dhe begatitë e Zotit, duhet ta kujtojë Zotin me mirënjohje e falënderim.

E së fundi, në se ndodhet në gjendje të vështirë e në



mjerim, duhet ta kujtojë përsëri Zotin, duhet t'i lutet që t'i japë fuqi për të përballuar me durim e sabër vështirësitë e mjerimit.

Për të gjitha këto arsye, Sheh Ahmeti i porosiste ndjekësit e tij që të shqyrtonin mendimet, veprimet dhe sjelljet e tyre. Ndonëse është krijesa më e bukur dhe më e plotë, ndonëse është ndriçuar me diturinë e mendjen e cila është karakteristika më e vlefshme që e dallon nga të gjitha krijesat tjera të Zotit, sepse i shërben për të dalluar të mirën nga e keqja, njeriu është përsëri i lirë të zgjedhë, është i lirë të veprojë sipas bindjeve dhe mundësive të tij. Prandaj ai bën gabime në mendime e në veprime, herë sepse nuk është i udhëzuar drejtë, herë me qëllim, herë pa dashje e herë nga pakujdesia. Mëshira hyjnore është e pakufi. Por në fushën e dijes, ndonëse Allahu e ka pajisur njeriun me mendje, ndonëse i ka mësuar atij shumë gjëra që e dallojnë nga krijesat tjera, ai përsëri duhet të përpiket që nëpërmjet kapaciteteve që ka, të rritë shkallën e diturisë, të mprehë shqisat, të thellojë gjykimin dhe të kërkojë të formohet gjithnjë shkallë-shkallë, drejtë të panjohurës. Sa i takon fushës së njohjes, sidomos lidhur me të ardhmen, aftësitë mendore të njeriut dhe mundësitë e parashikimit të tij janë mjaft të kufizuara. Ne e kemi gjithnjë të vështirë

të vendosim se si të veprojmë. Madje, gjetja apo parashikimi i një zgjidhjeje të drejtë të problemit që na parashtrahet, për të mos thënë që është e pamundur, është gjithnjë tepër e vështirë. Në thellësitë e së ardhmes, në thellësitë e së panjohurës, mendja e njeriut sheh fort turbullt. Këtu përzihen shumë gjëra. Në themel është kaderi i Zotit. Por menjëherë del një problem. Që njeriu nuk duhet të shkarkojë përgjegjësitë e përpjekjet e veta për të realizuar nevojat dhe dëshirat që lidhen me të ardhmen drejt së panjohurës? A duhet ta lejojë veten të justifikohet përmes kaderit të Zotit? Të mjaftohet me shkrehjen dhe lënien në dorën e Zotit, duke thënë se ai i di hajret dhe ai do të na mësojë si të veprojmë? Zoti i ndihmon ata që përpiqen, ata që punojnë, ata që derdhin djersë, ata që luftojnë në emër të Zotit, por nuk i do e as nuk i ndihmon dembelët. Një i ditur thoshte se lutjet janë dy llojesh: lutjet me fjalë dhe lutjet me punë. Të dytave Allahu u përgjigjet menjëherë, sespe Ai nuk e lë pa shpërblim mundin dhe djersën e derdhur. Por, përsa u takon lutjeve me fjalë, është në dorën e Tij t'u japë përgjigje, në këtë jetë apo në tjetrën.

Pikërisht në fushën e njohjes, mistikët, dijetarët në fushën e fesë zotërojnë aftësi të veçanta për të depërtuar në shkaqet dhe dukuritë pak të njohura apo të dukshme të kësaj jete. Nga copëzat e shpëputura të kujtimeve apo edhe nga ato çfarë ka shkruar Sheh Ahmet Shkodra, mund të theksojmë se pasuesit e tarikatit Alije Rifai kishin shumë besim tek ai. Dhe këto i shpjegojnë me shumë dukuri që janë mjaft të njohura në këtë sekt. Madje, ne jo rrallë kemi dëgjuar se pikërisht nga këto shfaqje të jashtme të mundësive të tyre, bëhen vlerësime dhe interpretime jo të drejta.

Në librin që ne sot po përurojmë, librin e dy miqve të mi, të të ndjerit Haxhi Faik Luli dhe Haxhi Bujar Shehu, ka një informacion shumë të pasur për misticizmin dhe tarikatet e ndryshme, mbështetur në një bibliografi të gjerë e të shfrytëzuar me kompetencë shkencore. Por më lejoni të paraqes disa nga idetë themelore, disa nga shtyllat, bazat fetare mbi të cilat ngrihet tarikati "Rifai". Jam i detyruar ta bëj këtë, sepse me sa shoh ka turbullira në mjaft besimtarë.

Të gjithë ndjekësit e tarikatit "Rifai", si dhe të tarikateve tjera, janë besimtarë të devotshëm islamë. Në Shkodër e më tej, disa veprime të gabuara të disa individëve të veçantë janë përgjithësuar për të gjithë dervishët, për të gjitha tarikatet, e aq më tepër për rifaitë. Kjo nuk është e drejtë. Një besimtar, gjë që edhe mund të ngjasë, qëllon të shkelë rregullat e sheriatit apo të moralit islam, por kjo nuk do të thotë që të gjithë besimtarët janë të tillë. Përkundrazi, edhe ai që gabon i ka të gjitha mundësitë t'i kuptojë gabimet, të kërkojë mëshirë, të bëjë tobe dhe të vazhdojë të besojë me bindje të plotë në mëshirën e pakufishme të

të madhit Zot. Zoti fal, Zoti është mëshirues i madh. Kjo është një normë e përcaktuar qartë në Kuranin famëlartë dhe në traditën profetike.

Për ta kuptuar më qartë këtë, po parashtrojmë idetë themelore në të cilat mbështetet tarikati “Rufai” dhe çfarë predikon Sheh Ahmet Shkodra, themelues dhe prijës i këtij tarikati në Shkodër. Secili mund të sjellë shembuj nga vepra, për të ilustruar këto ide themelore.

- Besimtarët islamë si dhe çdo ndjekës i tarikatit “Rifai”, themelin e besimit të vet e kanë në Kuran dhe në hadithet e Profetit Muhamed a.s.

- Secili prej tyre duhet t’i besojë me bindje të plotë gjash-të të vërtetave të besimit, gjashtë shtyllave apo sharteve të imanit.

- Përveç se “Të madhin Zot e Pejgamberin, vërtetojmë “edhe katër kushte që duhen plotësue: më u falë, me agjë-rue, me dhanë zeqat, N’qoftë zenjin, n’Qabe me shkue e ka detyrë, shumë kupton zemra i bahet pasqyrë”.

- Një kujdes i veçantë i kushtohet edukimit moral dhe sjelljes së besimtarëve, njësimi dhe bashkimit. Është armik i dasisë dhe i përçarjes, në themel vë nderimin për vetveten dhe posaçërisht për të tjerët, qofshin këta edhe të besimeve tjera. Me të drejtë autorët theksojnë në vepër: “Ai me singëritet e pastërti shpirtërore pasqyron e vlerëson maksimalisht drejt, kushtet e fesë Islame, nderimin e veçantë për Profetin Muhamed a.s., rolin e drejtë të tarikateve, domosdoshmërinë e respektimit të besimeve të ndryshme dhe praktikimin e tolerancës ndërfetare”.

- Me shumë interes janë porositë e këshillat për studimin e njohurinë që duhet të kenë besimtarët “që terri të bahet dritë”, “që të luftohet fanatizmi”, “që përmes dëshmive të arrihet shkalla e lartë e njohjes së Zotit “. Ai vetë ishte një shembull në këtë fushë; miq të tij e cilësojnë “i ditur pa hesap”, “i vetmi dijetar”, “det pa fund në dituri” etj.

Më duket se është me vlerë të sqarojmë edhe një problem, me qëllim që të kuptojmë më mirë idetë mistike të Sheh Ahmetit. E gjithë vepra e tij e shkruar, por më tepër sjellja, aktiviteti e këshillat që dha, tregojnë qartë këto ide themelore: Vetëm Allahu i madhnueshëm është i denjë për adhurim, vetëm Allahu është objekt kulti e adhurimi”. Ky është kuptimi mistik i dëshmisë monoteiste “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut”. Sheh Ahmeti, si çdo mistik tjetër në rrugën e vet drejt përsosmërisë, e kupton se dëshira e tij është vetëm Zoti i madhëruar. Njeriu i lumtur që arrin në këtë shkallë, e kupton me bindje e siguri të plotë se: “ Vetëm Allahu është i dashur “. Në këtë rast, mistiku e ka gjetur rrugën dhe digjet e përvëlohet për këtë ideal të shenjtë. Në këto momente të lartësimit shpirtëror, fillon të kuptojë se veprues në realitet është vetëm Perëndia. Në-

përmjet syve të zemrës ai dallon se “Çdo atribut i përsosur është i Zotit të Madhnueshëm”. Pra në jetë, në realitet,tribute dhe cilësi të përsosura ka vetëm Allahu. Mistiku i dehur nga dashuria hyjnore nuk do t’ia dijë për asgjë tjetër që është jashtë Zotit të madhnueshëm, madje as për veten e vet. Ai vuan, pëson, kërkon të takohet me të Amshueshmin. Mistiku është gati të vdesë, por vdekja natyrale nuk e merr përdhunisht; kjo nuk është e lejueshme në fenë tonë. Mistiku pranon vdekjen e vetëdijshme, vdekjen shpirtërore të shprehur me formulën e njohur “Vdisni para se me vdekë”. Kështu ai afrohet, bashkohet, shkrihet shpirtërisht me Allahun, dashurohet mbas tij. Dëshmia për njësinë e Zotit tashmë ka kuptimin: “Vetëm Allahu është i qenë, përveç Allahut nuk ka tjetër të qenë”. Në gjuhën mistike, kësaj shkallë i thuhet “Tehvidi zade”. Siç shihet, kjo shkallë është rrjedhojë e dashurisë së flaktë që duhet të ketë besimtari për Perëndinë e amshuar.

Rrugën për të arritur në këtë shkallë dashurie, Zoti xh.sh. ia tregoi me këtë verset kuranor Profetit a.s.: “O Profeti im, thuaju atyre që pretendojnë se më duan, në qoftë se e doni Allahun, ndiqni rrugën time, që t’ju dojë edhe Allahu ju dhe t’jua mbulojë të metat”.

Përmbajtja e këtij verseti tregon qartë se për të arritur gradën më të lartë të kulturës shpirtërore, në radhë të parë njeriu ka nevojë për të kuptuar dhe për të shmangur të metat e veta.

Dashuria ndaj Perëndisë mund të arrihet duke dashur Profetin e Tij të lartë e duke ndjekur rrugën e tij, se Profeti nuk kërkon ndonjë shpërblim tjetër veçse t’i duam Ehli-Bejtin. Kjo e vërtetë shprehet qartë në versetin e mëposhtëm: “Thuaju, o Profeti Im, popullit tënd besimtar, se ti për dritën që u jep atyre, nuk kërkon ndonjë shpërblim tjetër, veçse t’ia duan të afërmit”.

Prej kësaj kuptohet qartë roli që luan dashuria për Ehli-Bejtin; të gjithë mistikët kanë dashuri për Ehli-Bejtin, vuajnë e mjerohen për vuajtjet e tyre e sidomos në dhjetë ditët e para të hënës së Muharremit, agjërojnë dhe shtojnë ibadetet duke kujtuar tragjedinë e vajtueshme të Qerrbelasë.

Nga sa thamë më sipër, duket qartë roli i Sheh Ahmet Shkodrës si themelues i tarikatit “Rifai” në Shkodër, dallohet personaliteti i tij si Sheh i ditur e autoritar, si njeri i arritur në diturinë, përkushtimin dhe devotshmërinë e tij. Ai ishte shembulli i një besimtari të devotshëm, i përsosmërisë morale, i karakterit të fortë, energjik dhe të pamposhtur, i dashurisë së zjarrtë për Allahun e madhnueshëm e për Profetin a.s. dhe për të gjithë Ehli-Bejtin. Me jetën, veprimtarinë, fjalën dhe sjelljen e tij, ai krijoi një rreth të gjerë miqsh e pasuesish të pasionuar, jo vetëm në Shkodër, por në shumë qytete të Shqipërisë.

Këshilla të arta nga Kurani Famëlartë



“E cilat mirësi të Zotit tuaj po i mohoni”

IMANI

“O besimtarë! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë.”

“Ata që në fillim besojnë dhe pastaj e mohojnë besimin, më pas sërish besojnë dhe sërish e mohojnë besimin dhe thellohen në mosbesim, Allahu, me të vërtetë, nuk do t’i falë dhe nuk do t’i shpjerë në rrugë të drejtë.” (Nisa, 136-137)

ALLAHU ËSHTË I PLOTFUQISHËM PËR ÇDO GJË

“Me të vërtetë, janë përqeshur shumë të dërguar para teje, por ata që përqeshnin i përfshiu ajo me të cilën ata talleshin.”

Thuaj: “Udhëtoni nëpër botë e shihni çfarë dënimi kanë marrë ata që përgënjeshtrojnë (të dërguarit).”

Thuaj: “Kujt i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë?” Përgjigju: “Allahut!” Ai ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën dhe, me siguri, do t’ju tubojë në Ditën e Kiametit, për të cilën nuk ka pikë dyshimi. Ata që kanë humbur shpirtat e tyre, në të vërtetë nuk do të besojnë asnjëherë.”

“E Tij është çdo gjë që pushon natën dhe ditën. Ai dëgjon dhe di çdo gjë.”

Thuaj: “A të marr mbrojtës tjetër, përveç Allahut, Krijuesit të qiejve dhe Tokës? Ai e ushqen (botën), ndërsa Vetë nuk ushqehet”. Thuaj: “Unë jam urdhëruar që të jem i pari që t’i nënshtrohem Atij” dhe kurrësi mos u bë idhujtar!”

Thuaj: “Unë kurrë nuk e kundërshtoj Zotin tim, sepse I frikësohem dënimit të një Dite të Madhe”.

“Atë që shpëtohet nga dënimi i kësaj dite, vërtetë Zoti e ka mëshiruar. Ky është shpëtimi i vërtetë.”

“Nëse nga Allahu të godet ndonjë fatkeqësi, atëherë askush përveç Tij nuk mund të të shpëtojë. E, nëse të dhuron ndonjë mirësi, dije se vetëm Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.”

“Ai është i Sunduesi mbi robërit e Vet; Ai është i Urti dhe ka dijeni për gjithçka.”

Thuaj: “Cila është dëshmia më e madhe (që ti je profet)?” - dhe përgjigju: “Allahu është dëshmitar midis meje dhe jush”. Ky Kuran më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t’ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet. A mos vallë ju dëshmoni se, përveç Allahut ka edhe zota tjerë? Thuaj: “Unë nuk dëshmoj”. Thuaj: “Vërtet, Ai është vetëm Një Zot dhe unë jam larg nga ato që ju ia shoqëroni Allahut (në adhurim)”. (En’am, 10-19)

KUSH JU SHPËTON NGA VËSHTIRËSITË?

Thuaju: “Kush ju shpëton nga errësira e tokës dhe e detit, kur i luteni Atij haptazi dhe fshehurazi (duke thë-

në): “Nëse Ai na shpëton prej këtyre (rreziqeve), vërtet do të bëhemi mirënjohës”.

Thuaj: “Allahu ju shpëton nga ato dhe nga çdo e keqe tjetër, por prapëseprapë ju adhuronit të tjerë veç Tij”.

Thuaj: “Ai ka fuqi t’ju ndëshkojë prej së larti ose nga poshtë këmbëve tuaja, ose t’ju përçajë në grupe e të vuani nga duart e njerëzvet. Shih si ua shpjegojmë shpalljet, që ata të mund të kuptojnë!” (En’am, 63-65)

MJAFTON QË TË THEMI “BËHU”

“Nëse dëshirojmë të bëhet diçka, mjafton që të themi: “Bëhu!” dhe ajo bëhet.” (Nahl, 40)

Një paralajmërim më tepër për të zotët e mendjes

“Allahu është Ai që qiejt i ka ngritur me shtylla, të cilat nuk mund t’i shihni e më pas është ngritur mbi Fron. Ai ka nënshtuar Diellin dhe Hënë; të gjitha këto rrotullohen për një kohë të caktuar. Ai i drejton të gjitha çështjet dhe i shpjegon në hollësi shpalljet, me qëllim që ju të bindeni se do të takoheni me Zotin tuaj.”

“Është Ai që e ka shtrirë tokën, duke krijuar në të male dhe lumenj. Dhe për çdo lloj fruti, Ai ka krijuar nga një çift. Ai ka bërë që nata ta mbulojë ditën. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.”

“Në Tokë ka vise që janë të lidhura njëri me tjetrin, ka kopshte të mbjella me hardhi, ka ara dhe palma me një pip ose shumë pipa, të cilat ujiten me të njëjtin ujë, por disa nga frutet i bëjmë më të shijshme nga të tjerat. Pa dyshim, në këto ka shenja për njerëzit që kanë mend.”

“Nëse ti (Muhamed) çuditesh nga idhujtarët, janë vërtet të çuditshme fjalët e tyre: “Vallë, pasi të bëhemi dhé, do të krijohe mi vërtet përsëri?!” Këta janë ata që nuk besojnë në Zotin e tyre dhe në qafat e të cilëve do të ketë vargonj; këta janë banorët e Xhehenemit, në të cilin do të qëndrojnë përherë.” (Er-Rad, 2-5)

“Ai jua tregon juve vetëtimën, duke ju bërë të frikësoheni e të shpresoni; është Ai që krijon re të rënda (me shi).”

“Bubullima e madhëron Atë me falënderim, por edhe engjëjt, nga frika ndaj Tij; Ai i dërgon rrufetë dhe godet me to kë të dojë; - dhe ata përsëri diskutojnë për Allahun, ndërkohë që Ai është i ashpër në ndëshkime.” (Er-Rad, 12-13)

“Allahut i përulet në sexhde gjithçka që gjendet në



qiej dhe në Tokë, me hir a me pahir, si dhe hijet e tyre i përulen në mëngjes dhe në mbrëmje.

Thuaj: “Kush është Zoti i qiejve dhe i Tokës?” dhe përgjigju: “Allahu!” Thuaj: “A mos vallë, ju zgjidhni për mbrojtës në vend të Tij, ata që nuk mund t’i sjellin vetes as dobi, as dëm?” Thuaj: “A janë të njëjtë i verbëri dhe ai që sheh? Ose a janë njësoj terri dhe drita? Apo ata (idhujtarët) i veshin Allahut ortakë, të cilët krijojnë siç krijon Ai, kështu që krijimi u ngjan i njëjtë atyre (idhujtarëve)?!” Thuaj: “Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është i Vetmi, Ngadhënjimtari.”

“Ai e zbret shiun nga qielli, prandaj rrjedhin lumenjtë me masë dhe rrjedha bart mbeturinat mbi sipërfaqen e ujit. Edhe zgjyra, kur e shkrijnë njerëzit në zjarr që të bëjnë stoli ose vegla, është mbeturinë, si ajo. Kështu, Allahu jep shembullin e së vërtetës dhe të së pavërtetës: Mbeturinat hidhen, ndërsa ajo që u shërben njerëzve mbetet në tokë. Kështu, Allahu i shpjegon shembujt.

“Për ata që i përgjigjen Zotit të tyre, është përgatitur e mira e madhe. Ndërsa ata që nuk i përgjigjen Atij - sikur



të ishte e tyre gjithçka që gjendet në Tokë, madje edhe një herë aq, ata do ta sakrifikonin atë (për të shpëtuar). Njerëzve të tillë u është përgatitur llogari e rëndë dhe strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shtrat i shëmtuar që është ai!”

“Vallë, ai që di se ajo që të është shpallur ty (Muhammed) nga Zoti yt është e vërteta, a është njësoj me atë që është i verbër (ndaj këtij fakti)? Vetëm njerëzit që kuptojnë ia vënë veshin kësaj.”

“Këta janë ata që i përmbahen besëlidhjes me Allahun dhe nuk e prishin premtimin;” (Er-Rad, 15-20)

PËRSE LARGOHENI?

“Me të vërtetë, Allahu është Ai që farën dhe bërthamën e bën të mugullojë. Ai e nxjerr të gjallën prej të vdekurës dhe të vdekurën prej të gjallës. Ky është Alla-

hu. Atëherë, përse i largoheni Atij?”

“Ai bën të feksë drita e agimit. Ai e ka bërë natën për pushim, ndërsa Diellin dhe Hënën për të njehsuar kohën. Kjo është urdhëresa e Allahut, të Plotfuqishmit dhe të Gjithëdijshtit.”

“Është Ai që i ka krijuar yjet, për t’ju rrëfyer rrugën në errësirat e tokës dhe të detit. Ne ua kemi shpjeguar qartë shpalljet Tona njerëzve që dinë.”

“Është Ai që ju ka krijuar prej një njeriu të vetëm, që të jetoni dhe të preheni në tokë. Ne ua kemi shpjeguar qartë shpalljet Tona njerëzve që kuptojnë.”

“Është Ai që lëshon nga qielli ujë, nëpërmjet të cilit Ai nxjerr sythat e çdo bime. Prej kësaj Ne nxjerrim gjelbërim, kokrra gruri në kallinj, palma hurme të ngarkuara me kalaveshë të ulët, kopshte rrushi, ulliri dhe shege, që ngjajnë, por që janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Vështro-ni frytet e tyre kur formohen dhe piquen. Sigurisht që në këto ka shenja për njerëzit që besojnë.” (En’am, 95-99)

KRIJUESI I ÇDO GJËJE

“Vërtet që Zoti juaj është Allahu, i Cili i krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë, pastaj u ngrit mbi Fron, duke drejtuar çdo gjë. S’ka ndërmjetës tek Ai, përveçse me lejen e Tij. Ky është Allahu, Zoti juaj, andaj adhurojeni Atë! Vallë, a nuk po mendoni?!”

“Tek Ai do të ktheheni të gjithë. Premtimi i Allahut është i vërtetë. Ai e zë fill krijimin e pastaj e përsërit atë, që t’i shpërblejë me të drejtë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Sa i përket atyre që nuk besojnë, ata do të kenë pije nga uji i vluar dhe dënim të madh, për shkak se kanë mohuar.” (Junus, 3-4)

“Allahu është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën. Ai lëshon ujë nga qielli e nëpërmjet tij nxjerr fruta si ushqim për ju. Ai i ka vënë në shërbimin tuaj anijet, që me lejen e Tij, ju të lundroni me ato nëpër dete. Ai i ka krijuar lumenjtë për dobinë tuaj e po ashtu edhe Diellin dhe Hënën, që lëvizin vazhdimisht. Ai ka vënë në shërbimin tuaj natën dhe ditën.”

“Ai ju jep gjithçka që i kërkon. Edhe nëse përpiqeni t’i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t’i numëroni dot. Njeriu është vërtet i padrejtë dhe mosmirënjohës.” (Ibrahim, 32-34)

ME GJITHË KËTO MIRËSI

“Është Ai që zbret nga qielli shi, i cili ju siguron ujë për të pirë dhe bën që të rriten bimët, që shërbejnë si ushqim për kafshët.”

“Nëpërmjet tij (ujit) rriten të lashtat, ullinjat, palmat, rrushi dhe fruta të llojllojshme. Këtu ka vërtet tregues (të fuqisë hyjnore) për njerëzit, që kuptojnë.”

“Ai ka bërë që ju ta shfrytëzoni natën dhe ditën, Die-llin dhe Hënën. Edhe yjet janë vënë në shërbimin tuaj me urdhrin e Tij. Njëmend, në këto ka shenja për njerë-zit që mendojnë.”

“Ai ka krijuar në Tokë për ju çdo gjë me ngjyra dhe cilësi të ndryshme. Natyrisht që në këto ka shenja për njerëzit që ua vënë veshin.”

“Është Ai që ju ka vënë në shërbim detin, që ju të hani prej tij mish të freskët dhe të nxirrni nga ai stolitë që mbani. Ti sheh se si anijet e çajnë atë, që ju të kërkon mirësitë e Allahut dhe të jeni mirënjohës.”

“Ai ka vendosur male të palëvizshme në Tokë, që ajo të mos tundet bashkë me ju, dhe ka krijuar lumenj e rrugë për të arritur aty ku synoni.”

“Ai ka vënë edhe shenja të tjera, si dhe yjet, nëpërmjet të cilave njerëzit orientohen.”

“Atëherë, a është njësoj si Ai që krijon, si ai që nuk kri- jon?! A nuk po merrni vesh?”

“Nëse do t'i numëronit mirësitë e Allahut, nuk do të mund t'i llogarisnit ato. Allahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë.”

“Ai di gjithçka që ju fshihni dhe që shfaqni haptazi.” (Nahl, 10-19)

QËLLIMI I GJITHË KËTYRE MIRËSIVE

“Nga ajo që ka krijuar, Ai ka bërë për ju hije; ka bërë për ju streha nëpër male; ka bërë për ju rroba që t'ju mbrojnë nga nxehtësia; ka bërë për ju veshje prej metali për t'ju mbrojtur në luftë. Kështu, Ai i përsos begatitë e Veta mbi ju, me qëllim që ju t'i bindeni vullnetit të Tij.”

“E, nëse njerëzit shmangen, ti (o Muhamed) je i de-tyruar vetëm që të shpallësh qartazi.”

“Ata e dinë dhuntinë e Allahut, por pastaj e mohojnë, se shumica e tyre janë jobesimtarë.” (Nahl, 81-83)

KUR JU GODET NDONJË FATKEQËSI

Allahu ka thënë: “Mos adhuron dy zotëra, sepse Ai është një Zot i vetëm, prandaj frikësohuni vetëm prej Meje!”

“Atij i përket çdo gjë që gjendet në qiej dhe në Tokë, Atij i përket bindja e besimi përherë. A mos vallë, do t'i frikësoheni tjetërkujt, përveç Allahut?”

“Çdo mirësi që keni, është nga Allahu. E, nëse ju godet ndonjë fatkeqësi, prapë nuk keni kujt t'i kërkonin ndih- më përveç Tij.” (Nahl, 51-53)

SEKRETI I MJALTIT

“Allahu zbret nga qielli ujë me të cilin ngjall tokën pasi është tharë! Kjo, në të vërtetë, është shenjë e qartë për njerëzit që duan të dëgjojnë.”

“Në fakt, edhe te bagëtitë ju keni shenja për të mësuar prej tyre. Ne ju japim atë që kanë në barkun e tyre prej ushqimit të përpunuar dhe gjakut: qumësht të pastër dhe të shijshëm për ata që e pinë.”

“Ndërsa nga frutat e palmave dhe të hardhisë, ju për- gatitni pije dhe ushqim të shijshëm. Natyrisht, edhe kjo është shenjë e vërtetë për ata që mendojnë.”

“Zoti yt e frymëzoi bletën, (duke thënë): “Ndërto shtëpi në male dhe në drurë dhe në atë (kosheret) që kanë ngritur njerëzit!”

“Ushqehu me gjithfarë lloje frutash dhe ec rrugës së Zotit tënd përulshëm!” Nga barku i tyre del lëng ngjy- rash të ndryshme, në të cilin ka ilaç e shërim për nje- rëzit. Vërtet që kjo është shenjë për ata që përsiatin.” (Nahl, 65-69)

A ËSHTË I NJËJTË AI QË KA MUNDËSI ME ATË QË S'KA

“Allahu e krahason shembullin e skllavit, që s'ka mu- ndësi për asgjë dhe që është pronë e të zotit me atë që Ne i kemi dhënë plot begati, prej të cilave jep fshehtazi dhe haptazi. A janë njëllor? Lavdi i qoftë Allahut! Shu- mica e tyre nuk dinë.”

“Gjithashtu, Allahu krahason shembullin e dy njerëz- ve, njëri prej të cilëve është shurdh-memec, nuk mund të bëjë asgjë dhe është barrë e pronarit të vet, - kurdo e kudo që ta dërgojë, nuk i sjell asnjë të mirë. A është i barabartë ky me atë që urdhëron për drejtësi dhe ndjek rrugën e drejtë?!” (Nahl, 75-76)



Edukata kreative dhe mësimi

Rrustem Spahiu

Krijimtaria i takon të gjitha lëmeve të jetës dhe është thelbësore për të gjitha aspektet e veprimtarisë njerëzore, por në të njëjtën kohë ajo është shumë e rëndësishme edhe për përparimin e njeriut në përgjithësi. Krijimtaria është një prej bazave themelore mbi të cilat ngrihet koncepti i edukatës.

Në kohën në të cilën jetojmë, ndërkohë që vendet e zhvilluara kanë kaluar nga epoka e industrisë në epokën e post-industrisë, personat krijues nuk mund të gjenden lehtë. Për këtë arsye shtrohet pyetja nëse shkollat tona i japin rëndësi të mjaftueshme edukimit krijues, apo këtë ia lënë rastit. Nëse kësaj i shtojmë konformizmin dhe ndikimin e tij te individ, atëherë, sa është e mundur që krijimtaria të dalë në pah?

KONFORMIZMI

Çdo qenie njerëzore, gjatë jetës i nënshtrohet ndikimeve përsa i takon mënyrës së të menduarit, të ndjerit dhe të vepruarit. Gjithashtu, gjatë ciklit të marrëdhënieve shoqërore çdo individ mundohet edhe të ndikojë mbi të tjerët, në mënyrë që mendimet dhe sjelljet e tyre t'ia përshtasë vetes. Uheldal e përkufizon konformizmin si “Një situatë e cila ndikon tek individët, që të bëjnë një akt të caktuar në atë mënyrë, që ta shohin personat e tjerë, që edhe ata të sillen poashtu.”

Nikola jep përkufizimin si vijon: “Konformizmi mund të përcaktohet si pranim i sjelljes së grupit ose shumicës ngaqë grupi ose shumica e kërkon dhe e pret një sjellje të tillë, ose e prezanton si mënyrë të sjelljes.”

Grupet ndikojnë në mendimin, në ndjenjat dhe sjelljet e anëtarëve të tyre në forma të ndryshme të ndikimit shoqëror.

Nëse shumica e anëtarëve bëjnë gabim të dukshëm, shumica e individëve është e prirë të pajtohet në mënyrë unanime me gjykimin e padrejtë të grupit.

Disa nga faktorët që ndikojnë në konformizëm janë:

- *simpatia e grupit për individin* (në parim, sa më simpatik të jetë grupi për individin, aq më i madh do të jetë konformizmi ndaj normave grupore).

- *vetërespektimi* (individët, të cilët nuk kanë ndjenjë të mjaftueshme vetërespekti, janë të prirur të pranojnë ndikimin e të tjerëve mbi ta dhe shpeshherë të nënçmojnë veten),

- *dëshira për t'i ikur konfliktit* (pranimi i disa gjërave edhe kur ato nuk janë në rregull, vetëm për të mos hyrë në konflikt me të tjerët).

Për t'u pranuar në grupin që dëshirojnë, deri diku edhe fëmijët përgatiten në konformizmin e tyre të parë në jetë, gjegjësisht nëse heqin dorë nga dëshirat e veta nga nevoja për të qëndruar brenda një grupi.

Kur flasim për personalitetin e njeriut konformist, shpesh e përshkruajmë me këto veti: është inferior, dogmatik, joorigjinal, pa personalitet dhe pa vetëbesim. Personaliteti konformist është i prirur drejt vlerave konvencionale, frikësohet të shprehë mendimet e veta, ngaqë beson se anëtarët e grupit mund të mos pajtohen me të.

Crutchfield pohon se, kreativiteti dhe krijimtaria pajtohen ndërmjet tyre. Personi krijues e gjen patjetër fuqinë që t'i kundërvihet detyrimit të grupit dhe të heqë dorë nga botëkuptimet konvencionale. Aktiviteti krijues duhet të udhëhiqet patjetër nga motivet e tij të brendshme.

CYTJA E KRIJIMTARISË

Ekziston ndryshimi ndërmjet krijimtarisë së të rriturve dhe krijimtarisë së fëmijëve. Duke pasur më pak përvojë jetësore se sa të rriturit, fëmijët janë më pak ekspertë, por kanë mënyra më origjinale dhe qëndrime të përbashkëta në lidhje me kryerjen e detyrave. Secili edukator (prind, mësues etj.) duhet ta vërë theksin mbi zhvillimin e mendimit divergjent, i cili si i tillë zhvillohet në norma të lira dhe me përgjigje të larmishme. Në dallim nga mendimi konvergjent, i cili eliminon çdo origjinalitet dhe çon më shpesh nga përgjigja e saktë, mendimi divergjent ndihmon në nxitjen dhe zhvillimin e krijimtarisë së fëmijëve. Mendimi divergjent nuk ka norma të caktuara, ka më shumë zgjidhje dhe prej tyre zgjedh më të mirën. Është me vend thënia e Linus Paulingut, fituesit të dyfishtë të çmimit Nobel: *“Mënyra më e mirë për të fituar ide të mira, është që të fitoni shumë ide”*. Në lidhje me mënyrën se si mund t’i ndihmojmë të rriturit dhe fëmijët për të fituar ide të reja mund të themi:

- kjo është ide e mirë,
- shumë mirë, ta provojmë këtë,
- po, e pastaj,
- më thuaj diçka më tepër për këtë,
- të mundohemi ta provojmë këtë,
- t’ia tregojmë të gjithëve këtë etj.

Përveç kësaj mundemi edhe që:

- t’i japim entuziazëm me vështrimin dhe interesimin që tregojmë ndaj tij,
- ta dëgjojmë dhe të mundohemi ta kuptojmë përse propozon pikërisht këtë gjë,
- të mos e ndërpresim derisa të mbarojë mendimin,
- të vazhdojmë ta zhvillojmë idenë e tij.

Për fat të keq, në shumicën e rasteve tekstet shkollore janë të konceptuara në një mënyrë të atillë që pyetjet e dhëna kanë vetëm një përgjigje të saktë. Zbulimet e shumta vijnë nga përgjigjet e reja. Jemi të vetëdijshëm se shpesh herë bëjmë gabime lidhur me krijimtarinë e fëmijëve; edukatorët më shumë kujdesen për ngritjen e shkallës së zhvillimit të fëmijës, duke e ngatërruar kështu matjen e inteligjencës me matjen e krijimtarisë.

SHKOLLAT, VENDI KU KULTIVOHET KRIJIMTARIA

Spontaniteti është një nga dukuritë e vjetra të qenieve të gjalla dhe parakusht i krijimtarisë. Kjo nuk do të thotë se çdo qenie spontane është krijuese. Gjithsesi, nëse zvogëlohet spontaniteti në çfarëdo mënyre qoftë, krijimtaria nuk mund të dalë në pah. Gjatë procesit të shoqërizimit të tij, fëmija humbet rregullisht diçka nga spontaniteti i vet. Është i njohur fakti se fëmijët parashkollorë janë më krijues, se fëmijët që

shkojnë në shkollë, të cilët përveç presionit edukativ në familje, i nënshtrohen edhe ndikimit intensiv pedagogjik, e ky nuk mund të ketë shumë kujdes në cilësitë personale dhe të nevojave të fëmijëve.

Shkollat, në të cilat kultivohet krijimtaria duhet të kenë këto elemente:

- procesi i prodhimit duhet të vlerësohet më shumë se sa vetë prodhimi dhe rezultatet e punës, sepse është shumë i rëndësishëm fakti se në ç’mënyrë janë vënë nxënësit në punë dhe në ç’mënyrë i kryejnë detyrat.

- fëmijët duhet të kenë guxim t’i këmbëjnë idetë me mësuesin, sepse dëgjimi i mendimit ndryshe dhe pranimi i qëndrimeve të tjera mund të shkaktojnë lindjen e ideve të reja, rritjen e pavarësisë së mendimit të nxënësve, të cilët pastaj mësuesi do t’i orientojë drejt zgjidhjeve të drejta,

- shpeshherë koha e kufizuar i ndërpret idetë e reja, p.sh.: zija e shkollës ndërpret punën e nxënësve, sepse është dhënë shenja për ndërprerjen e orës së mësimi,

- të përgatitet mjedisi në të cilin zhvillohet procesi mësimor sipas nevojave të mësuesit e nxënësve. Mjedisi duhet të jetë i mirë për nxënësit, në mënyrë që ata të jenë të rrethuar nga moshatarë me të cilët kanë marrëdhënie miqësore. Nevojitet përshtatja e temperaturës së duhur, ngjyrat e ambientit rrethues etj.

Krijimtaria te nxënësit mund të zhvillohet në çdo lëndë mësimore, në mënyrë që çdo mësues të mundohet të zhvillojë marrëdhëniet e tij personale me nxënësit, që të mund t’ua ofrojë atyre në mënyrën e tij të veçantë njësinë mësimore. Ka shumë raste kur nëpër shkolla mbingarkohet kujtesa e nxënësve, duke lënë kështu pas dore mënyrat e shumëllojshme të mendimit. Pra, transmetohen kryesisht dituri faktografike, gjë e cila i çon nxënësit në pasivitet. Informatat e pranuar në një mënyrë të tillë pasive mund ta frenojnë krijimtarinë të fëmijët dhe t’i kufizojnë në kërkesën që ata mund të kenë për zgjidhje të reja. Në nxitjen e krijimtarisë, mësuesit duhet të kuptojnë aktivitetin krijues të nxënësve, të mos i mbingarkojë ato dhe të stimulojë sa më shumë kureshtjen e tyre. Mësuesit i kyçin aktivisht nxënësit në procesin edukativo-arsimor në shkollat ku kultivohet krijimtaria. Gjithsesi, roli i mësuesit në promovimin e edukimit krijues është shumë i madh. Për të nxitur krijimtarinë, duhet të kuptojnë patjetër rëndësinë e krijimtarisë për zhvillimin e fëmijës. Krijimtaria nuk duhet të humbasë në etapat e procesit mësimor, por duhet të jetë një prej detyrave më të rëndësishme në punën arsimore edukative. Shpresojmë se nga dita në ditë do të ketë më shumë shkolla që e kultivojnë krijimtarinë, në mënyrë që nxënësit që vijnë në mësimet në shkolla të tilla të jenë më të kënaqur dhe të arrijnë rezultate më të mira.



Trego mirëkuptim

Yashar Kandemir

Cdo njeri i kushton shumë rëndësi vetes së tij. Ai vdes që ta duan të tjerët, ta respektojnë dhe ta nderojnë. Kur gabojmë, presim që të tjerët të na mirëkuptojnë. Ne i duam ata që na kuptojnë dhe ankojemi prej atyre që nuk na kuptojnë. Ta konsiderojmë veten më lart se të tjerët dhe të kërkojmë prej tyre që mos na i vënë regabimet, është sëmundja jonë e pashërueshme. Profetët dhe të mëdhenjtë e fesë janë përpjekur t'i kurojnë këto sëmundje. Ata na këshillojnë që ta nënvleftësojmë egon tonë, t'i vlerësojmë të tjerët dhe të tregohemi të arsyeshëm me ta.

Meqë sëmundja e nxjerrjes në pah të vetvetes është e përgjithshme dhe çdokush pret mirëkuptim nga të tjerët, atëherë le të përpiqemi t'i kuptojmë njerëzit nën udhëheqjen e Profetit tonë të dashur dhe mësuesit tonë të etikës. Halli ynë i pashërueshëm mund të përmirësohet vetëm në qoftë se arrijmë ta bëjmë këtë gjë.

MOS T'U NGJASOSH INJORANTËVE

Hebrenjtë e Medines vinin herë pas here te Profeti dhe i drejtonin atij pyetje nga më të ndryshmet, në mënyrë që të kuptonin nëse ai ishte me të vërtetë profet apo jo, dhe në këtë mënyrë ata i bënë atij një lloj provimi. Një ditë prej ditësh, hebrenjtë erdhën tek Profeti dhe duke bërë sikur po e përshëndesnin, iu drejtuan me shprehjen “samu alejkum” (vdeksh më mirë!), shprehje e cila në pikëpamjen tingëllore është shumë e përafërt me përshëndetjen islame “selamu alejkum” (paqja qoftë me ju!) Profeti nuk e humbi qetësinë dhe ua ktheu atyre me fjalët “alejkum” (Ashtu qoftë edhe për ju!). Mirëpo Aisheja që gjendej e pranishme aty, u prek shumë nga kjo përshëndetje e turpshme e hebrenjve dhe nuk mundi të rrinte pa u thënë atyre “Vdekshi ju më mirë dhe ju mallkoftë Zoti!”. Profeti u përpoq

ta qetësonte gruan e tij duke i thënë:

- Qetësohu Aishe! Trego mirëkuptim (tolerancë) dhe mos u sill ashpër.

Por Aisheja, e cila nuk kishte ndërmend të mbyllte njërin vesh përpara atyre që kishte dëgjuar, i tha Profetit:


- A nuk e dëgjove se çfarë të thanë?

Profeti iu përgjigj:

- Po ti a nuk më dëgjove se si iu përgjigja unë atyre? Ua ktheva me të njëjtën përsëndetje. Kur unë të lutem për ta, lutja ime ka për t'u pranuar, ndërsa kur ata të lutem për keq për mua, dëshirat e tyre nuk kanë për t'u përmbushur. (Buhari, Edeb 29).

I dërguari i Allahut që treguar i kujdesshëm ndaj urdhrit hyjnor, që të mos ngjasonte me injorantët, duke menduar se edhe ata hebrenj që e fyen mund të bëheshin një ditë myslimanë si shumë hebrenj të tjerë që e kishin gjetur rrugën e drejtë. Ai nuk u mor me sjelljet e paedukata të këtyre njerëzve të paedukatë dhe të rëndomë, por i la ata në mendjelehtësinë e tyre e kështu, duke treguar një aftësi të lartë e kish hedhur pas krahësh faktin që ata kishin qeshur me njëri-tjetrin për fjalët e thëna. Kjo është sjellja e njerëzve të mëdhenj. Ashtu siç që shprehur edhe Enes ibn Maliku, i Dërguari i Allahut nuk pati fyer ndokënd, nuk kishte thënë ndonjëherë fjalë të turpshme dhe nuk kishte mallkuar askënd. (Buhari, Edeb 38, 44).

Le të shohim një tjetër sjellje të Profetit (a.s.), sjellje me të cilën ai e shfaq me gjithë bukurinë e vet këtë veçori të tij superiore. Bedeviu Ujejne ibn Hisn, i njohur për veprimet e tij të trasha dhe të paedukata, shkon një ditë tek Profeti për vizitë. Ai e gjen Profetin duke bashkëbiseduar me disa sahabë. Profeti i thanë se Ujejne kërkonte të takohej me të. Ndonëse i rëndë në fjalë dhe në sjellje, ky njeri ishte i pari i fisit të tij dhe ende nuk e kishte pranuar fenë islame. Në qoftë se ai do ta pranonte fenë islame, do ta pranonin gjithashtu edhe shumë pjesëtarë të fisit të tij. Pasi tha që ta lajmëronin për të hyrë brenda, duke dashur t'i paralajmëronte shokët e tij të pranishëm që nuk e njihnin atë person dhe të shmangte mundësinë që ata të fyheshin nga sjelljet e tij, Profeti ua bëri të ditur se personi që do të vinte njëri si njeri i mbrapshtë në fisin e tij. Kur Ujejne erdhi, Profeti e priti shumë mirë e me shumë edukatë dhe e pyeti për



shëndetin dhe punët. I buzëqeshi plot mirësi dhe pasi dëgjoi se ç'kishte për t'i thënë e përcolli me të mirë. Aisheja, e cila po shihte me habi se ç'bëhej aty, nuk diti t'i jepte kuptim sjelljes së Profetit ndaj e pyeti:

- O i dërguari i Allahut! Ti thua se personi nuk është njeri i mirë, por edhe sillesh me të mirë!

I dashuri i Allahut iu përgjigj:

- Aishe! A më ke dëgjuar ndonjëherë të them fjalë të këqija? Një nga personat që do të ndihet shumë keq ditën e kiametit kur të dalë përpara Allahut, është ai person që qëndron larg këshillimit të njerëzve duke ia pasur frikën fjalëve të turpshme që ata flasin." (Buhari, Edeb 38; Muslim, Birr 73).

Profeti u thoshte njerëzve fjalë të ëmbla dhe përmes tyre ua fitonte zemrat, duke krijuar në këtë mënyrë mundësinë që mes tij dhe bashkëbiseduesit të lindte dashuria miqësore. Ajo që bënte Profeti gjatë jetës së tij që edhe arti i fjalëve të buta në rastet kur dëshironte t'i mësonte diçka injorantit apo t'i tërhiqte vëmendjen mëkatarit. Njerëzit e mëdhenj, si shprehje e natyrës së



lartë me të cilën janë krijuar, dinë të sillen mirë edhe me njerëzit e këqinj, në mënyrë që t'u japin atyre mundësinë për t'u njohur me të mirën dhe të bukurën, të virtytshmen dhe sublimen. Të dish të sillesh me njerëzit dhe të hedhësh pas krahëve anët e tyre të pahijshme, është një qëndrim i denjë.

Allahu i lartësuar na mëson se e mira nuk është e njëjtë me të keqen, duke na këshilluar ta parandalojmë të keqen nëpërmjet kryerjes së veprave të mira. Në qoftë se veprojmë në këtë mënyrë, ne mund të bëjmë edhe mik për zemër njeriun me të cilin kemi hasmëri. Allahu na kujton se një gjë të këtillë mund ta bëjnë vetëm ata njerëz që janë burra të vërtetë. (Fusilet, 34-35).

T'UA KUPTOSH GJENDJEN TË TJERËVE

Të kuptosh gjendjen në të cilën gjenden të tjerët, është një art më vete. Meqenëse përmbushja e nevojave morale dhe materiale që kanë njerëzit bëhet shkak për t'u fituar zemrat, atëherë duhet të tregohet kujdes në lidhje me problemet materiale dhe shpirtërore që ata kanë. Jeta e Profetit tonë është e mbushur me she-

mbuj të tillë të bukur.

Gjatë periudhës së Medinës, kur dielli i Islamit nisi të ndriçonte të katër anët e Arabisë, ata që patën fatin të bëhen myslimanë ndjenë nevojën ta mësonin dhe ta jetonin fenë. Nuk ishte e mundur që të dërgohej nga një mësues i fesë në çdo fis. Për këtë arsye, disa fise dërgonin të rinj mendjemprehtë dhe të mirkuptueshëm tek i Dërguari i Allahut për të mësuar fenë. Ata jetonin dhe flinin në xhaminë e Profetit dhe mësonin fenë si nga Profeti ashtu edhe nga ehli Sufe, nxënësit që jetonin vetëm në xhaminë e profetike për të mësuar fenë dhe për ta praktikuar atë. Një prej të rinjve që erdhën nga larg këtu ishte edhe Malik bin Huvejrith. Disa të rinj nga fisi Benu Lejs, në të njëjtën moshë me Malikun, kishin ardhur në Medinë që të mësonin fenë islame. Ata qëndruan plot njëzet ditë. Sado që ata e donin profetin dhe myslimanët që rrinin rreth tij, prapëseprapë filluan të kishin mall edhe për familjet e tyre. Profeti, për të cilin Maliku kujtonte se ishte një njeri shumë i mëshirshëm dhe shumë zemërdhembshur, e vuri re këtë ndjenjë malli që u përvëlonte zemrat. Ai u takua dhe bashkëbisedoi me të gjithë ata të rinj, një e nga një, i pyeti se kush i priste në vendlindje dhe në fund fare u tha se tashmë kishte ardhur koha të ktheheshin pas. Ai kërkoi prej tyre që t'ua mësonin familjeve gjërat që i kishin mësuar aty, që të faleshin ashtu siç e kishin parë profetin të falej, që njëri prej tyre duhej të këndonte ezanin kur të vinte koha e namazit, ndërsa më i rrituri prej tyre të bëhej imam. Pastaj u tha të rinjve të ktheheshin në vendlindjet e tyre. (Buhari, Ezan 18, 49, Edeb 27).

Myслиmani është njeri me sjellje të hijshme dhe që i mirëkupton të tjerët. Si shumëkush, ai mund të jetë drejtues, punëdhënë, mësues apo prind. Ata që e thërrasin "drejtor, pronar, mësues, nënë, baba", kanë nevojë për mëshirë, dashurinë dhe mirëkuptimin e tij. Profeti Muhamed, i cili e donte ymetin e tij më shumë se çdo gjë tjetër dhe nuk ishte i kënaqur të shihte tek vuante bashkësia e tij, është lutur për drejtuesit e mirë dhe i ka mallkuar drejtuesit e këqij. Ai pati bërë këtë dua: "Allahu im! Bëjua jetën të vështirë atyre që i dalin për zot punëve të bashkësisë sime dhe i nxjerrin vështirësi anëtarëve të saj. Mirëkuptoji ata njerëz që i dalin për zot drejtimit të bashkësisë sime dhe tregohen të mirëkuptueshëm me anëtarët e saj." (Muslim, Imare 19).



ÇËSHTJA E FORMIMIT TË NJERIUT ISLAM

Ahmet Tashgetiren

Islami, si fe e ka problem formimin e njeriut të tij. Fillimisht, duhet të përcaktojmë këtë problem dhe ta pranojmë si të tillë.

Në themel të këtij problemi qëndrojnë dy aspekte: së pari, çështja e informimit dhe së dyti, ajo e edukimit. Tani le t'i analizojmë këto dy çështje:

Është një fakt i vërtetë që Islami e ka formuar njeriun e vet të posaçëm. Islami mendon se njeriu është në përputhje të plotë me të vërtetat e një krijimi të tillë. Prandaj, njeriu është paqësor me Allahun, me shoqërinë dhe njerëzit, me veten e tij, me sendet dhe me universin. Ja pra, ky është njeriu i Islamit. Ky është njeriu i paqes... Islami nuk merr në konsideratë një individualitet ngatërrestar. Nëse kundërshtoni Allahun, nuk do të mund ta qetësoni shpirtin tuaj; nëse nuk shkoni mirë me shoqërinë, nuk do t'ju mjaftojë ajri që merrni; nëse nuk jeni në paqe me veten, do t'ju konsumohet dëshira për të jetuar; nëse nuk pajtoheni me universin as toka nuk ju mbart dot... Njeriu kërkon sigurinë dhe siguria mund të arrihet me paqe në të gjitha këto drejtime. Vetë Islami ka për qëllim të ndërtojë paqen në të gjitha këto fusha veprimi.

Besimtar, nga njëra anë do të thotë **“ai që beson”**, në kuptimin e të qenit në varësinë e një botëkuptimi, por nga ana tjetër, do të thotë **“ai që jep siguri, mbështetje”**. Ndërkohë që myslimani nga njëra anë përmban në vetvete kuptimin **“ai që i dorëzohet Allahut”**, por nga ana tjetër mbart edhe kuptimin **“individ, i cili nëse ka siguri, sjell paqe edhe në vendin ku ndodhet”**. Shoqëria e besim-

tarit dhe e myslimanëve është një shoqëri e sigurisë dhe e paqes. Thënë ndryshe, çdo lloj veprimi apo aksioni që dëmton paqen dhe sigurinë, ka lidhje me një mangësi apo dëmtim në individualitetin e Islamit.

Dija Islame përbëhet nga norma shoqërore që kanë të bëjnë me besimin, adhurimin, etikën dhe organizimin e jetës. Informim islam, do të thotë arritje në një strukturim mendor - shpirtëror, që plotësojnë njëra-tjetrën në të gjitha këto drejtime. Strukturimi mendor është arritja e të gjykuarit të vlerave në potencialin Islam, ndërsa strukturimi shpirtëror është përfshirja e të gjitha dijeve marrë në kontekstin shpirtëror...

Unë mendoj se dhënia e dijes Islame fillon me dijen e besimit dhe të akaidit. Kjo është edhe baza e botëkuptimit Islam.

Kur ishte në Mekë, i Dërguari i Allahut u pati dhënë fillimisht myslimanëve të parë **“edukimin e tevhidit”** si burim i çdo lloj lirie. Më pas, vijuan dijet për ahiretin. Natyrisht, ishin edhe dije për profetësinë, shpalljen-Kuranin... Këta përbëjnë gurët anësorë të mendimit njerëzor. Dijet për adhurimin, etikën dhe veprat shqyrtohen në këtë këndvështrim. Sot ka problem në të gjitha këto fusha të dijes.

Gabime në radhitje, mungesa e dijes, dije e mangët, dije e gabuar... Të gjitha këto përbëjnë ishuj të vegjël, shumë të ndryshëm në bagazhin mendor dhe shpirtëror të njeriut.

Kemi të bëjmë me një atmosferë të ngatërruar, në të ci-

Kush nuk di parimet e tregtisë që ka vendosur Islami, të mos bëjë pazar me ne. Atëherë, kush nuk mëson dijet lidhur me jetën e Islamit, duhet të hetohet përse i përket përpikmërisë së tij në këtë drejtim.

lën pandehet se çdo gjë e mësuar është Islam, se Islami është ajo që është mësuar, se çdo gjë dihet pa ditur asgjë... Kjo është si të shpagosh veprimin e atij që s'e sheh.

Në fakt, dijet duhen mësuar sipas radhës dhe në mënyrë të plotë, ndërsa më pas formohet brumi dhe të gjitha bashkohen në një ekuilibër e krijojnë një përputhje me tërësinë.

Nëse dija e tevhidit s'është e plotë, bëhet i pamundur pastrimi i mendjes nga idhujt. Nëse dija e ahiretit s'është e plotë, humbet ekuilibri botë-ahiret... Nëse mes adhurimit dhe tevhidit s'është arritur të krijohet një lidhje e duhur, shpirti i adhurimit humbet; nëse s'është arritur të konceptohet zuhdi, bota humbet kuptimin e saj... Një xhihad dhe shpagim që ka humbur qëllimet lidhur me jetën, kthehet në një gjakmarrje...

Fatkeqësisht, rrugët e informimit të drejtë janë të bllokuara...

Njerëzit mësojnë:

- mllëfin, pa mësuar durimin,
- xhihadin, pa përcaktuar pikën e ndalesës,
- fitimin e parasë, pa mësuar zeqatin,
- dhënien, pa mësuar etikën e infakut,
- vendosjen e parimeve, pa mësuar llogaridhënien para Allahut,
- pjesëmarrjen në drejtim, pa mësuar ndjeshmërinë e besimit,
- ekuilibrimin bashkëshortor, pa mësuar përgjegjësi të tilla si: dhembshurinë, amanetin, mëshirën,
- dijen që do të mburret me shumicën e bashkësisë së pejgamberit, pa mësuar edukimin e fëmijës,
- urdhërin për vepra të mira, pa mësuar përkujdesjen në predikim,
- ndalesat nga të këqijat pa mësuar kufirin ndalues.

Pa mësuar dijet bazë, humbet në çështje të diskutueshme. Pa ditur, zotëron ide...

Omeri thotë: *Kush nuk di parimet e tregtisë që ka vendosur Islami, të mos bëjë pazar me ne. Atëherë, kush nuk mëson dijet lidhur me jetën e Islamit, duhet të hetohet përse i përket përpikmërisë së tij në këtë drejtim.*

Islami është dija e jetës dhe për sa kohë nuk kemi një dije të tillë, kërkojmë të jetojmë një jetë myslimani. Po a është e mundur një gjë e tillë?

Kemi dy burime kryesore të dijes në emër të Islamit... Kuranin dhe të Dërguarin e Allahut. Këto dy burime duhen mësuar gërmë për gërmë. Librat e mëvonshëm Islam dhe personalitetet myslimanë janë komente të këtyre dy burimeve kryesore. Secili prej tyre është një përpjekje e të kuptuarit. Përpjekje për të kuptuar ajetet, përpjekje për të kuptuar shpirtin e jetës së të Dërguarit të Allahut... Kjo kërkon një përpikmëri të tillë në fund të së cilës, thelbësore duhet të jetë formimi i një njeriu që i përngjan më shumë Pejgamberit (a.s.)... Cila është cilësia më parësore e të Dërguarit? Të qenurit mëshirë për botët... Drita e rrugës sonë, lideri ynë, është një pejgamber i mëshirës... Madje edhe xhihadi i tij është për të arritur në mëshirë. Thirrja e tij është një thirrje **"jetëdhënëse"**. Ai na këshillon të synojmë **"mirësinë – bukurinë"**, si në këtë botë dhe në ahiret. Ai na këshillon që të bëjmë përherë një thirrje, një lutje për bukurinë. Të gjitha dijet tona mbliidhen në një qëllim. Guri përpunues i çdo dijeje është Kurani, janë ato që na vijnë nga profeti. Njeriu ka nevojë për një dije, madje edhe për të hetuar dijen e fituar në emër të Islamit mbi bazën e këtyre dy burimeve. Ne jemi të mjeruar në të gjitha këto fusha. Jemi të mjeruar edhe në rang shteti, edhe në rang botëror.

Ç'dije ka marrë njeriu ynë në aspektin e parimeve të besimit dhe si e ka arritur këtë?

Po përse i përket adhurimit, etikës dhe veprave?

Sa njerëz u përpoqën të mësojnë Kuranin përmendësh me të gjitha dijet përkatëse?

Sa njerëz iu përlulën një dijetari për këtë qëllim? Apo sa dijetarë kemi që mund të japin një arsimim të tillë, që kanë akumuluar brendësinë e Kuranit?

Dija që ka rreth Islamit një pjesë e mirë e jona, a nuk përbëhet vetëm nga vendosja e qirinjve në një tyrbe, nga bërja e një kurban apo të lidhja e një cope beze?

Pjesa jonë më e madhe ka mësuar të lexojë mevlud vetëm prapa të afërmeve si një dije e Islamit, apo jo? Ja pra, një pjesë e mirë e jona kemi mësuar urrejtjen, gjuajtjen me grushta dhe revolucionin në emër të Islamit, nisur nga padrejtësitë që jetojnë në mbarë botën.

Sikur të mendonim këtë: le ta mësoj sot etikën e të parit, për të mirën e syve të mi... Nesër të mësoj etikën e gjuhës së Kuranit, për gjuhën time. Ditën tjetër të mësoj drejtësinë e familjes së të Dërguarit të Allahut për raportin tim me bashkëshorten dhe fëmijët... Të mësoj gjendjen shpirtërore të të Dërguarit të Allahut, që t'i jap rrugë zemrës sime... Kjo është dija Islame. Jemi të varfër në këtë drejtim, gjë që na pengon të bëhemi myslimanë të vërtetë.

Përsa i përket etikës... Islam, në të njëjtën kohë do të thotë edukatë.

Të gjitha këto dije, i japin njeriut një kuptim brenda një rregulli etik. Përsa kohë që librat nëpër rafte nuk hapen, edhe po të rrinë një mijë vite aty nuk i japin asgjë njeriut. Edhe liderët harrohen në faqet e historisë si individualitet historike.

Islami kërkon ta kthejë dijen në etikë, që të arrijë në strukturimin e brendshëm të njeriut. Mirëpo në këtë fushë ka shumë probleme.

Probleme ka në të gjitha fushat ku do të formohet individualiteti i njeriut.


Atëherë si do ta edukojë Islami njeriun? Si do arrihet tek njeriu i Islamit? Si do flitet për një shoqëri islame?

Është gjë e drejtë që njerëzit janë në kërkim. Është një realitet, që njerëzit të cilët kanë përkujdesjen që u ka dhënë Islami, me qëllimin për ta vënë dijen në praktikë kanë bërë përpjekje për formimin e mjeteve të etikës si për individualitetet e tyre, ashtu edhe për njerëzit për të cilët janë përgjegjës. Por, që të gjitha këto përpjekje të japin fryte, duhen shmangur pengesat.

Koherenca e prindërve në familje për t'i vënë në praktikë dijet, roli përcaktues i Islamit në raportin familje – shkollë, kthimi i xhamisë nga një ambient adhurimi në një qendër shoqërore, dhënia e një edukate pozitive të kulturës së lagjes dhe misioni pozitiv i mediave...

Nëse nuk ekzistojnë këto dukuri, për ç'etikë mund të bëhet fjalë në lidhje me arritjen në individualitetin e një myslimani?

Në të kundërt, mund të flitet për njerëz me personalitete të cënuara. Kështu bie edhe përqindja e njerëzve të Islamit. Madje, ndoshta del në pah një strukturë që hijëzon me etiketa të tjera veçoritë e Islamit. Tiparet dalluese të karakterit që fitojnë njerëzit nga kultura të ndryshme, fillojnë të shfaqen si pjesë e identifikimit Islam. Kjo është edhe arsyeja që shumë njerëz të cilët duken si parimorë të Islamit, shfaqin sjellje që nuk përputhen me Islamin dhe pastaj gjykohen me një pyetje të tillë: "A i ka hije kjo, jetës tende prej myslimani?... Psh, një njeri i cili kryen obligimin e haxhit dhe të namazit sipas Islamit, por që ndërkohë



në marrëdhëniet e punës shfaq vlera kapitaliste... Apo një figure, fjalët e së cilit janë nga Islami, shpirti dhe ndjesitë nga akideja e Islamit, ndërsa kënaqësitë të përcaktuara nga prirjet fizike... Një karakter, përkatësia e të cilit është nga Islami, misioni nga parimet farefisnore, mënyra e sjelljes nga ndikimet zonale... Të gjitha këto tregojnë një përzierje etike.

Kur kërkojnë një vend edukimi më original në projektionin e Daru'l Erkam, thënë më qartazi kur u drejtohen formave mistike, njerëzve u dalin përpara kurthe të tjera. Ndoshta me kënaqësinë e një urie shpirtërore, arrihet në ato rrugë që s'janë aspak të shëndetshme, ndërkohë që e fshehta e kësaj pune është të gesh udhëzuesit që kanë dije dhe edukatë. Nga edukata e mirëfilltë, kalohet shumë larg, në dhimbje shpirtërore.

Si përfundim, është e nevojshme të thuhet se Islami është një vërtetësi e pashmangshme. Në individualitetin e njeriut, Islami është një vlerë e pashmangshme. Formimi i një vendi, edukimi, si për informimin ashtu edhe për formimin e njeriut, në këtë aspekt, është një proces i pashmangshëm për kthjelltësinë shoqërore. Çdo lloj pengese në këtë drejtim, në fund të fundit, është e dëmshme për të ardhmen.



Një Ajet

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

Thuaj: “O Zoti im! Ma shto dijen!” (Taha 114)

Allahu i Lartmadhëruar nuk e urdhëroi Pejgamberin (a.s.) që t’i lutej për shtimin e ndonjë gjëje tjetër përveç diturisë. Kjo pasi dija është një thesar i pafund. Dituria është frytdhënëse jo vetëm për zotëruesin e saj, por edhe për njerëzit e tjerë, madje edhe për të gjitha qeniet e gjalla. Dituria është mjeti më i rëndësishëm për të ndarë të vërtetën nga e shtrembra. Shtimi i diturisë s’është një peshë e rëndë për njeriun, përkundrazi është një virtyt lartësues për të. Me shtimin e diturisë, tek njeriu rritet modestia, njeriu shpëton nga disa gjëra të panevojshme, kupton të vërtetën dhe tregon kujdes që të bëhet një njeri i mirë. E kundërta e dijes është injoranca, e cila është e papranueshme.

Thuaj: “A mund të jenë të njëjtë ai që di me atë që nuk di?” (Zumer 9)

Nëpërmjet këtij ajeti Kuranor, Allahu Teala na tregon se dituria është diçka e lavdërueshme, duke na shpjeguar vlerën dhe superioritetin e saj, ashtu sikurse tregon edhe se injoranca është diçka e ulët dhe e mangët. Njeriu i ditur i bindet Allahut, ndërsa injoranti është kryelartë. Këta janë të kundërtat e njëra-tjetrës, ndërkohë që bindja është virtyt, kryelartësia është rrënim. Çdo lloj injorance është kundërshtuar dhe është nënvlerësuar në fenë tonë. Kjo pasi çdo element i injorancës ka mohim dhe kryelartësi. Arsyeja se pse është quajtur periudha para Islamit si periudhë e injorancës, është se i gjithë populli mohonte njësinë e Zotit dhe tregohej kryelartë ndaj Tij.

Dituria e saktë dhe e vërtetë e pastron njeriun nga shirku dhe e bën atë të dalë para Allahut si një rob i vërtetë. Në të kundërt, individit ka të meta dhe mangësi në dijen e tij. Injorant nuk është vetëm ai që s’di shkrim e lexim, sikurse pandehin sot disa njerëz, por është edhe ai që nuk heq dorë nga mohimi i Zotit të Lartmadhëruar dhe nga shfaqja e kryelartësisë ndaj Tij.

“Allahu do t’i ngrejë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija” (Muxhadele 11)

Allahu i lartëson gradët shpirtërore të atyre që besojnë tek Ai dhe të atyre që veprojnë në përputhje me urdhrat e Tij. Në këtë jetë ata i bën që të jenë të suksesshëm, ndërsa në ahiret do t’i shpërblejë me katet më të larta të xhenetit. Allahu Teala edhe dijetarin që jeton në përputhje me diturinë e tij, gjithashtu do t’i dhurojë gradët më të larta shpirtërore. Ajeti kuranor i mësipërm është një argument i qartë që tregon vlerën e diturisë dhe dijetarëve tek Allahu. Në Kuranin famëlartë ka shumë ajete që theksojnë epërsinë e diturisë dhe dijetarëve. Në lidhje me këtë temë ka me qindra hadithe të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Një Hadith



Transmetohet nga Ebu Hurejra radijallahu se

Resulullahu sallallahu alejhi ve sellem ka thënë:

“Besimi përbëhet nga gjashtëdhjetë ose shtatëdhjetë degë. Më e larta e këtyre është fjala “la ilahe ill Allah” ndërsa më e ulëta është të heqësh nga rruga gjërat që dëmtojnë njerëzit. Edhe turpi është një nga degët e besimit.” (Buhariu, Iman 3; Muslim, Iman 58)

Shpjegime

Profeti ynë i dashur e krahason besimin me një pemë të shëndoshë që i ka rrënjët në zemër. Disa nga degët e kësaj peme janë ato çfarë duhet të zotërojë një besimtar, p.sh. gjashtë bazat e besimit: dashuria për Allahun, falenderimi i Tij, durimi ndaj vështirësive dhe largimi nga veset e këqija, si: urrejtja, zilia, zemërimi dhe tradhtia.

Disa nga degët e besimit janë edhe fjalët që duhet të shqiptojë një besimtar. Shqiptimi i shehadetit, mësimi dhe dhënia e diturisë dhe përmendja e Allahut, janë disa nga këto.

Ndërsa disa degë të tjera të besimit janë veprime që duhet të kryejë një besimtar. Disa prej këtyre janë pesë bazat e Islamit: pastrimi, mbrojtja e nderit, kryerja e obligimeve ndaj prindërve, familjes, fqinjëve, si dhe heqja e gjërave nga rruga nëse ato dëmtojnë njerëzit.

Resulallahu (s.a.v.s) thekson se në bazë të çdo veprimi tonë, qëndron besimi. Ai thotë se në krye të kushteve të besimit qëndron shqiptimi i shehadetit, pra fjala **la ilahe illallah**, prej të cilës nuk mund të hiqet kurrë dorë. Pastaj na flet për ndjenjën e turpimit duke e trejtuar atë si një rën prej cilësive dhe degëve të pazëvendësueshme të besimit që e bën njeriun besimtar të vërtetë. Prandaj, besimtari duhet të ruhet nga veprimet e turpshme dhe të indinjohet, kur veprime të tilla kryhen nga të tjerët.

Ky hadith na përkujton detyrimet tona të rëndësishme, si dhe na informon për shpërblimin hyjnor që do të përfitojmë në rast se i kryejmë këto detyra. Nëse një punë e lehtë si largimi prej rrugës i një guri apo i një ferre na bën të fitojmë kënaqësinë dhe mëshirën e Allahut të Madhërishtëm, a është e mundur të imagjinohet vlera dhe shpërblimi që ka pranë Allahut një punë më e rëndësishme?

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Të gjitha veprat që duhet të kryejë një besimtar janë të lidhura drejtpërdrejt me besimin.
2. Meqenëse të gjitha obligimet me të cilat na ka ngarkuar Allahu i Madhëruar kanë lidhje me besimin, ne nuk mund t'i ndajmë ato prej njëra-tjetrës.
3. Ndjenja e turpimit nuk është një dobësi, por një cilësi e pazëvendësueshme, e cila e lartëson dhe e plotëson besimin.

HAZRETI ALIU (R.A.)

Hazreti Aliu (r.a.), lindi brenda në Qaben e madhërueshme, gjë me të cilën nuk është nderuar askush tjetër në faqen e kësaj toke.¹ Ngase familja e tij ishte shumë e madhe, atë e mori Profeti (a.s.) në kujdesin e tij, kështu që qysh në moshën pesë vjeç ai filloi të edukohej nga profeti ynë i dashur. Kësisoj ai pa u përljer hiç nga traditat e ndyra të periudhës së injorancës, u bë fëmija i parë që pranoi islamin.

Pasi Pejgamberit (a.s.), filloi t'i vinte shpallja, ai shkante çdo vit në panairin që bëhej rreth Qabes në periudhën e haxhit, për t'i ftuar njerëzit që të hynin në islam dhe merrte me vete ose Hazreti Aliun ose Hazreti Ebu Bekrin. Kur Hazreti Aliu ngelte prapa, shkante për terezi të vet në Qabe dhe thyente disa idhuj, për t'u kthyer mandej sërish te profeti Muhamed, (a.s.).

Në periudhën e hixhretit, Hazreti Aliu (r.a.), bëri një sakrificë shumë të madhe. Për t'ua shpërqendruar vë-

mendjen atentatorëve që kishin rrethuar shtëpinë e Hazreti Profetit dhe që kishin si qëllim ekzekutimin e tij, veshi herkën jeshile të Hazreti Pejgamberit (a.s.), dhe u shtri pa frikë në shtratin e tij.

Hazreti Aliu (r.a.), pasi kreu disa porosi që i kishte lënë Hazreti Pejgamberi (a.s.), u nis me mall për në Medine. Udhëtimi ishte shumë i vështirë, sepse duhej bërë natën. Kështu, ai arriti me këmbë të enjtura tek profeti, aq i dashur për të.

Në vitin e dytë të hixhrit, me urdhër të Allahut, Hazreti Aliu (r.a.), pati fatmirësinë të martohej me Hazreti Fatimenë. Kështu ai pati fatin të bëhej dhëndri i Profetit dhe një nga pjesëtarët e **Ehli Bejtit**².

MBRETI I BUJARISË

Hazreti Aliu (r.a.), nuk u dha shpirtërisht asnjëherë pas kësaj dynjaje të rreme, sepse ai u edukua nga vetë Resulullahu. Shfaqjet e vëllazërisë dhe të empatisë ishin të pranishme në jetën e tij si askund tjetër. Profeti Muhamed, (a.s.), ka thënë:

"Allahu kur ia don të mirën dikujt, e bën atë të përparojë në rrugën e shërbimit dhe të kryerjes së nevojave të të tjerëve." (Sujuti, II, 4/3924)

Me dëshirën për t'u përfshirë në sihariqin në fjalë të Profetit, Hazreti Aliu (r.a.), është shprehur:

"Ka dy mirësi prej të cilave nuk jam i sigurt se cila më gëzon më tepër. E para është ardhja e një njeriu tek unë me mendimin se mund ta ndihmoj në kryerjen e hallit të tij, pra të kërkuarit nga unë ndihmë me gjithë shpirt."

¹.. Hakim Mustafiz, III, 549.

².. Kështu quhet familja e Profetit.

**"Allahu kur ia don të mirën
dikujt, e bën atë të përparojë
në rrugën e shërbimit
dhe të kryerjes së nevojave
të të tjerëve."**

E dyta është kur Allahu më bën mua mjet për t'ia kryer nevojën atij, apo për t'ia lehtësuar atë hallin që ka. Më shumë preferoj të mund t'ia kryej një punë apo një hall një vëllai mysliman, sesa të kem si pasuri një dynja me ar apo serm." (Ali el-Muttaki, Kendhul-Ummal, VI, 598/17049)

Ja disa shembuj që tregojnë praktikisht moralin e tij të lartë.

Një ditë Hazreti Aliu e pyeti bashkëshorten e tij të nderuar:

"- Më ka marrë shumë uria, a ka diçka për të ngrënë në shtëpi?"

Hazreti Fatimeja i tha Hazreti Aliut se nuk ka asgjë për të ngrënë, se në shtëpi ka vetëm gjashtë akçe³. Atëherë Hazreti Aliu mori gjashtë akçet dhe doli për të blerë diçka për të ngrënë. Gjatë rrugës vuri re se një njeri po grindej me një mysliman dhe po i thoshte:

"- Më jep borxhin, ose eja të shkojmë bashkë tani në gjykatë!"

Pavarësisht se borxhliu kërkoi nga borxhdhënësi që t'ia shtynte pak afatin e pagesës, ky i fundit as që dëshi t'ia dinte. Hazreti Aliu, i cili u gjend krejt rastësisht pranë atyre që po grindeshin, i pyeti:

"- Për çfarë shume po grindeni?"

"- Për gjashtë akçe." - u përgjigjën ata. Atëherë, ndonëse ishte edhe vetë nevojtar për ato gjashtë akçe që kishte, Hazreti Aliu ia dha menjëherë borxhdhënësit, duke e nxjerrë myslimanin nga situata e vështirë në të cilën ndodhej. Pas kësaj filloi të mendonte se çfarë do

t'i thoshte Hazreti Fatimesë. Por, tekembramja, Hazreti Fatimeja është vajza e profetit dhe sigurisht që do të tregojë mirëkuptim, - mendoi me vete dhe u drejtua për në shtëpi.

Kur arriti në shtëpi ia tregoi ndodhinë, Hazreti Fatimesë. Zonja e nderuar tha:

"- Shumë mirë paske bërë, el-hamdu lillah, paske shpëtuar një mysliman nga burgu. Neve na mjafton Allahu." Por ajo edhe u mërzi. Hazreti Aliu vërejti menjëherë mërzinë e Hazreti Fatimesë e gjithashtu lotët në sytë e fëmijëve të uritur për vdekje. Ndjeu një shqetësim të brendshëm për gjithë çfarë ndodhi dhe doli jashtë me një mendim: "Po shkoj tek Profeti. Do ta harroj këtë vuajtje duke parë fytyrën e nurtë të bukurisë së tij profetike". Gjatë rrugës, teksa po ecte mendueshëm, Ai hasi në rrugë një njeri që kishte një deve të majme. Ky njeri i tha Hazreti Aliut:

"- Këtë deve dua ta shes, a dëshiron ta bleësh?"

Edhe pse Hazreti Aliu i tha atij që nuk kishte asnjë lek në dorë, ai ia shiti devenë veresie Hazreti Aliut për njëqind akçe. Sapo Hazreti Aliu u largua pak me devenë në dorë, në rrugë u shfaq një tjetër njeri, i cili e pyeti:

"-A mund të ma shesësh këtë deve për treqind akçe?"

Hazreti Aliu pranoi dhe ia shiti. Meqë devenë e shiti me lekë në dorë, shkoi në Pazar, bleu diçka për të ngrënë dhe pastaj u kthye në shtëpi. Me të mbërritur në shtëpi ia shpjegoi Fatimesë çfarë i kishte ndodhur. Hëngrën dhe të gjithë së bashku falënderuan Allahun me gjithë zemër. Më pas, Hazreti Aliu doli nga shtëpia dhe shkoi tek Hazreti Pejgamberi. Pejgamberi

3.. Parë e asaj kohe.



(a.s.), e pyeti:

“- O Ali! A e din kush ta shiti dhe kush ta bleu devenë?”

“- I Dërguari i Allahut e di më së miri.” – iu shpreh Hazreti Aliu. Hazreti Pejgamberi tha:

“Ai që ta shiti devenë ishte Xhebraili (a.s.), ndërsa ai që ta bleu, ishte Israfili (a.s.). Kurse deveja ishte një deve prej atyre të xhennetit. Allahu i Lartmadhëruar ta shpërbleu me pesëdhjetëfish në këtë dynja mirësinë që i bëre atij myslimanit. Kurse në botën tjetër do të të shpërblejë me aq sa vetëm Ai e di.”⁴

Sipas një transmetimi të Ibn Abbasit, Ata (r.a.) ka thënë:

Një herë, Hazreti Aliu ujiti për tërë natën një bahçe me hurma për të fituar një sasi të caktuar elbi. Kur gdhiu, mori atë sasi elbi që ishte haku i tij i punës dhe erdhi në shtëpi. Një të tretën e sasisë së elbit që fitoi Hazreti Aliu atë natë, e blujtën të gjithë së bashku si familje, që të gatuanin një ushqim të veçantë që quhej “hazira”. Pasi përgatitën hazirën, u duk në derë një i varfër që kërkonte ushqim. Ata i dhanë ushqim nga ai që kishin pjekur e bërë gati. Më pas morën një të tretën e dytë të elbit që Hazreti Aliu kishte fituar duke punuar tërë natën, e bluan dhe e gatuan për ta ngrënë. Në atë çast ia behu një jetim, që kërkoi përsëri diçka për të ngrënë. Ata ia dhanë menjëherë jetimit atë që kishin përgatitur për të ngrënë vetë. Filluan ta bluanin e ta përgatisnin pjesën e mbetur të elbit. Pasi ushqimi u bë gati, u shfaq në derë një i mushrik i zënë rob, që i kërkoi



përsëri diçka për të ngrënë. Sasinë e fundit të ushqimit ia dhanë atij e kësisoj e kaluan atë ditë të uritur.

Sipas një transmetimi tjetër, kjo histori ka ndodhur kur Hazreti Aliu së bashku me familjen e tij kanë qenë agjërueshëm. Tre të varfërit, pra fakiri, jetimi dhe skllavi kanë ardhur në prag yftari. Ushqimi u është dhënë këtyre të varfërve të sipërpërmendur, ndërsa pjesëtarët e kësaj familjeje të nderuar e kanë bërë yftarin vetëm me ujë. Kjo ngjarje u bë shkak për shpalljen e këtyre ajeteve:

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura. Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim.” (el-Insan, 8-11) (Vahidi, Esbabu Nuzul, s. 470; Zemahsheri, el-Keshshaf, VI, 191-192; Razi, XXX, 244)

Për këtë arsye, në lidhje me Hazreti Aliun, Hazreti Pejgamberi (a.s.), është shprehur se ai është **“Sultanu’l-Es’hija”** që do të thotë “Mbreti i Bujarëve”.

Hazreti Aliu është shquar në mesin e sahabeve të tjerë sa për sakrificën dhe bujarinë, aq edhe për diturinë, edukimin shpirtëror, vendimet e tij të sakta, si dhe për guximin dhe trimërinë.

LUANI TRIUMFUES I ALLAHUT

Hazreti Aliu mori pjesë në të gjitha luftat dhe tregoi trimëri e heroizëm të pashoq. Vetëm në luftën e Tebukut nuk pati mundësi të merrte pjesë, sepse

4.. Shih. Ramazani, Mahmud Sami, Hz. Alijju’l Murteza, sf. 119-122.



“Trim i vërtetë nuk është ai që e mund kundërshtarin e tij në dyluftim, por ai që arrin ta mbajë veten nën kontroll, kur nevrikoset.”

Hazreti Pejgamberi (a.s.), e la të ruante myslimanët që do të qëndronin në Medinë, si dhe të ruante Ehli Bejtin e të kujdesej për të. Ai ashab i nderuar dhe i njohur prej gjithkujt për trimërinë e guximin e tij, e pyeti me zë të mekur Hazreti Pejgamberin:

“- O i Dërguari i Allahut! A po më lë mua me gratë e fëmijët, që të kujdesem për to?”

Hazreti Pejgamberi (a.s.), e ngushëlloi duke i thënë:

“- O Ali! Ti je për mua çfarë Haruni ishte për Musanë! Por ama pas meje nuk ka pejgamber tjetër.”⁵

Sipas traditës arabe, çdo ushtri nxirrte për dyluftim në fushëbetejë luftëtarët më me emër dhe me të shquar në trimëri dhe heroizëm. Hazreti Pejgamberi (a.s.), e nxirrte Hazreti Aliun në çdo betejë ku ai ishte pjesëmarrës. Me ndihmën e Zotit, Hazreti Aliu triumfonte përballë çdo luftëtari armik. Për të theksuar këtë cilësi që manifestohej tek Hazreti Aliu me dëshirën e Allahut, ai është emërtuar me shprehjen **“Esedullahi'l Galib”** (Luani triumfues i Allahut).

Sigurisht, në themel të trimërisë së Hazreti Aliut qëndron edukimi shpirtëror që Hazreti Pejgamberi i kishte dhënë atij që në fëmijëri. Hazreti Pejgamberi ka thënë:

“Trim i vërtetë nuk është ai që e mund kundërshtarin e tij në dyluftim, por ai që arrin ta mbajë veten nën kontroll, kur nevrikoset.” (Muslim, Birr, 107)

Duke jetuar me vetëdijen se trimi i vërtetë është ai që del fitimtar në betejën me egon e tij, Hazreti Aliu u bë shembulli i gjallë i këtij hadithi.

Gjatë një beteje, Hazreti Aliu e kishte vënë nën vete kundërshtarin e tij. Duke e parë veten në prag të vdekjes, kundërshtari vendosi ta fëlliqte Hazreti Aliun duke e pështyrë në fytyrë.

Luani triumfues i Allahut, Hazreti Aliu u ndal dhe, duke pasur frikë se në këtë rast do të mund ta vriste kundërshtarin thjesht për të përmbushur egon e tij, hoqi dorë nga vrasja e armikut.

Kjo gjë bëri shumë ndikim tek kafiri, i cili krejt papritmas vuri re se u la i lirë pikërisht në çastin kur po vritej nga Hazreti Aliu. Ai e harroi luftën dhe të gjithë armiqtë që kishin me njeri tjetrin deri para pak minutash dhe e pyeti Hazreti Aliun se për ç'arsye e bëri këtë. Ai iu përgjigj kështu:

“- Lufta jonë është dy llojesh: e para është lufta me të ngjashmit e tu, pra me kafirët, luftë që bëhet për hir të Allahut të Lartmadhëruar. Lloji i dytë i luftës sonë është lufta me egon, e kjo luftë synon që të arrijmë të kemi në dorë frerët e ndjeshmërive tona. Lufta me ty ishte një luftë që unë po e bëja për hir të Allahut. Mirëpo kur ti më pështyve, m'u zgjua në mënyrë të natyrshme egoja, arsye për të cilën rrezikoj të të vrisja jo më për hir të Allahut, por për hir të egos sime. U frikësova prej kësaj, prandaj u ndala, nuk të vrava, por të dhurova lirinë. E mora egon nën kontroll dhe triumfova ndaj saj, duke dalë kështu fitimtar në luftën më të madhe, atë ndaj vetes. Dëmi që mund të bëjë një besimtar që është skllav i egos së vet, është më i madh se dëmi që mund të bëjë një kafir si puna jote.”⁶

5.. Shih Ramazanoglu Mahmud Sami, Hz. Aijju'l-Murteza, fq. 54.

6.. Shih. Ramazanoglu Mahmud Sami, Hz. Aliu i Murteza, fq. 117.



Nga kjo përgjigje e Hazreti Aliut u ndriçua zemra e jobesimtarit, iu hapën sytë ndaj të vërtetës islame dhe hyri menjëherë në të vetmen fe të Zotit. Më pas, ky njeri mori pjesë në disa luftra së bashku me Hazreti Aliun kundër jobesimtarëve. Ai që deri dje ishte jobesimtar, luftoi me gjithë shpirt kundër egos së tij e gjithashtu kundër armiqve të islamit, pa e përzier zemërimin që i buronte nga islami me zemërimin apo shqetësimin që i buronte nga egoja e tij.

Në fushëbeteja të ndryshme Hazreti Aliu shfaqte trimëri dhe heroizma të jashtëzakonshme, por nga ana tjetër ai i kushtonte një rëndësi të veçantë përkushtimit në adhurim, duke kryer me qetësi e kënaqësi të madhe shpirtërore çdo obligim adhurimi. Në njërën prej luftrave, Hazreti Aliut i ngulet në këmbë një shtizë. Sado që shokët u përpoqën t'ia shqitnin nga këmba, prapëseprapë nuk arritën, pasi nuk i lejoi dhembja që i shkaktonte Hazreti Aliut. Atëherë Hazreti Aliu (r.a.), u tha:

“- Unë po filloj të fal namaz dhe ju gjatë kohës që falem, më nxirrni shtizën nga këmba!”

Bënë ashtu siç u tha Hazreti Aliu. Në këtë mënyrë mundën t'ia hiqnin shtizën nga këmba pa hasur vështirësi. Pasi dha selam duke përfunduar faljen e namazit, Hazreti Aliu i pyeti shokët:

“- Çfarë bëtë, pse nuk e hoqët?”

Shokët e tij iu përgjigjën:

“- Ta hoqëm shtizën nga këmba teksa po faleshe!”

Hazreti Aliu (r.a.), falej me aq shpirt e përkushtim tek i Madhi, sa që harronte krejtësisht dimensionin e tij fizik dhe zhvishej krejtësisht nga tokësorja...

**“Qetësoni shpirtërat tuaj
me fjalë të urta e me fjalë që të
bëjnë të mendosh!
Ashtu siç lodhen trupat, ashtu
lodhen edhe shpirtat.”**

PREJ QABES NË MESXHIDIN E KUFES...

Pasi Hazreti Pejgamberi (a.s.) ndërroi jetë, Hazreti Aliu (r.a.), ndihmoi me aq sa pati mundësi halifet që u zgjodhën në krye të shtetit. Ai është gjendur në kuvenimet e tyre dhe ka dhënë mendimet e tij të thella e të sakta, të cilat në pjesën më të madhe të herëve janë marrë në konsideratë.

Pas vrasjes së Hazreti Osmanit (r.a.), nga rebelët, me insistimin e shumë as'haveve Hazreti Aliu pranoi hilafetin. Me të marrë detyrën e halifit puna e parë që bëri Hazreti Aliu, ishte transferimi i qendrës së shtetit nga Medineja për në Kufe. Të gjithë besimtarët ishin të mërzitur tek shihnin se Medineja, një qytet i mbushur me kujtimet e të Dërguarit të Allahut po bëhej skenë e përleshjeve politike. Hazreti Aliu e mori këtë vendim për ta ruajtur Medinen e për ta lënë atë qëndër diturie dhe paqeje. Atë pjesë jete që i kishte mbetur pasi shkoi në Kufe, e kaloi mes grindjeve, përçarjeve, intrigave dhe kaosit të përgjithshëm politik.

Një herë e pyetën:

“- O prijës i besimtarëve! A më jepni leje që, me dëshirën time, të bëhem ruajtësi juaj?”

Ndërsa Hazreti Aliu është përgjigjur:

“- *Ruajtësi i njeriut është exheli i tij!*”

Disa ditë para se të ndërronte jetë, duke e parashkuar vdekjen e vet, ai ndërpreu ngrënien dhe pirjen. Atyre që e pyesnin se përse e kish ndërprerë të ushqyerit dhe të pirët, i thoshte:

“*Dëshiroj që urdhri i Allahut të më gjejë të uritur.*”

Pa kaluar shumë kohë, në Mesxhidin e Kufes, teksa



po falte namazin e sabahut, Hazreti Aliu plagoset për vdekje nga Ibn Mulxhem. Kur ndodhi kjo ngjarje, ai ishte në moshën 63 vjeç.

Kur Hazreti Aliu dergjej në shtrat nga plagët, Xhundeb bin Abdullah afrohet dhe i thotë:

“- O prijësi i besimtarëve! Allahu mos na lëntë kurrë pa ty, por nëse Ai ka vendosur të të marrë afër Vetes, atëhere ne të japim besën se do të pranojmë si halife djaln tënd Hasanin.”

Hazreti Aliu (r.a.), ashtu sikurse pati vepruar edhe Hazreti Omeri, u përgjigj:

“Në lidhje me këtë temë as nuk ju urdhëroj të bëni atë që më thoni, por as nuk ju ndaloj! Ju i dini më mirë punët tuaja!!”

Pastaj, ai i la këtë testament Hazreti Hasanit dhe Hazreti Hysejnit:

“Po ju lë testament devotshmërinë! Mos i jepni rëndësi jetës së kësaj bote! Mos e qani atë që humbni! Thoni vazhdimisht të vërtetën! Organizojini veprimet tuaja të jetës duke u mbështetur tek Libri i Allahut, Kurani! Jini armiq ndaj atij që bën padrejtësi dhe miq të atij që i bëhet padrejtësi! Mos i jepni rëndësi fjalëve të atyre që qortojnë vendimet e fesë!”

Më pas, Hazreti Aliu shqiptoi shehadetin dhe me frymën e tij të fundit e mbylli librin e kësaj jete. Kur erdhi në jetë, i pati hapur sytë së pari në Qaben e Madhërueshme, ndërsa fundin e tij fizik e përjetoi në një mesxhid ku njerëzit i faleshin Allahut.

I bërë pishman për ngatërresat e tij me Hazreti Aliun,

7.. Shih Ramazanoglu Mahmud Sami, Hz. Aliju'I-Murteza, fq. 74.

në periudhën e fundit të jetës së tij Muavija është shprehur:

“Ah sikur të kisha qenë një nga Kurejshët që jetonte në punën e tij. Ah sikur të mos isha përzier fare në këto çështjet e drejtimit.” (Ibn Esir, el-Bidaje, VIII, 135)

Një nga dijetarët më të mëdhenj shpirtëror të fesë ka thënë:

*“Sikur Hazreti Aliu të gjente pak kohë e mundësi prej luftërave që përjetoi në të gjallë të tij, kushedi sa gjëra të mrekullueshme do të na mësonte në lidhje me dituritë Kuranore. Tekembramja, ai është kryetari i të urtëve. Ai ka thënë fjalë që askush tjetër nuk i ka thënë e nuk do të mund t'i kishte thënë.”*⁸

DISA FJALË TË URTA NGHA HAZRETI ALIU

“Qetësoni shpirtërat tuaj me fjalë të urta e me fjalë që të bëjnë të mendosh! Ashtu siç lodhen trupat, ashtu lodhen edhe shpirtat.”

“Nuk ka mirësi në namazin që falet pa shpirt, në agjërimin që mbahet pa u larguar nga fjalët dhe veprat e kota, në leximin e Kuranit pa meditim, në diturinë që nuk depërton në zemër, në pasurinë që nuk nxit bujarinë, në vëllazërimin që nuk shfaqet në kohë të vështira, në nderin që nuk prodhon falenderim, në lutjen që nuk del nga shpirti e që nuk bëhet në mënyrë të sinqertë.”

“Njerëzit janë armiq të asaj që nuk e dinë.”

“Xheneti është vendi i bujarëve, ndërsa xhehemi është vendi i të paditurve.”

“Nuk do t'u bëhet pyetja të paditurve “Pse nuk u bëtë të ditur?” pa u pyetur

8.. Shih Ramazanoglu Mahmud Sami, Hz. Aliju'I-Murteza, fq. 113.

më parë të diturit: "Pse nuk e shpërndatë diturinë tuaj, ashtu që t'ua mësonit edhe të tjerëve?"

"Ai që dëshiron xhenetin vrapon drejt punëve të mira. Ai që i frikësohet zjarrit, ruhet nga epshi i tij. Atij që beson se një ditë do të vdesë, i shuhet egoja."

"Ndershmëria është zekati i bukurisë."

"Edukata dhe bujaria në fe, është fryti i mendjes së pjekur."

"Ai që është i plotë me mendtë e kokës, flet shumë pak."

"Ai që është vetëdijësuar se edhe fjalët janë pjesë e veprave, flet krejt pak. Ai flet vetëm për çështjet që i interesojnë."

"Të heshtësh deri atëherë sa të të pyesin, është më mirë se të flasësh deri atëherë sa të të thonë "A po e mbyll gojën tani?"

"Mos mendo t'i kthesh përgjigje atij që flet në mënyrë të rëndomtë, sepse ai që flet në mënyrë të tillë, ka në fjalorin e tij shumë fjalë të rëndomta për t'i kthyer përgjigje përgjigjes tënde."

"Mos bëj shaka me njerëzit injorantë. Ata ta thejnë zemrën me gjuhën e tyre të helmët."

"Flituni njerëzve me atë që ata kuptojnë."

"Hija e një gjëje të shtrembër është po ashtu e shtrembër."

"Ai që nuk zotëron sunetin e Allahut, të të Dërguarit të Tij dhe evliave, nuk zotëron asgjë. Suneti i Allahut është të mbash të fshehur sekretin; suneti i Resulullahut është të udhëhequrit e njerëzve me drejtësi; ndërsa suneti i ev-



lijave është të tregohesh i durueshëm ndaj mundimeve që të japin njerëzit."

"Nëse dëshiron të miqësohesh me ndonjë njeri, mbaj ndaj tij një distancë të mirëpërcaktuar. Në qoftë se ai sillet në mënyrë normale, atëherë vazhdoje miqësinë me të; në të kundërt hiq dorë."

"Personi zemra e të cilit është e mbushur me armiqësi, nuk mund të bëjë punë të mira. Kjo sepse zemra nuk është aq e gjerë sa të përmbajë njëkohësisht dy gjendje aq të kundërta."

"Besimtari e ka buzëqeshjen në fytyrë, ndërsa trishtimin në zemër."

"Vdekja me besim është arritja e mirësisë së plotë."

"Jeta e kësaj bote përbëhet nga dy ditë. Njëra prej tyre është në dobinë tënde, ndërsa tjetra është në dëmin tënd. Kur të jesh në ditën tënde të mirë mos u llasto; gjithashtu mos u zemëro e mos anko kur të jesh në ditën tënde të keqe."

"Sot është dita e të vepruarit, nuk ka asnjë llogaridhënie. Ndërsa nesër është dita e llogarisë, nuk ka mundësi veprimi."

"Çdo frymë është një hap i hedhur drejt vdekjes."

"Bota së bashku me fenë do të kenë qetësi dhe paqe vetëm atëherë kur të sigurohet vazhdimësia e këtyre katër grupeve:

1. Të pasurit të cilët nuk tregohen dorështrenguar me pasurinë e tyre.

2. Të diturit të cilët veprojnë me diturinë e tyre.

**"Ai që është vetëdijësuar
se edhe fjalët janë pjesë
e veprave, flet krejt pak.
Ai flet vetëm për çështjet
që i interesojnë."**

3. Injorantët të cilët nuk krenohen me paditurinë e tyre.

4. Të varfrit që nuk e shesin ahiretin për interesat e dynjasë."

"Sa bukur është kur të pasurit tregojnë modesti duke shpresuar në shpërblimin e Allahut të Lartmadhëruar. Por akoma më bukur është kur i varfëri, duke u mbështetur tek Zoti i Lartmadhëruar, sillet syngopur ndaj të pasurve."

"Mjerimi është shumë më i mirë sesa t'i mbetesh dikujt moralisht borxh për diçka gjithë jetën."

"Ndershmëria është stolja e të varfrit, ndërsa falënderimi është stolja e të pasurit."

"Koprracia bart në vete të gjitha veset e këqija."

"Kur të varfërohesh dhuro lëmoshë duke bërë tregti me Allahun e Lartmadhëruar. Kur të të bjerë në dorë ndonjë pasuri, falëndero menjëherë Zotin! Kujdes! Mos e humb pasurinë tënde nëpërmjet falënderimit të paktë."

"Nga mirësitë e dynjasë të mjafton islami. Nga preokupimet e ndryshme të mjafton ai i adhurimit. Nga mësimet që mund të nxjerrësh të mjafton mësimi që nxjerr nga vdekja."

"Dituria është trashëgimia më e mirë. Edukata është arti më i mirë. Devotshmëria është ushqimi më i mirë. Adhurimi është kapitali më i mirë. Vepra e mirë është udhërrëfyese më i mirë. Morali i mirë është miku yt më i afërt. Butësia është ndihmësja jote më e madhe. Të jesh i kënaqur me atë që ke është pasuria më e madhe. Përkujtimi i vdekjes është edukuesi yt

më i mirë."

"Katër virtyte janë ndër punët më të vështira:

1. Të falësh në gjendje zemërimi.

2. Të tregohesh bujar kur je nevojtar.

3. Të ruhesh nga dëmi i egos tënde në vende të mbyllura dhe të hapura.

4. Të thuash të vërtetën përballë atij prej të cilit ke frikë apo ke ndonjë interes."

"Allahu i dërgon fatkeqësi të mëdha atij që i zmadhon fatkeqësitë e vogla."

"Pasuria është brumi i dëshirave të egos. Dëshirat (egoistike dhe tokësore) janë çelësi i vuajtjeve tona. Zilia po ashtu është një lodhje e kotë."

"Dëshirat dhe shpresat që të kultivon jeta e kësaj e bote verbojnë edhe një njeri largpamës."

"Një person ka vlerë aq sa dëshirat dhe ëndrrat e tij."

"Ai që bëhet skllav i dëshirave dhe i ëndrrave të egos së tij, nuk ka si t'i ketë veprat e mira."

"Nëse ti nuk e gjen rrugën për tek rrisku yt, atëherë është rrisku yt ai që e gjen rrugën për tek ti."

"Në këmbim të shpirtit tuaj mos pranoni asgjë tjetër përveç xhenetit. Prandaj shiteni shpirtin tuaj vetëm në këmbim të tij."

"Miq të Allahut të Lartmadhëruar janë ata njerëz të cilët, arrijnë të shohin planin e brendshëm të dynjasë, kur të tjerët shohin vetëm planin e jashtëm të saj."

"Imani (besimi) i atij njeriu që nuk i beson më shumë punëve të Zotit sesa punëve të tij nuk është përsosur akoma!"

Mr. sci. Flamur Sofu

Qëndrimi i sheriatit Islam ndaj lotos, bixhozit dhe lojrave të fatit

“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit, janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni! Vërtet, djalli me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?” (El-Ma’ide: 90-91)

“Nuk lejohet argëtimi përveçse në tri gjëra: kalërimi, argëtimi me gruan dhe të shenjuarit (të mësuarit e përdorimit të shtizës apo ndonjë mjeti ushtarak) sepse këto janë shumë të rëndësishme.” (Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)

Duke qenë një fe universale, që i përket çdo kohe dhe hapësire, feja islame i përgjigjet të gjitha çështjeve që paraqiten e që do të paraqiten deri në ditën e kiametit, me të vetmin qëllim, që askush të mos mundohet të arsyetojë se nuk e ka ditur normën-dispozitën e ndonjë çështjeje. Prandaj, që në krye të herës juristët myslimanë (fukahatë) kanë shkruar dhe u janë përgjigjur pyetjeve të ndryshme në lidhje me qëndrimin e fesë islame ndaj lojrave të fatit si bixhozi-kumari, lojërat e fatit, lotaria etj.

Kur u kthehemi librave klasike të jurisprudencës islame,

shohim se ata i kanë shpjeguar shumë qartë rregullat dhe dispozitat që kanë të bëjnë me këto lojëra. Në fillim ne do të shpjegojmë dispozitën e sheriatit ndaj garave dhe kush-teve të përcaktuara për to.

GARAT

Në parim garat janë të lejuara, gjë e cila vërtetohet me sunetin e të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s.) e me pajtimin unanimit të dijetarëve (muxhtehidëve). Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.) se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka thë-

në: "Nuk ka gara, përveçse në vrapimin e deveve, në gjuajtjen e shtizave dhe në vrapimin e kuajve". Gjithashtu, të gjithë juristët myslimanë, janë të një mendimi se garat ndahen në dy lloje:

1. Gara pa shpërblim.
2. Garat me shpërblim.

Garat pa shpërblim, janë të lejuara pa asnjë kushtëzim, si p.sh. garat në vrapim, me kuaj apo me deve, garat në mundje, në ngritjen e gurit etj. Transmetohet se Aisheja (r.a.) ka bërë gara me të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s.) në vrapim¹. Transmetohet se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka bërë gara në mundje me një ashab të quajtur Rukaneh dhe ka triumfuar përballë tij². I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka kaluar pranë disa njerëzve që bënin gara në ngritjen e gurëve për t'u veçuar se cili ishte më i fuqishëm, e një veprim të tillë nuk e ka kundërshtuar, po përkundrazi e ka miratuar.

Përsa sa u përket garave me shpërblim, dijetarët kanë këto mendime:

1. Hanefinjtë³ janë të mendimit se shpërblimi lejohet në garat:

- a. me shtizë,
- b. me kuaj, gomerë dhe mushka,
- c. me deve,
- d. mes njerëzve.

Tre grupet e para konsideroheshin si elementë të domosdoshëm luftime, të cilët jemi të urdhëruar t'i mësojmë nëse vazhdojnë të konsiderohen akoma të vlefshëm. Për këtë, Allahu i Lartësuar urdhëron: **"Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t'ju shpërblehet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi."**⁴ Po ashtu, si argument mund të përmendim edhe hadithin e të Dërguarit (s.a.u.s.), ku thuhet: "Argëtimi lejohet vetëm në tre raste: kalërimi, argëtimi me gruan dhe të shenjuarit (të mësuarit e përdorimit të shtizës apo ndonjë mjeti ushtarak) sepse këto janë shumë të rëndësishme."⁵ Përsa i përket garave ndërmjet njerëzve, hanefinjtë përmendin si argument garimin e Profetit (a.s.)

1. Transmeton Ahmedi, Ebu Davudi, Shafi'u, Nesaiu, Ibn Maxhe, Ibn H - bani dhe Behjekiu. Shiko: Shevkaniju: Nejlul Eutar, botimi i II, boton Darul Hajr Damask 1418/1998, vol. VIII, fq. 428.

2. Transmeton Ebu Davudi nga Alij bin Rukaneh. Shiko: Nejlul Eutar vol. VII fq. 428.

3. Alaudin Ebi Beker bin Mesud el-Kasaniju el-Hanefiju: Beda'iu Sana'i Fi Tertibi Shera'i, boton: Daru Ihjai Turathil Arabeijj, bot. II, Bejrut-Liban, vol. V, fq. 305.

4. El-Enfal: 60.

5. Transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu nga Ukbete bin Amiri.

me bashkëshorten e tij, Aishen (r.a.), transmetim ky i ardhur nga vetë Aisheja (r.a.). Dijetarët e shkollës juridike në fjalë, e arsyetojnë këtë duke thënë se vrapimi për xhihad është më se i nevojshëm.⁶

2. Pjesa dërmuese e dijetarëve (xhumhuri) si malikinjtë, shafinjtë dhe hanbelinjtë, janë të mendimit se shpërblimi lejohet në:

- a. Garat me kuaj, me gomerë dhe mushka.
- b. Garat me deve.
- c. Gjuajtjen me shtizë.

Në dallim nga Hanefinjtë, këta dijetarë mendojnë se shpërblimi lejohet vetëm në tre garimet e sipërpërmendura, ndërsa arsyetimi që ata i bëjnë këtij lejimi është fakti se ato janë elementë të domosdoshëm për xhihad. Përsa i përket shpërblimit të garave ndërmjet njerëzve, ky grup dijetarësh mendon se ato nuk janë të lejuara.

Garat për të cilat lejohet të merret shpërblim, duhet të plotësojnë disa kushte. Këto kushte janë:

1. Që garat të përfshihen në kategorinë e sipërpërmendur.

2. Që shpërblimi të jetë nga njëri prej garuesve apo nga një person i tretë. Garuesi që ofron shpërblimin, duhet t'i thotë garuesit tjetër: nëse t'i e fiton garën, do të kesh këtë shpërblim prej meje, e nëse e humbet, nuk ke për të më dhënë asgjë. E nëse ndodh që shpërblimin e ofron pala e tretë, palë e cila nuk është në garë, duhet të thotë: kush fiton ka këtë shpërblim prej meje, apo prej arkës shtetërore, nëse është prijës. Prandaj, kurrësi nuk lejohet që shpërblimi të jetë i kushtëzuar nga të dy palët në gara, gjë që d.m.th. se kush humbet duhet t'i japë shpërblimin e caktuar atij që korr fitore⁷.

3. Që garuesit të jenë të barabartë në gara. Si p.sh.: nëse dikush hyn në garën e vrapimit me kuaj duke qenë i sigurt se do të fitojë për arsye se kali i tij është më i fuqishëm se kali i garuesit tjetër, atëherë një gjë e tillë nuk lejohet⁸.

4. Të dihet lloji i mallit që është përcaktuar për shpërblim⁹.

Dijetarët islamë janë të mendimit se gara nuk duhet të ketë këto elemente:

- a. asnjë element bixhozi,
- b. të mos mundohet kafsha e cila do të marrë pjesë në garë, si p.sh. të lihet pa ngrënë.

6. Dr. Vehbete Zuhajli, El-Fikhul Islamiyyu ve Edil-letuhu, boton "Darul Fikri", bot. IV, Damask-Bejrut 1418/1997, vol. VI, fq. 4877.

7. Ibid.

8. Alaudin Ebi Beker bin Mesud el-Kasaniju el-Hanefiju: Beda'iu Sana'i Fi Tertibi Shera'i, boton: Daru Ihjai Turathil Arabeijj, bot. II, Bejrut-Liban, vol. V, fq. 305.

9. Po aty.

c. që shpërblimi të mos jetë i kushtëzuar në mes të garuesve, d.m.th. ai që fiton të marrë shpërblimin nga ai që humb.

BIXHOZI

Në shariat islam, çdo lloj loje që ka në vete elemente të bixhozit, konsiderohet e ndaluar (haram). Ndalesa e bixhozit është e përcaktuar qartë nga fjalët e Allahut të Lartësuar dhe nga suneti i të Dërguarit (s.a.v.s.).

Në Kuran thuhet shumë qartë:

“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni! Vërtet, djalli me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?”¹⁰. Po ashtu, në hadithin e të Dërguarit (s.a.v.s.) qëndron kështu: *“Kush luan bixhoz është sikur t’i ketë futur duart në gjakun dhe mishin e derrit”. “Kush i thotë shokut të vet eja të luajmë bixhoz, duhet të japë sadaka”*¹¹.

Myslimani, në asnjë mënyrë, nuk mund ta konsiderojë bixhozin si lojë për zbavitje apo si mjet fitimi¹². Në fenë islame janë të garantuara dhe të mbrojtura interesat e përgjithshme kundruall interesave personale, prandaj feja islame dëshiron që personi ta fitojë pasurinë në mënyrë të ligjshme dhe të arsyeshme.

Sipas parimeve të shariatit islam, myslimani nuk duhet të shikojë vetëm interesat e tij personale, por duhet domos të shikojë interesat e përgjithshme të myslimanëve. Bixhozi dhe të gjitha ndalesat e tjera, janë të gjitha në dëm të njeriut. Askush nuk mund të arsyetojë se loja e bixhozit është e dobishme. Gjithkush e di se këto lojëra, janë të dëmshme për shoqërinë në përgjithësi.

Po qe se do të mundohemi të përcaktojmë urtësitë e ndalimit të bixhozit, nuk do të arrijmë t’i përcaktojmë të gjitha, sepse dija absolute i përket vetëm Allahut të Lartësuar. Kësisoj, ne do të përmendim vetëm disa prej tyre:

1. Të gjitha llojet e bixhozit, kanë si qëllim fitimin e pasurisë në mënyrë të padrejtë.

2. Bixhozi nxit urrejtje, përçarje dhe çdo gjë të keqe.

3. Bixhozi e bën njeriun parazit, etj¹³.

E shohim të arsyeshme të përmendim edhe faktin se pa-



suria e myslimanit është e pacënueshme dhe se ajo mund t’i merret vetëm në mënyrë legale ose me dëshirën e tij (si dhuratë apo lëmoshë). T’ia marrësh pasurinë atij me anë të bixhozit, është një veprim i paligjshëm¹⁴.

Lojërat e bixhozit janë gjithmonë të dështuara, sepse ato e nxisin humbësin që ta përsërisë lojën, me shpresën se do mund ta rifitojë pasurinë e humbur, teksa nga ana tjetër e nxit fituesin ta vazhdojë lojën me shpresë se do të fitojë edhe më shumë. Mirëpo në të shumtën e rasteve, ndodh që brenda një kohe shumë të shkurtër fituesi të humbë atë që kishte fituar, duke dështuar kështu tërësisht. Kështu, nga njëra anë, humbja e nga ana tjetër fitorja, që të dyja bëhen shkak që lojtarët të mos largohen prej lojës¹⁵. Duhet të kihet parasysh se çdo lojë, që mbart në vetvete elemente të bixhozit, konsiderohet haram - rreptësisht e ndaluar sipas shariatit islam.

Shënim: *Bixhozi është një lojë që gjithmonë e preokupon atë që merret me të, ndërsa nga ana tjetër e largon atë nga obligimet që ka ndaj Krijuesit, ndaj vetes, familjes dhe shoqërisë. Bixhozi u sjell gjithmonë telashe e probleme atyre që merren me të. Ndërsa, përsa i përket lojës së shahut, e cila është lojë shumë e përhapur në mesin e njerëzve, dijetarët islamë kanë mendime të ndryshme:*

1. Disa mendojnë se kjo lojë është haram.

2. Disa mendojnë se kjo lojë është vepër e papëlqyeshme (mekruh).

3. Disa mendojnë se kjo vepër është e lejuar (mubah).

Ata që mendojnë se kjo lojë është e ndaluar, e mbështesin mendimin e tyre në disa hadithe për të cilat ekspertët mendojnë se janë hadithe të trilluara, sepse shahu në kohën e të Dërguarit (s.a.v.s.) nuk ka ekzistuar. Juristi i mirënjohur bashkëkohor dr. Jusuf el-Karadavi përkrah mendimin e atyre që mendojnë se lejohet loja e shahut, por duke plotësuar këto tre kushte:

10. El-Ma’ide: 90-91

11. Buhariu dhe Muslimi.

12. Dr. Jusuf el-Kardavi: El-Halalu vel Haramu fil Islam, fq. 295.

13. Muhammed Alijj es-Sajsi, Abdul Latif es-Subkij, Muhammed Ibrahim Kersuni: Tefsiru Ajatil Ahkam, boton "Daru Ibn Kethir" dhe "Darul Kadiri", botimi i III, 1420/1999, pjesa e I, fq. 236. Krahason: El-Halalu vel Haramu.

14. El-Halalu vel Haramu, fq. 296.

15. Ibid.

- a. të mos bëhet shkak për të vonuar namazin,**
- b. të mos ketë elemente të bixhozit,**
- c. të mos përdoren fjalë të ndyta e të turpshme gjatë lojës.**

Po qe se nuk respektohen këto tre kushte, apo qoftë dhe njëra prej tyre, atëherë kjo lojë konsiderohet e ndaluar dhe rreptësisht haram.¹⁶

LOTARIA-LOJËRAT E FATIT

Lotoja konsiderohet një formë bixhozi, të cilën feja islame e ka ndaluar rreptësisht, si një sëmundje shumë të rrezikshme që e kërcënon drejtpërdrejt fuqinë e njeriut si në aspektin fizik ashtu edhe në atë psikik, duke e shndërruar atë në përtac e në parazit. Lotoja konsiderohet një lloj loje që mund të sjellë fitim pa mund dhe pa angazhim serioz. Me plot të drejtë dijetarët islamë japin opinione juridike islame (fetva) negative në lidhje me loton, duke e konsideruar atë si një prej punëve të fëlliqura të djallit.¹⁷ Argumentet që ndalojnë loton, janë po ato që ndalojnë edhe bixhozin, sepse në të dy rastet fitimi është i bazuar në fatin. Pra, këto argumente duhet të kuptohen si analogji e shëndoshë dhe me shkak shumë të qartë. Ka disa njerëz që mundohen të mbrojnë idenë se lotoja është një lojë e dobishme, sepse në këtë lojë dikush do të fitojë medoemos. Atyre që mendojnë kështu, ne u përgjigjemi duke iu thënë se një veprim i tillë nuk përputhet fare me parimet e sheriatit islam. Sipas së drejtës islame, rëndësi primare ka interesi i përgjithshëm e jo ai personal. Prandaj, pa asnjë dyshim mund të deklarohet se lotoja është në dëm të shoqërisë, pavarësisht se në të mund të ketë interes individual.

E shohim të arsyeshme që në lidhje me çështjen e lotos dhe lojërave të fatit, të prezantojmë fetvatë e dy dijetarëve të mirënjohur bashkëkohorë: Muhammed Se'id Ramadan el-Butit dhe Jusuf el-Karadavit:

Prof.dr. Muhammed Se'id Remadan el-Buti jep këtë fetva në lidhje me loton:

"Pasuria e fituar me anë të lojës së quajtur loto, është një lloj pasurie që fitohet duke luajtur disa vetë, që të fitojë vetëm njëri prej tyre sipas fatit. Atëherë mendo dhe logjiko se si mund ta arsyetosh një fitim të tillë!? Pasurinë e fituar me loto nuk të takon ta shndërrosh në pronë, sepse nuk e ke fituar sipas mënyrës së lejuar me sheriat. Ajo pasuri është pronë e shumë personave, ndaj është obligim t'u kthehet të gjithëve atyre që kanë marrë pjesë në lojë. Nëse nuk mund t'i identifikosh të gjithë ata që kanë luaj-

tur, atëherë ajo pasuri duhet të përdoret në interesin e përgjithshëm të myslimanëve."¹⁸

Prof. Dr. Jusuf el-Karadavi jep këtë fetva për loton:

"Lotoja është një lloj bixhozi. Nuk mund ta lejojmë të luhet në emër të "organizatave humanitare" dhe "qëllimeve humane". Njerëzit që mundohen ta lejojnë loton nëpërmjet këtij preteksti, janë të ngjashëm me ata që mbledhin ndihma vullnetare për qëllime humane, me anë të "vallëzimit të ndaluar" dhe "artit të ndaluar". Të dy grupeve ne u përgjigjemi duke u thënë: "Vërtet Allahu është i mirë dhe Ai nuk pranon tjetër përveç asaj që është e mirë-hallall". Ata që mbështeten në këtë mënyrë të fitimit, na e bëjnë të qartë faktin se në shoqëri janë shuar ndjenjat e bamirësisë, mëshirës dhe devotshmërisë. Kjo, sepse mendojnë të grumbullojnë ndihma vullnetare humanitare vetëm nëpërmjet bixhozit dhe zbavitjes së ndaluar. Feja islame nuk e kërkon një veprim të tillë prej shoqërisë së vet. Ajo beson në mirësinë e njeriut, i cili i arrin qëllimet e tij të pastra vetëm me mjete dhe mënyra të pastra. Të gjitha këto mënyra të ndershme bëjnë thirrje për bamirësi, për nxitje të ndjenjave humane dhe thirrje për besimin në Zotin e në Ditën e Gjykimit."¹⁹

PËRFUNDIM

1. Duke u mbështetur në faktin se çdo lloj fitimi në kurriz të tjetrit është haram, ne dalim në përfundimin se të gjitha lojërat e fatit dhe llojet e bixhozit janë të ndaluara rreptësisht (haram), ndërsa ai që merret me këto ka bërë mëkat të madh.

2. Largimi nga këto lojëra të ndaluara me sheriat është në dobinë tonë, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

3. Myslimani duhet të edukojë veten dhe të tjerët, që t'i kërkojë të gjitha shkaqet legjitime për të arritur deri tek fitimi hallall, por në të njëjtën kohë të largohet nga çdo mënyrë e paligjshme e fitimit.

4. Myslimani duhet ta ketë të qartë se të gjitha lojërat e fatit janë kurthe dhe veprime të djallit të mallkuar, prandaj, ai duhet të largohet prej tyre.

5. Myslimani duhet ta ketë të qartë se lojërat e fatit janë të ndaluara sipas konsensusit të të gjithë dijetarëve, kështu që një besimtar nuk duhet të guxojë të merret me gjëra të tilla të ndaluara, e të veprojë një ndalesë të nivelit të tillë.

6. Myslimani duhet të jetë krejtësisht i bindur në faktin se ajo çfarë ndalon Allahu, është diçka që shkakton dëme, ndërsa ajo çfarë Ai na urdhëron, është e dobishme për njeriun.

16. Ibid.

17. Dr. Vehbete Zuhajli, El-Fikhul Islamiyyu ve Ediletuhu, boton "Darul Fikr", Damask-Bejrut 1418/1997, vol. VII, fq. 4981-4982.

18. Dr. Muhammed Se'id Ramadan el-Buti: Me'a Nasi Meshuratun ve F-tava, boton "Darul Fikr", Damask 1999, fq. 63

19. El-Halalu vel Haramu, fq. 297-298.

Vlera e diturisë dhe e veprës në Islam

Mr. Abdulkader Durguti

Në krahasim me religjonet e tjera, feja islame është ajo që i vlerëson më shumë kërkuesit e diturisë. Ajo i motivon studiuesit në veprimtaritë e tyre. Këtë motivim dhe vlerësim mund ta shohim së pari në Kuran. Aty, fjala dituri (ilim), përmendet më shumë se 80 herë.¹ Ndërsa nga infinitivi i fjalës "ilm", janë shtjelluar mijëra fjalë të tjera që vërtetojnë rëndësinë dhe vlerën e veçantë të diturisë. Për të vërejtur rëndësinë që i jepet diturisë, mjafton të përmendim vetëm fillimin e zbritjes së Kuranit. Fjala e parë e shpallur ishte "**Lexo**", (Alak, 96/1) po ashtu, tematika e parë e shpalljes ishte leximi, studimi dhe hulumtimi. Si edhe në fushën e hadithit, do të vërejmë kapituj të veçantë, të cilët flasin për rëndësinë dhe vlerën e diturisë.

Përsa i përket obligueshmërisë së të kërkuarit të diturisë, Pejgamberi (a.s.) shprehet: "*Kërkimi i diturisë është farz (obligim) për çdo mysliman*"². Obligimi që ceket në këtë hadith, përfshin të gjithë myslimanët pa dallim, nga se obligimi është kolektiv. Për çdo mysliman apo myslimane është detyrë të zotërojë dituri rreth obligimeve të domosdoshme që lidhen me jetën besimtare, me moralin dhe dispozitat themelore të jetës. Në aspektin juridik is-

lam, kjo dituri themelore përfshihet në kategorinë e "Farzit ajn", gjë që do të thotë se kjo dituri është obligim i çdo individi besimtar. Njeriu vlerësohet si gjynahqar, kur nuk e zotëron këtë dituri themelore fetare-morale, apo është zotërues i saj por nuk e zbaton atë.³

Islami i motivon në mënyra të ndryshme kërkuesit e diturisë. Profeti (a.s.) ka thënë: "*Kush merr rrugë për të kërkuar dituri, Allahu ia lehtëson atij rrugën për në xhenet*."⁴ Nga hadithi kuptojmë se sipas islamit, një një ndër punët më të virtytshme është studimi, kërkimi i diturisë, sepse dituria është një prej rrugëve që e shpie njeriun në xhenet.


Përsa i përket vlerës dhe rëndësisë që kanë dijetarët në islam, mjafton të marrim ajetin kuranor që thotë: "**Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka Zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, duke mbajtur drejtësinë.**" (Ali Imran, 3/18) Sipas Imam Gazaliut, për ta kuptuar vlerën dhe rëndësinë e dijes e të dijetarëve, mjafton të theksohet vetëm ky ajet i lartpërmendur. Pjesa e fundit e ajetit "duke mbajtur drejtësinë" i kushtohet dijetarëve, sepse dijetarët veprojnë me drejtësi ndaj urdhrave të Allahut duke dëshmuar se nuk ka Zot tjetër përveç Alla-

1. Muhammed Fuad Abdulkabij, *el-Muxhemu'l-Mufehres li Elfadhi'l-Kuran'il-Kerim*, f. 586.

2. Ibn Maxhe, "Mukaddime" 17.

3. Ebu Hamid el-Gazali, *el-Munkidhu Mine'd-Dalal*, f. 602-604.

4. Buhari "Ilm" 10; Muslim "Dhikr" 39.



hut. Nga ajeti shihet qartë se Allahu fillon duke dëshmuar njësinë e Tij nga Vetvetja e Tij, pas Tij dëshmojnë engjëjt dhe dijetarët. Karakteristika e dijetarëve në këtë ajet është se në këtë renditje ata qëndrojnë pas engjëjve. Ky ajet na bën të kuptojmë mirë se sa vlerë të madhe kanë tek Allahu, dijetarët që mbajnë drejtësinë.⁵

DOMOSDOSHMERIA E TË VEPRUARIT ME DITURI

Përveçse e obligon individin për të nxënë dituri, Islami e obligon gjithashtu edhe me përgjegjësinë e të vepruarit me të, sepse dituria dhe vullneti janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën. Fatkeqësia e kohëve tona është mbetja e diturisë vetëm në teori, pa u futur fare në praktikë, apo të vepruarit krejt në kundërshtim me të. Sa për ilustrim, mund të përmendim shembullin e konsumimit të disa pijeve të ndyshme alkoolike apo bimëve narkotike, ndonëse kemi njohuri të mjaftueshme fetare, shkencore, mjekësore dhe logjike se konsumi i tyre i dëmton seriozisht trupin dhe shëndetin e njeriut.

Të njëjtën gjë bënin edhe idhujtarët paganë, të cilët edhe pse e dinin se adhurimi i idhujve nuk u sillte atyre as dëm e as dobi, vazhdonin të praktikonin zakonet e tyre, të cilat binin ndesh me logjikën dhe mendjen e njeriut. Kur Ibrahim (a.s.) i theu të gjitha idhujt që ishin në faltore, përveç më të madhit, u mor nën hetim pranë Nemrudit. **“Ata e pyetën: ‘Ti i bërë kështu zotat tanë, o Ibrahim?’ Ai tha: ‘Jo! Këtë e ka bërë ky i madhi i tyre. Pyesni ata, nëse flasin!’ Atëherë ata i thirrën mendjes dhe i thanë njëri-tjetrit: ‘Me të vërtetë, ju vetë jeni keqbërësit’ Pastaj ulën kokat dhe i thanë: ‘Sigurisht që ti e di, se këta nuk flasin!’ Ai u tha: ‘Mos vallë, ju adhuron në vend të Allahut gjëra që nuk mund t’ju sjellin kurrfarë dobie e as dëmi?!’** (Enbija, 62-66) Edhe pse mësuan me fakte se adhurimi i tyre ishte i kotë, ata përsëri vazhduan të besonin në devijimet e tyre.

Islami e kundërshton diturinë boshe, e cila qëndron vetëm në fjalë, pra larg praktikës, sado që ajo mund të jetë e mbushur me ligjërime të praruara. Kurani e quan këtë një demagogji të përkohshme.⁶ Kurani e kundërshton fenomenin e zbukurimit të ligjërimit apo retorikën mahnitëse të të folurit me brendësi boshe. Të njëjtën gjë kanë vepruar edhe çifutët, prandaj Allahu (xh.sh.) i qortoi në Kuran: **“Vallë, a i urdhëroni njerëzit që të bëjnë të mira e veten po e harroni, ju që lexoni Shkrimet?!’** (Bekare, 44) Ky ajet kuranor synon t’u shprehë njerëzve se dituria dhe vepra janë të pandashme. Njerëzit duhet të largohen nga

ky fenomen shkatërrues, sepse këto fjalë dhe këto veti nuk janë të njerëzve të mençur e të ditur, por të atyre që nuk kanë qëndrueshmëri mendore. Ajeti i lartëpërmendur lidhet me çifutët, por nga ajete të tjera mësojmë se ky fenomen apo kjo dukuri, ekziston edhe tek ata të cilët besojnë Kuranin dhe Pejgamberin e tij. Atyre, Allahu u drejtohet me një qortim edhe më të rëndë, duke u thënë: **O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni? Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni!** (Saff, 2-3)

Enes b. Maliku transmeton se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka thënë: **“Gjatë udhëtimit në natën e Miraxhit, kam kaluar pranë një populli, të cilët shponin buzët e tyre me hekur prej zjarri. I Dërguari i Allahut ka pyetur: Kush janë këta njerëz? M’u tha: Ligjëruesit që kanë qenë në dynja, i urdhëronin njerëzit në të mirë, ndërsa e harronin vetën e tyre dhe ishin nga ata që lexonin librin e Allahut e nuk logjikonin.”**

Po ashtu, Usame b. Zejd transmeton se e ka dëgjuar Pejgamberin (a.s.) duke thënë: **“Do të vijë një njeri ditën e gjykimit, e do të hidhet në zjarr. I habitur, ai do të sillet sa në një anë në tjetrën, me habinë e një gomari. Do të mbledhen banorët e zjarrit rreth tij dhe do ta pyesin: O filan, a nuk ke qenë ti prej atyre që ke urdhëruar në punë të mira dhe ke ndaluar nga të këqijat? Do të thotë: Kam qenë prej atyre që kam urdhëruar për punë të mira, por nuk i kam vepruar, kam ndaluar nga të këqijat, ndërkohë që vetë i vepra ato.”**

Fjalët zbukurohen nga veprat dhe jo vetëm nga mënyra e zjarrit apo tërheqëse e të shprehurit të tyre. Për sa kohë që fjalët janë vetëm shprehje e të folurit dhe vetë folësi nuk beson dhe vepron sipas tyre, atëherë thëniet e tij mbeten të vdekura në mënyrë absolute. Lumturia e diturisë së dobishme arrihet atëherë kur diturisë i bashkohet edhe vepra, sepse për këtë, Allahu (xh.sh.) u garanton lumturinë atyre të cilët veprojnë me diturinë e fituar. **“Ne do të bëjmë që të kalojë jetë të bukur çdo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, dhe do ta shpërblejmë secilin prej tyre sipas veprave më të mira që ka bërë.”** (Nahl, 97)

Sado i ditur të jetë njeriu, nëse dituria e tij nuk shndërrohet në vepër, ajo fatkeqësisht do të jetë dëshmitare kundër tij në ditën e gjykimit. Këto njerëz, Kurani i krahason me gomarin, i cili bart shumë libra, por nuk ka asnjë përfitim nga ajo barrë sa i takon aspektit të veprimit. Të tillë ishin jahuditë. Në lidhje me ta, Allahu thotë në Kuranin Famë-lartë: **“Shembulli i atyre, që iu besua Teurati, por pastaj nuk e zbatuan atë, i shëmbëllen gomarit që vetëm sa i mbart librat”.** (Xhum'a, 5)

5. Ebu Hamid el-Gazali, *Ihja-i Ulum-i d-Din*, f. 70.

6. Bekare, 2/204.

7. Buhari “Fiten” 17; Muslim “Zuhd” 51.



Dituria

pasuria më e madhe në botë

Fatmir Hadri

Dituria është baza dhe jeta e Islamit. Ajo është shtylla themelore e kulturës dhe e qytetërimit islam. Vlera e diturisë dhe kërkimi i saj në Islam është përcaktuar me fjalët e Zotit në Kuranin Famëlartë dhe me thëniet e Muhamedit (a.s.). Kërkimi i saj është obligim prej djepit e deri në varr.

Njeriut i është dhënë mendja, nepërmjet të cilës ai mendon, arsyeton dhe arrin të kuptojë të mirën e të keqen. Mund të themi se mendja është instrumenti më i fuqishëm për realizimin e aspiratave dhe idealeve njerëzore. Ajo është dhurata më madhështore e Zotit, që e lartësoi njeriun mbi të gjitha krijesat e gjalla në tokë. Ajo është drita dhe syri i shpirtit njerëzor. Ajo është jeta e zemrës. Ndërsa padituria është vdekja e zemrës, kështu që duhet te largohemi prej saj.

Allahu Lavdiplotë me fjalën e parë të Kuranit *“Lexo...”* i drejtohet fillimisht Muhamedit (a.s.) e pastaj, përmes tij i drejtohet tërë gjinisë njerëzore, të gjithë atyre që i përkasin apo jo besimit Islam. Allahu Fuqiplotë në Librin e Tij Famëlartë, fjalën el-ILM (dituri) e ka përmendur rreth 850 herë, gjë që tregon qartë vlerën e madhe të saj. Dituria është baza e të gjitha të mirave. Prej saj burojnë veprat që bazohen në urdhrat e Allahut Mëshirëplotë dhe udhëzimet e Muhamedit (a.s.). Çdo njeri duhet të rrënjosë në zemrën e tij dëshirën e flaktë për të nxënë dituri. Allahu Lavdiplotë e ka urdhëruar të dërguarin e Tij, por bashkë me të edhe të gjithë të tjerët, që ta lusin Allahun t’u dhurojë dituri, në këtë mënyrë: *“...dhe thuaj: Zoti im shtoma*

dijeninë.” (Ta-Ha: 114). Kurse i dërguari i Allahut Muhamedi (a.s.) ka thënë: *“Bëhu i ditur ose arsimohu (deri sa të bëhesh i tillë); dëgjo ç’flasin të diturit, por mos u bëj i katërti se do ta pësosh!”*

Alli (r.a.) e pyeti: *“E kush është i katërti, o i dërguari i Allahut?”* I Dërguari i Allahut iu përgjigj: *“Ai që është i paditur dhe nuk pyet njerëzit e ditur për çështjet fetare. Ky njeri është krejtësisht i humbur.”*

Allahu Lavdiplotë diturinë e krahason me dritën dhe shqisën e të parit, ndërsa paditurinë me errësirën dhe verbërinë. Ja disa krahasime kuranore që magjepsin mendjen njerëzore: *“Nuk janë, kurrsesi, njësoj i verbëri dhe ai që sheh, as errësira dhe drita, as freskia (e hijes) dhe vapa. Po ashtu, nuk janë kurrë të barabartë të gjallët dhe të vdekurit. Allahu bën të dëgjojë kë të dojë Vetë, kurse ti (Muhamedi) nuk mund të bësh të dëgjojnë ata që janë në varr.”* (El-Fatir, 19-20)

Vullneti për dije është dhurata më madhështore e Zotit. Dashuria për dije buron nga dëshira për të ditur. Dituria dhe dashuria për diturinë rriten së bashku. Urrejtja ndaj diturisë lindet nga padituria, sepse padituria është aleati më i mirë i shejtanit. Prandaj, shejtani e ka më frikë të diturin kur fle, se sa injorantin e zgjuar kur falet.

I Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.) ka thënë se: *“Atij që merr rrugën për të kërkuar dituri, Allahu do t’ia lehtësojë rrugën për në Xhenet. Vërtet edhe engjëjt ia shtrijnë krahët kërkuesit të diturisë. Çdo gjë që është në qiej dhe në tokë*

kërkon falje për dijetarin, madje edhe peshqit në ujë. Pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi dinarë as derhem, por ata kanë lënë trashëgimi diturinë, prandaj kush e merr atë, ka marrë hisen më të bollshme”.

Nga hadithi i mësipërm shihet qartë se dituria jo vetëm që ka vlera të larta, por ajo është edhe më me vlerë se sa pasuria. Dituria e mbron njeriun, ndërsa pasuria duhet të mbrohet nga njeriu. Pasuria mund të harxhohet, kurse dituria nuk harxhohet kurrë. Rojtarët e pasurisë, një ditë, patjetër do të vdesin, ndërsa dijetarët mbesin të gjallë përjetë, sytë nuk u shikojnë, por fjalët e tyre përkujtohen gjithmonë. Dituria e lartëson njeriun, e bën të pavdekshëm dhe e mban gjithmonë gjallë në kujtesën e popullit, në çdo vend dhe në çdo kohë. Sa bukur kanë thënë të parët tanë: “Njeriu vdes, por vepra, puna dhe fjala e tij nuk vdes kurrë”.

Aliu (r.a.) ka thënë se: “Dashuria ndaj diturisë ose ndaj dijetarëve është fe që duhet predikuar, sepse dituria është trashëgimia e të Dërguarve, ndërsa dijetarët janë pasardhësit e tyre”.

Nga burimet e historisë vërehet qartë se pejgamberi i fundit, Muhamedi (a.s.) i ka dhënë aq shumë rëndësi diturisë dhe kërkuesve të saj, sa që historianët objektivë e pranojnë se në lidhje me këtë fushë Pejgamberi ka bërë më shumë se çdokush tjetër në historinë e njerëzimit. Për të ilustruar këtë do të sjellim disa hadithe që flasin për vlerën e diturisë dhe të kërkuesve të saj. Muhamedi (a.s.) thotë: “Pasojat e vdekjes së një fisi janë më të lehta se pasojat e vdekjes së një dijetari”. Në një rast tjetër, vendin ku njerëzit mblidheshin për të nxënë dituri, Muhamedi (a.s.) e ka vlerësuar më shumë se sa lutjen, duke thënë: “Të gjen-desh në një tubim ku flitet rreth diturisë është më mirë sesa të falësh njëmijë rekate (nafile), të vizitosh njëmijë të sëmurë dhe të përcjellësh njëmijë të vdekur (xhenaze).”

Dikush prej të pranishmëve tha: “A është më mirë se leximi i Kuranit?”. Muhamedi (a.s.) iu përgjigj: “Kurani vlen vetëm me dituri”.

Respekti që kishte Pejgamberi (a.s.) për diturinë shihet qartë edhe në një hadith tjetër në të cilin thuhet: “Ditën e gjykimit, ngjyra e dijetarëve dhe gjaku i shehidëve do të peshohen, dhe ngjyra e dijetarit do të peshojë më shumë se sa gjaku i shehidit”.

Islami i ka kushtuar rëndësi të madhe diturisë, sepse ajo është bazë për përparimin e njerëzve në këtë botë dhe për lumturinë në botën tjetër.

Në lidhje me dobinë e diturisë ka shumë ajete kuranore, hadithe të Muhamedit (a.s.) dhe thënie njerëzish të mençur. Ja disa prej tyre:

Allahu i Madhërishëm thotë: **“Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, duke mbajtur**

drejtësinë. S’ka zot tjetër përveç Atij, të Plotfuqishmit, të Urtit.” (Ali Imran: 18)

Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Vërtet edhe engjëjt ia shtrijnë krahët kërkuesit të diturisë nga kënaqësia me veprën e tij.”

Allahu Lavdiplotë, thotë: **“Allahu i lartëson ata që besuan prej jush, e gjithashtu i lartëson në shkallë të lartë edhe ata të cilëve u është dhënë dituri. Allahu di çdo gjë që punoni.”** (Muxhadele: 11).

Allahu i Gjithëdijshtëm thotë: **Thua: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!”** (Zumer/9)

Kurse Abdullah Ibn Mesudi, (r.a.) ka thënë se: “Shenjë e mjaftueshme e devotshmërisë është dituria, ndërsa shenjë e mjaftueshme e mendjemadhësisë është padituria.”

Po ashtu, Muadh Ibn Xhebeli, (r.a.) ka thënë: “Mësojeni diturinë, pasi mësimi i saj për hir të Allahut është devotshmëri, kërkimi i saj është adhurim, shqyrtimi i saj është xhihad, t’ia mësosh dikujt diçka që ai nuk e di është sadaka, ndërsa ta bësh këtë ndaj familjes është afrimetet. Ajo është shoqëruesi në vetmi.”

Fet’h el-Musilij tha:

“Nëse nuk i japim të sëmurit as ushqim, as pije dhe as ilaçe, a nuk është i destinuar të vdesë?”

- Po.

- Gjithashtu edhe zemrës nëse i ndalohet urtësia dhe dituria për tre ditë, ajo do të vdesë.”

Llukmani i urtë e këshilloi djalin e tij duke i thënë: “O biri im: Ulu pranë dijetarëve me thjeshtësi dhe shoqëroji ato, sepse Allahu i ringjall zemrat me dritën e urtësisë ashtu siç ringjall tokën e shkretuar me ujin e shiut.”

Dituria është burim sevapesh edhe pas vdekjes, nëse njeriu që e ka zotëruar ia ka lënë në dobi të tyre njerëzve, qoftë me shkrim apo nëpërmjet nxënësve të cilët ai i ka mësuar.

Në lidhje me këtë Muhamedi (a.s.) ka thënë: “Kur njeriu vdes, veprat e tij ndërpriten, përveç në tre raste: nëse ka lënë pas vetes sadaka rrjedhëse, dituri të cilën e shfrytëzojnë të tjerët dhe fëmijë të ndershëm që do të luten për të”.

Dituria është shenjë se Allahu ia do të mirën atij personi.

Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Kujt i dëshiron Allahu të mirën, ia mundëson atij kuptimin e fesë”. Pra, sa më shumë që njeh islamin, aq më shumë të do Allahu të mirën. Kriteri, i cili tregon se kë do më shumë Allahu është dituria dhe jo pasuria, fama apo pozita. Të mirat e kësaj bote Allahu ia jep atij që do dhe atij që nuk do, mirëpo fenë ia jep vetëm atij që do.

Përfundimisht, dituria është shpirti i Islamit, pa të cilën thelbi i tij nuk mund të ekzistojë dhe ardhmëria e tij nuk garantohet.

Fitër Bajrami

Allahu ekber! Në këtë ditë të madhe të fitër bajramit.

Allahu ekber! Në ditën e shpërndarjes së shpërblimeve nga Allahu.

Allahu ekber! Në ditën, kur gëzohet zemra e çdo të varfëri.

Allahu ekber! Me emocionet që të fal kjo ditë e bekuar.

Allahu ekber! Në këtë ditë, ku myslimanët janë mbledhur të gjithë së bashku.

Dita e bajramit është dita e haresë dhe e gëzimit, një ditë që e meritojnë të gjithë ata që e kaluan muajin e ramazanit me agjërim, duke qëndruar larg çdo ushqimi dhe pijeje, që nga syfyri deri në aksham, duke pasur si qëllim të vetëm nënshtrimin dhe bindjen ndaj urdhërave të Zotit të botërave, Allahut fuqiplotë.

Fitër bajram do të thotë: **“kthim në natyrshmëri”** ose thënë me jale të tjera **“kthim në normalitet, në të ushqyer dhe të pirë, pa nëpërkëmbur rregullat e sheriatit islam”**. Në Kuranin famëlartë Allahu (xh.sh.) thotë: **“Ka shpëtuar ai që është pastruar”** (Surja Shems, 9.), gjë që do të thotë: ka lënë pas njëherë e përgjithmonë veprat e liga dhe e ka pastruar veten nga sëmundjet shpirtërore si: egoizmi, kopracia, shpirti hakmarrës, paragjykimi dhe mendimi i keq.

Muaji i Ramazanit është muaj i bekuar, në të cilin shtohet devotshmëria, muaj i cili na lartëson gjendjen tonë shpirtërore. Ai është muaji që na zhvillon moralisht, na mëson durimin, na ushtron që t'i falim në kohë namazet tona, prandaj duhet që këto mësimet që marrim gjatë këtij muaji të begatshëm, të vazhdojmë edhe pas largimit të këtij mysafiri të bekuar e të nderuar.

Jemi mësuar që në Ramazan t'i shohim myslimanët më të devotshëm, të angazhuar me adhurime, agjërimet, namazet, sadaka, Kuran etj. Jemi mësuar t'i shohim xhamitë të mbushura plot me xhemat, madje edhe ata, të cilët nuk i kemi parë më përpara në xhami.

Myslimanët nuk kanë vetëm një kohë të caktuar për të bërë adhurim, si Ramazanin, apo një vend të caktuar si haxhin jala vjen por gjithëherë dhe çdo herë, siç thotë Hasan el Basriu: “Allahu (xh.sh.) nuk ka caktuar për veprat e myslimanit kohë të caktuar, përveç vdekjes.” Allahu (xh.sh.) në Kur'anin e madhëruar urdhëron:

“Adhuro Zotin tënd derisa të të vijë vdekja.”
(Hixhër, 99)

Ky ishte një muaj i tërë sakri i cili na bënte të jesh për të ndihmuar të varfrit e të vobektët. Një muaj, i cili erdhi në mesin tonë për të zbutur zemrat e ngurtësuar nga materializmi. Një muaj që na fali shumë prej vetes, prandaj e kemi të vështirë të ndahemi prej tij. Një muaj, i cili në teravitë e tij na ringjalli edhe njëherë emocionet e para të shpalljes hyjnore jalen e Allahut Kuranin që lexohej në çdo rekat dhe kuptimi i të cilit gdhendej thellë



në shpirtin e besimtarëve të rreshtuar përpara Allahut fuqiptotë.

Teravitë dhe namazet e ramazanit do të mbeten të ngulitura thellë në mendjen dhe shpirtin e çdo besimtari. Ngrohtësia e të ulurit pranë sofrës së yftarit do të na mungojë edhe për 11-muaj me radhë. Sot, mbarë bota islame ndihet e gëzuar për këto momente të bukura që na fali kjo ditë, por edhe pak e pikëlluar duke ditur se ç'mirësi po na ikën nga dora, mirësi të cilën nuk e dimë nëse do kemi fatin e mirë ta përjetojmë sërish vitin e ardhshëm në këtë faltore.

Të nderuar vëllezër e motra bashkëqytetarë!

Përjetojmë ditën e festës sonë për të gëzuar dhe për të shkëmbyer urimet, por gëzimi ynë nuk duhet të na shpierë deri atje sa të kalojmë ku ijtë e fesë, duke humbur çdo arsye dhe logjikë. Tryezave të mos u bashkëngjitet alkooli, edhe nëse ndokush mund ta kërkojë me pretekstin se e do zakoni, sepse për atë që beson në Zot nuk ka zakon më të mirë se sa zakoni i besimit. E ku ka jalë më të mirë se sa jala e Allahut

Mos harroni ta adhuronit përherë Allahun, se Zoti i ramazanit është edhe Zoti i muajve të tjerë.

Së fundi, lus Allahun e madhëruar ashtu siç është lutur vetë Pejgamberi (a.s.):

Zoti ynë! Bëje Kuranin pranverë të zemrave tona, dritë të shpirtave tanë, qetësues të problemeve dhe shqetësimeve tona.

Zoti ynë! Na mundëso leximin e tij, bëje atë ndërmjetës për në ditën e gjykimit, argument për ne dhe jo kundër nesh.

Zoti ynë! Ti, që i lidh zemrat, bëji zemrat tona të

qëndrueshme në besim. O zot, kërkojmë prej teje ato që të ka kërkuar vetë profeti ynë.

Zoti ynë! Na servir të vërtetën e na mundëso ta ndjekim atë; bëj që ta shohim të keqen si të keqe dhe na mundëso qëndrimin larg prej saj.

Zoti ynë! Ti je falës, bujar, e do faljen, prandaj na fal neve.

Zoti ynë! Na mundëso vazhdimësinë e veprave të mira edhe pas ramazanit, na bëj të qëndrueshëm e jo të luhatshëm në besim. Na fal përherë gëzim dhe lumturi në mesin familjar e shoqëror.

Zoti ynë! Bëji ditët tona që na kanë mbetur në këtë jetë si ditët e bajramit.

Na fal për të metat dhe gabimet që kemi bërë gjatë ramazanit, me apo pa dashje, sepse ne jemi krijesa të dobëta që gabojmë shumë, kurse mëshira jote është më e madhe se zemërimi dhe ndëshkimi yt.

Zoti ynë ! Udhëzoje popullin shqiptar në rrugën tënde, dhuroji njerëzve të përvuajtur lehtësi në kapërcimin e problemeve të jetës.

Zoti ynë! Mbroje vendin tonë nga fatkeqësitë natyrore dhe shpirtërore. Fali asaj begati, përparim ekonomik dhe shoqëror.

I lutem Allahut të Madhëruar që në këto ditë feste t'i afrojë zemrat e njerëzve me njëri-tjetrit. Në mënyrë të veçantë ua urojmë Fitër Bajramin të gjithë mërgimtarëve të shpërndarë anekënd botës, të sëmurëve, jetimëve dhe të gjithë njerëzve që qëndrojnë të ngujuar për arsye gjakmarrije.

*Gëzuar dhe për shumë vjet
Festën e Fitër Bajramit!*

Kontributi i Bejtu'l-Hikmes

Mr. Artur Tagani

NDIKIMI I BEJTU'L-HIKMES NË FUSHËN E MENDIMIT

Krahas kontributit të vyer që dha kjo qendër në fushën e përkthimeve të veprave më të rëndësishme klasike, një nga shërbimet e rëndësishme që doli si rezultat i punimeve të bëra në Bejtu'l-Hikme, ishte edhe ridimensionimi i disiplinave të vjetra Islame, si: Filozofia, Kelami dhe Tasavvufi.

Kindi, një nga ekspertët e Bejtu'l-Hikmes, është personi që hedh themelet e para të filozofisë sistematike në botën Islame. Pas tij vijnë Farabiu, Zakerijja er-Razi, Ibn Sina, Nasiruddin et-Tusi, Shihabuddin Suhreverdi, etj.

Veprat kryesore filozofike mbi të cilat punuan personeli i Bejtu'l-Hikmes, ishin kryesisht ato të Platonit, Aristotelit dhe të neoplatonistëve. Veprat e tyre me shekuj të tërë janë diskutuar nga myslimanët. Madje, si rezultat i kësaj simpatie ndaj metodës së tyre filozofike, është krijuar edhe një shkollë në botën Islame e quajtur Mesh'shâ'i (Peripatetizmi i filozofëve myslimanë).

Në fushën e Kelamit ishin emrat e ekspertëve, si; Hudhejl el-Al'lafi, Ibrahim en-Nadhami, Serahsi dhe Ravendi.

Ndërsa në fushën e Tasavvufit vërejmë Ebu Dher el-Gifarin, Umer Bin Abdulazizin, Hasan el-Basriun, Ibrahim Bin Et'hemin, Zunnun Misriun, etj.

NDIKIMI I BEJTU'L-HIKMES NË FUSHËN E SHKENCËS

Myslimanët kanë hedhur hapa të mëdhenj në shumë fu-

sha të shkencës. Muhammed Bin Musa el-Harezmi vendosi themelet e shkencës së Algjebrës dhe është i pari që i dha kësaj shkence një trajtë të pavarur nga shkencat e tjera. Filozofi mysliman Kindi vendosi themelet e matematikës moderne, shkroi vepra lidhur me teorinë e shifrave. Kindi gjithashtu zhvilloi gjeometrinë globale, duke u bazuar në studimet astronomike të tij. Të gjitha këto janë falë bazamentit kulturor dhe shkencor që vendosi Bejtu'l-Hikme.

Një nga kontributet më të rëndësishme të Bejtu'l-Hikmes për zhvillimin e të gjitha shkencave ishte sjellja në përdorim të shifrës "zero". Myslimanët kanë rënë në sy duke u marrë kryesisht me gjeometrinë dhe trigonometrinë. Ndërsa me matematikën janë marrë mjaft emra shkencëtarësh të mëdhenj, si: Thabit Bin Kur'ra, Xhabir el-Battani, Ebu'l-Vefa Buzxhani, Ibn Hajthemiu, etj.

Myslimanët janë marrë edhe me shkencën e astronomisë. Edhe në këtë fushë kanë arritur shumë rezultate të rëndësishme. Shkencëtarët e kësaj fushe janë: Ibrahim el-Fezari, Ferruhan et-Taberi, Sehl Bin Bishri, Kindi, Thabit Bin Kur'ra, etj.

Si rezultat i arritjeve të Bejtu'l-Hikmes dhe të interesimit që përhapi anëmbanë botës së kureshtarëve të shkencës, myslimanët startuan edhe shkencën e gjeografisë. Disa prej shkencëtarëve që u morën me këtë shkencë ishin: Ibrahim el-Fezari, Is'hak el-Kindi, Ahme del-Fergani, si dhe; Thabit Bin Kur'ra, Battani, Tajjib Serahsi etj.

Mes të gjithë shkencëtarëve, ai që bëri librin e parë në lidhje me mjekësinë sistematike është Rabbani et-Taberiu.

Më pas, Raziu dhe Ibn Sina ngrenë në pedestal mjekësinë Islame, kontribut i cili ka ndriçuar për shekuj me radhë mendjet e të gjithë të interesuarve për mjekësinë.

Krahas këtyre shkencave, Bejtu'l-Hikme ka ndikuar në zhvillimin edhe të shkencave si: kimia, farmaceutika, botanika, zoologjia.

Ndikimet e përgjithshme të Bejtu'l-Hikmes

RUAJTJA E TRASHËGIMISË SË MENDIMIT DHE TË SHKENCËS SË ANTIKITETIT

Për arsye të disa tronditjeve historike që ndodhën aty nga fundi i Epokës Antike, si emigrimi i popujve dhe rënia e Romës, ashtu siç u asgjësuan shumë vlera kulturore, u shkatërruan gjithashtu edhe veprat filozofike dhe shkencore. Shumë kohë më pas, veprat që patën shpëtuar pa pësuar ndonjë dëmtim dolën edhe një herë në dritë.

Veprat e rëndësishme patën kaluar një tjetër rrezik gjatë shekullit IV, në kohën kur filluan të përktheheshin pa kontroll në surianisht.

Në një kohë të tillë kur trashëgimia e antikitetit kishte mbetur në prag të asgjësimit total, me shfaqjen në histori të Abbasive u krijua institucioni i parë kulturor Islam dhe u mblodhën librat ekzistues në Greqi, Azi të Vogël, Qipro, Gjirin Persik, Siri, Mesopotami, Azinë e Mesme, Egjipt, si dhe në Indi. Me këtë fushatë aq të rrallë në histori, myslimanët kanë kontribuar në një mënyrë të jashtëzakonshme në ruajtjen e këtyre veprave, duke i përkthyer në arabisht apo duke ua dhuruar botës së mendimit e shkencës.

FILLIMI I “EPOKËS SË ARTË” I KULTURËS ISLAME

Nisma shtetërore e ndërmarrë nga qeveria Abbasite për të krijuar Bejtu'l-Hikmen, është konsideruar nga shumë studiues lindorë apo perëndimorë si fillimi i Epokës së Artë Islame. Kjo gjë bëri që qytetërimi Islam të ngrihej kryesisht mbi këto tre pika:

a) *Arabishtja u bë një gjuhë universale e shkencës.* Kjo gjë ndodhi si rezultat i përkthimeve në gjuhën arabe të veprave të antikitetit dhe të qytetërimeve të mëhershme.

b) *Bibliotekat dhe Medresetë u bënë iniciatore të projekteve të ngjashme.* Në një periudhë të shkurtër kohore, u vu re se anembanë botës Islame dhe joislame ishin hapur shumë institucione të ngjashme me Bejtu'l-Hikmen, madje ndonjëra prej tyre mbante të njëjtin emër me Bejtu'l-Hikmenë. Disa prej këtyre institucioneve ishin hapur edhe nga vetë ish-personeli i Bejtu'l-Hikmes. Sa për institucionet e hapura në vendet joislame, mund të thuhet se ato kishin

marrë si shembull medresetë dhe Bejtu'l-Hikmenë, duke filluar që nga organizimi e deri tek aspekti arkitektonik.

c) *Krijohet epistemologjia Islame.* Kur transmetuan filozofinë greke, filozofët myslimanë nuk e lanë ashtu si ishte, por e përdorën këtë dije brenda paradigmes së shkencës Islame dhe e shkrinë me një qëllim hyjnor, gjithnjë me bosht monoteizmin, duke hedhur kështu themelet e para të epistemologjisë Islame. Më pas, kjo epistemologji solli mendje enciklopedike që e kanë ndikuar mendimin njerëzor për shekuj me radhë.

NDIKIMI QË USHTROI BEJTU'L-HIKME NË BOTËN PERËNDIMORE

Transferimi i dijes dhe i kulturës nga bota Islame tek ajo perëndimore ndodhi kryesisht nëpërmjet Andaluzisë dhe Sicilisë. Sipas studimeve që janë bërë, shumica e burimeve të shkruara që janë gjetur në skajin perëndimor të botës Islame, në Andaluzi, janë transferuar nga lindja e botës Islame, nga qendrat kërkimore të ndërtuara në Bagdad, siç është rasti i Bejtu'l-Hikmes, si dhe nga institucionet e tjera shkencore e kulturore të ndërtuara brenda kufijve të shtetit Abbasit.

Më pas, në qytetet kryesore të Andaluzisë u vërejt se jo-myslimanët hapën disa qendra që të mund t'i përkthenin këto vepra në gjuhën e tyre. Këto qendra shërbyen për të përkthyer në latinisht veprat kryesore të astronomëve, ekspertëve të natyrës, filozofëve, mjekëve, matematicienëve dhe kimistëve myslimanë.

Qendrat si Bejtu'l-Hikme, të ndërtuara në botën Islame, kanë patur aq shumë ndikim sa që veprat e mendimtarëve myslimanë rreth muzikës, siç janë ato të Kindit e të Farabiut, u hapën perëndimorëve horizontin përtej muzikës kishtarë, e cila deri atëherë kishte pasë pushtuar tërë kulturën e tyre muzikore. Si rezultat i këtyre librave, perëndimi filloi të thellohej me notat muzikore. Kështu, muzika perëndimore filloi të zhvillohej, duke pësuar ndikim të dukshëm nga muzika orientale.

Si përfundim, Bejtu'l-Hikme, u ndërtua si një zyre përkthimesh dhe bibliotekë. Më pas, gjatë progresit të vazhdueshëm që pati, u zgjerua fizikisht dhe funksionalisht, derisa mori trajtën e një qendre kërkimore, kryesisht të shkencave ekzakte dhe u bë një institucion i denjë arsimor. Kjo qendër, e cila u bë burim i dijes për mbarë botën Islame për afro 500 vite me radhë, u shkatërrua në vitin 1258 nga perandori i Mongolisë, Hulagu Khan, gjatë kohës kur ai pushtoi Bagdadin.

Dokumenta osmane mbi Shqipërinë mesjetare

Zyra e botimeve të Arkivit Osman në Stamboll ka realizuar me sukses botimin e veprave me dokumente origjinale, në lidhje me shtete të ndryshme të hapësirës ballkanike e të lindjes së Mesme. Si pjesë e këtij projekti janë botuar deri tani librat: Kosova, Maqedonia, Shqipëria, Jemeni, Palestina në dokumentat arkivore otomane.

Arkivi osman në Stamboll përmban 100 milionë dokumenta arkivore, 55 milionë prej të cilëve janë klasifikuar dhe vënë në shërbim të studiuesve, ndërsa 45 milionë të tjerë po përpunohen në dosje të ndryshme sipas fondeve të parashikuara. Një numër i madh dokumentash kanë të bëjnë me Rumelinë, ndarjen e madhe administrative, përkrah asaj të Anadollit, e cila zinte një vend të rëndësishëm në jetën e perandorisë, aq sa bejlerbeu i Rumelisë ndodhej një shkallë më lart në hierarkinë administrative, krahasuar me bejlerbeun e Anadollit. Një numër i madh dokumentash kanë të bëjnë me trevat e pastra shqiptare që sot formojnë ndarjet e mëdha të tokave shqiptare (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni), ndërsa të tjerat përmbajnë të dhëna për bashkësitë shqiptare që ndodheshin në zona më të thella të Ballkanit, një pjesë e të cilave është asimiluar apo eliminuar në periudhat pas kongresit të Berlinit.

Në botimin e Shqipërisë, realizuar në vitin 2008, janë përfshirë 116 dokumenta arkivore të organizuara në 9 kapituj të ndryshëm (administratë, politikë, urbanistikë, ekonomi, ushtri, jetë sociale, shëndet, arsim dhe kult fetar).

Në këtë artikull do të trajtojmë disa prej këtyre dokumenteve, duke shfrytëzuar të dhënat që gjenden në to, me qëllimin se në këtë mënyrë do të kontribuohet në ndriçimin e çasteve të caktuara të jetës shqiptare gjatë sundimit osman.

Që në fillimet e pushtetit osman në Shqipëri dhe deri në momentin kur u shpall pavarësia e Shqipërisë, shqiptarët kanë pasur poste të shumta në administratën civile, fetare, por edhe atë ushtarake. Në fillimet e perandorisë osmane të rinjtë shqiptarë u përfshinë në sistemin e jeniçerëve,

që përbënin të vetmin repart të qëndrueshëm ushtarak të vendosur në qendrën e perandorisë, fillimisht në Edirne dhe më pas në Stamboll, në dallim nga ushtria e rekrutuar mbi bazën e të ardhurave ekonomike të timareve. Edukimi në shkollat e jeniçerëve ishte e vetmja rrugë brenda administratës osmane që të jepte mundësinë për t'u ngjitur në majat e hierarkisë perandorake. Kjo është arsyeja, që pas edukimit në shkollat e jeniçerëve dhe pas sukseseve në fushat e betejës, një numër i madh shqiptarësh arritën të ngjiten në rangun e sadrazamit, kryeministrit osman. Pas abrogimit të sistemit mesjetar ushtarak osman, pra pas shpalljes së Tanzimatit dhe krijimit të ushtrisë së rregullt në shkallë perandorie, elementi shqiptar zë një vend të rëndësishëm në administratën komanduese osmane. Kështu, dokumenti i datës 19 janar 1881 përmban një listë të ushtarëve që janë përgjegjës për sigurinë e jetës së sulltanit dhe të oborrit perandorak. Lista përbëhet prej 119 emra ushtarësh, për të cilët shënohet edhe prejardhja e tyre. Me përjashtim të një shqiptari nga Shkupi dhe dy prej Manastiri, të 116 ushtarët e tjerë janë prej Tiranës. Nisur nga data e dokumentit kuptojmë se këta qenë ushtarët që ruanin sulltan Abdulhamidin e II, dhe nuk është rastësi që adjutanti i sulltanit që vdiq gjatë atentatit të organizuar ndaj këtij të fundit në Beshiktash, qe vëllai i Esat pashë Toptanit, Gani Toptani.

Zhvillimi i jetës blegtorale dhe prodhimi me përkujdesje i produkteve të qumështit duhet të ketë qenë shumë i lartë, sepse në një dokument të datës 8 janar 1856 lexojmë shqetësimin e valiut të Selanikut, Mustafa efendiut, për përçarjet e tregtarëve të Selanikut të cilët përpiqeshin në mënyra të ndryshme të merrnin sasi gjalpi dhe margarine që ta tregonin për vete, duke u dhënë rryshfete ruajtësve të anijeve që ishin të ngarkuara me produkte të cilat do të dërgoheshin në Stamboll, për llogari të kuzhinës perandorake. Valiu i Selanikut kërkon të merren masa në mënyrë që gjalpi dhe margarina që vinte nga Shqipëria për llogari të kuzhinës pe-



randorake, të mos përfundonte në tregun e zi.

Mes dokumenteve të botuara gjendet edhe raporti i Ahmet Xhevdet pashës, i njohur më shumë për punën e tij si kryetari i komisionit që hartoi Mexhelle-në, kodeksin e rregullave të së drejtës civile osmane, detyra e parë e të cilit në administratën osmane qe gjykatës feje (naip) për dy vjet e gjysmë në kazanë e Përmetit. Ai i shkroi sulltanit një raport në lidhje me sanxhakun e Shkodrës, gjatë punës së tij inspektuese aty, me rastin e kryengritjes popullore ndaj valiut të Shkodrës, Osman Mazhar pasha. Raporti nuk mban datën kur është hartuar, por dimë se Xhevdet pasha erdhi në Shkodër në vitin 1861. Raporti përmban 39 faqe dhe është ndarë në tema të ndryshme nga vetë autori. Temat që preken në të janë: Shqipëria dhe ndarja gegë e toskë, malësorët, myslimanizmi i malësorëve të malësisë Karaxha, që varej nga kazaja e Pukës, fiset e bajraktarëve, çështja e Malit të Zi, dërgimi i Xhevdet pashës si emisar fuqiplotë në Shkodër, zakonet e fiseve të Shalës, gjakmarrja në Shkodër, popullsia e Shkodrës, sulmet dhe provokimet e malazezëve, Bib Dod pasha, bashkëpunimi mes myslimanëve dhe të krishterëve në Shkodër, ndërtimi i xhamive dhe i shkollave në zonat malore të Shkodrës, ndryshimet që ndodhën në vilajetin e Shkodrës pas kongresit të Berlinit.

Teksa flet mbi mirëkuptimin që ekziston mes të krishterëve dhe myslimanëve shqiptarë, Xhevdet pasha i tregon me habi sulltanit se *“Mirëkuptimi dhe harmonia mes katolikëve dhe myslimanëve këtu në vilajetin e Shkodrës është diçka e paparë në ndonjë vend tjetër. Ata respektojnë njëri-tjetrin dhe shkojnë të gjithë së bashku në gëzime e në luftë. Katolikët*

mund të kenë një bajraktar mysliman që u prin, ndërsa myslimanët një bajraktar jo mysliman. Madje në fshatrat e përzierë myslimanët japin kontributin mujor për pagesën e priftit të fshatit, ashtu sikundër edhe katolikët japin kontributin mujor për të mbuluar pagesën e hoxhës së fshatit.”

Gjithashtu, gjejmë disa të dhëna edhe mbi lejet perandorake për ndërtimet e objekteve të kultit të krishterë, ose të shkollave e spitaleve të këtij komuniteti. Kështu, hasim dokumentin e lejes që i jepet më datë 18 gusht 1908 komunitetit ortodoks të fshatit të Shën Thanasit në Korçë, me qëllim ndërtimin e një spitali që do të kishte përmasat 31 x 20, 60 x 10 m dhe do të kushtonte 120.000 kurush, si dhe leja e vitit 1866 për ndërtimin e kishës katolike në Vlorë. Ka të dhëna edhe për ndërtimin e xhamisë në lagjen Navaricë të Delvinës, pas kërkesës së bërë nga kadiu i Delvinës më datë 5 qershor 1675, të dhëna për caktimin e një lexuesi të xhuzit amme në xhaminë e sulltan Bajezitit në Shkodër në vitin 1692, caktimin e një hatipi në xhaminë e fshatit Bajrak të Krujës në vitin 1705, caktimin e një myezini për xhaminë e Hasan Tatovës në Tiranë në vitin 1841. Në botim është përfshirë edhe dokumenti që tregon për ndihmën monetare prej 75 mijë kurush që ka dhënë sulltani për përfundimin e ndërtimit të kishës katedrale në Shkodër.

Nuk ka dyshim se dokumentet e botuara janë vetëm një pikë ujë nga fondi i pasur që ndodhet në arkivin osman në Stamboll. Botimi tematik i këtij dokumentacioni do të hedhë dritë mbi shumë çaste dhe aspekte të historisë së trevave shqiptare e kombit shqiptar gjatë sundimit pesëshekullor osman.



Sa mund ta dojë nëna fëmijën e saj?

Cila është lidhja që ekziston mes nënës dhe fëmijës?

Po paraqesim dy histori që u jep përgjigje këtyre pyetjeve. Në Indi vdes një nënë, e cila lë pas disa fëmijë. Pas pak kohe, babai detyrohet të martohet me një grua, e cila duhej kujdesej për fëmijët jetimë, megjithëse ai frikësohej se mos njerka nuk do të kujdesej siç duhet ndaj fëmijëve. Babai i kërkoi njerkes që mos i keqtrajtonte fëmijët, vetëm në rastet kur mund të krijoheshin ndonjë situatë ku ajo do të duhej të nevríkosej medoemos, i dha në dorë një copë kockë që t'i godiste fëmijët me të.

Ditët e para njerka u mundua të tregohej e drejtë me fëmijët, por kur solli në jetë fëmijët e saj, fëmijët jetimë iu rënduan aq shumë, sa që nuk arrinte të kishte më durim. Sa herë që nevríkosej, i godiste me copën e kockës që i kishte dhënë i shoqi. Koha kalonte, vitet ecnin dhe, ndërsa fëmijët jetimë rriteshin të shëndetshëm e të fortë, fëmijët e njerkes rriteshin të dobët e të pafuqishëm.

Njerka filloi të dyshonte nëse pas kësaj ngjarjeje fshihet diçka, ndaj dhe e pyeti të shoqin.

- A ka ndonjë domethënie kocka?

- Ajo copë kocke që të kam dhënë është nga trupi i nënës së tyre. Kur ti i bërtisje ata mërziteshin, por kur ti fillove t'i godisje me atë kockë ata nisën ta ndjenin nënën e tyre pranë e nuk mërziteshin; rriteshin të shëndetshëm e të sigurt në vetvete. Edhe pse trupi ndjente dhembje, shpirti u qetësohej.

Ndoshta kjo që tregova është vetëm një trillim, por ajo çfarë kam përjetuar në vendin ku jetoj, në Azerbajxhan, është një histori e vërtetë:

Në një qytet të Azerbajxhanit, një nënë në moshë të re preket nga një sëmundje shumë e rëndë. Mushkëritë i shkrihen dhe vdekja i troket shumë shpejt. Gjatë tërë kohës kur ajo kishte qenë e sëmurë, për të ishte kujdesur e motra, e cila tregon amanetin e saj: "E di se kujdesja ndaj fëmijëve është shumë e vështirë, kërkon durim të madh, por kur të të humbasë durimi, të lutem merre këtë shami timen, mbështille në dorë e pastaj goditi..."

E motra fillimisht e kundërshtoi zbatimin e një dënimi të tillë, duke thënë se nuk do mund ta godiste apo ta dënonte nipin e saj. Megjithatë, nëna këmbënguli në amanetin e saj.

Kaluan shumë vite pas vdekjes së nënës së re. Tezja përkujdesej çdo ditë për nipin e vet, tregohej e ëmbël, e butë, e dashur, por një ditë ndodhi që iu sos durimi e i dha fëmijës një shuplakë në fytyrë.

Fillimisht fëmija u çudit, pastaj filloi të qante, ndërsa më pas foli:

-A e harrove amanetin e nënës sime?

Tezja u pendua aq shumë, sa që u betua se nuk do ta godiste kurrë më nipin e saj. Nëse fëmija do goditej nga një dorë e mbështjellë me shaminë e nënës, ndoshta nuk do e ndjente dhimbjen e shuplakës. Mbase nëna dëshironte t'i fshinte lotët e fëmijës me shaminë e saj. Kush e di! Por amaneti i nënës vazhdonte të mbështilte me dashuri fëmijën e saj edhe pse tashmë ajo ishte nën dhe...



H.z. Zejnebi -2-

Kjo ndarje ndikoi shumë në gjendjen shpirtërore të H.z. Zejnebit. Ajo mërzhitej gjithnjë për faktin se ishte martuar me një politeist, por nuk kishte ndonjë rrugëzgjidhje tjetër përveç durimit. Me duart e ngritura lart, ajo iu dorëzua Allahut duke u lutur për udhëzimin e bashkëshortit të saj.

Një vit pas hixhretit, politeistët u mblodhën në Medine dhe vendosën të bëjnë luftë të hapur kundër myslimanëve. Kështu u zhvillua lufta e Bedrit. Numri i ushtarëve myslimanë ishte shumë i vogël në krahasim me ushtrinë kundërshtare, por në radhët e ushtrisë myslimane do merrnin pjesë melekët dhe ndihma e Allahut (xh.sh). Kundrejt sinqeritetit, nijetit të pastër të ushtarëve myslimanë, ndihma e Allahut do kurorëzohej me fitore. Në radhët e robërve të luftës ishte edhe dhëndërrin e Profetit (s.a.v.s.) Ebul-Asi, i cili do fitonte lirinë në shkëmbim të premtimit që do i jepte Profetit (s.a.v.s.), se me të mbërritur në Meke do ta lejonte H.z. Zejnebin të shkonte pranë babait të saj.

H.z. Zejnebi mblodhi plaçkat dhe para se të nisej për rrugë vizitoi varrin e nënës së saj të nderuar, H.z. Hatixhes. U nis për në Medine me djalin e tezes, Kinanen dhe me vajzën e saj Umame, ndërkohë që ishte edhe shtatzënë.

“Sikur të mos i kisha dhënë fjalën babait tënd nuk do isha ndarë kurrë prej teje” ishin fjalët e fundit të Ebul-Asit drejtuar H.z. Zejnebit, i dënuar nga fakti që nuk ishte nderuar akoma me Islam.

Me të marrë lajmin e largimit të vajzës së Profetit (s.a.v.s.), politeistët dolën në rrugë për ta ndaluar. E sulmuan dhe e rrëzuan H.z. Zejnebin nga deveja, duke i shkakuar dëmtime të mëdha, të cilat do i kushtonin shumë. Ndërsa vazhdonte rrugën, nga njëra anë mendonte për plagët e marra, ndërsa nga ana tjetër nuk i hiqej nga mendja momenti i ndarjes me Ebul-Asin, tek

i cili për 16 vite me radhë kishte mbizotëruar dashuria, mëshira dhe mirësia. Prandaj, zemra e Zejnebit bënte gjithnjë dua për udhëzimin e tij.

Pas një udhëtimi të mundimshëm, H.z. Zejnebi do kishte nderin të takohej me babain e saj dhe me myslimanët e tjerë. Ndërsa H.z. Zejnebi jetonte e qetë me familjen e saj, Ebul-Asi po kalonte ditë të vështira. Në vitin e 6 hixhri, teksa kthehej nga Damasku me karvanin e tij tregtar, ai u sulmua dhe u detyrua të dorëzohej. I gjithë karvani u dërgua për në Medine. Me të lajmëruar Profetin për gjendjen e karvanit të Ebul-Asi, tregtarët dhe mallrat e tij u morën nën mbrojtje. Një veprim i tillë nga ana e Profetit, ia ngrohu edhe më shumë zemrën Ebul-Asit në lidhje me afrimin ndaj islamit. Gjithë mallrat iu dorëzuan sërish karvanit, që u nis drejt Medines me në krye Ebul-Asin, i cili tashmë e kish pranuar islamin, por nuk e kishte deklaruar akoma. Mendja dhe zemra i kishte mbetur në Medine. Pasi i shpërndau të gjithë mallrat, ai e shpalli haptazi faktin që ishte nderuar me Islam. Mblodhi plaçkat dhe menjëherë u nis për në Medine. Nga njëra anë ndjente mall për Profetin (s.a.v.s.), ndërsa nga ana tjetër ndjente mall për gruan e tij të nderuar, H.z. Zejnebin. Me të mbërritur në Medine, ai u drejtua menjëherë në Mesxhidin Nebevi (xhamia e Profetit), takoi Profetin e mëshirës dhe deklaroi fjalën e shehadeetit. Nga ana e tij, Profeti (s.a.v.s.) e ripërtëriu nikahun (martesën) e tij me H.z. Zejnebin, kështu mërzitjet, sprovat dhe vështirësitë iu shndërruan në gëzim e lumturi. Por kjo lumturi nuk zgjati shumë, sepse pas 1 viti, H.z. Zejnebi, e cila nuk ishte më shumë se 30 vjeç, do t’ia dorëzonte shpirtin Krijuesit të gjithësisë.

Në emër të besimit dhe përkushtimit të saj në islamin, H.z. Zejnebi u bë simbol i durimit e rezistencës, si dhe shembull i pashoq për gjithë gratë myslimane. Allahu e nderoftë me xhenet. AMIN!



Mosha e vërtetë e trupit, e ndryshme me atë të jetës sonë

Trupi ynë ka moshën e vet, shumë të ndryshme nga ajo që është e matur me vite në mënyrë kronologjike për jetën tonë në tërësi.

Secili prej nesh mund të thotë se trupi i tij ka një moshë jo më shumë se pesëmbëdhjetë vjet dhe kjo, për shkak se qelizat që e përbëjnë atë, kanë një cikël të jetës që përmban ndarjen, rigjenerimin, vdekjen dhe zëvendësimin nga të tjerat.

Çdo lloj qelize ka një kohëzgjatje të ndryshme, e kështu edhe mosha të ndryshme.

Kështu, qelizat e kockave tona mund të kenë 4-5 vjet jetë, ato të lëkurës mund të kenë rilindur dhe kanë vetëm disa ditë të jetës, pra ato nuk kanë të bëjnë me moshën e vërtetuar nga karta e identitetit.


Për shembull, qelizat e stomakut vdesin dhe janë zëvendësuar çdo pesë ditë apo më shumë, duke qenë në kontakt me acide të nevojshme për tretje konsumi të shpejtë.

Çdo qelizë e lëkurës sonë ka një jetë mesatare prej një jave, qelizat e mëlçisë formimin e zgjatin

për pesë muaj, rreth katër muaj qelizat e kuqe të gjakut etj.

Ndërsa qelizat e tjera kanë një jetë shumë të gjatë, për shembull një rimodelim i kockave i zëvendëson të gjitha qelizat e saj në dhjetë vjet.

Në trupin e çdo njeriu ka rreth dhjetë trilion qeliza dhe i bie që mosha mesatare e trupit të njeriut të jetë pikërisht në mes të njëmbëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë viteve.




Cikli gjumë-zgjim luan rol në zhvillimin e Alzheimerit

Tek njerëzit që nuk flenë sa duhet ka gjasa të shtohet rreziku i prekjes nga sëmundja e Alzheimerit, thuhet në një studim të ri. Shkencëtarët arrihen në përfundimin se cikli gjumë – zgjim mund të luajë rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj sëmundjeje neurologjike që shoqërohet me humbjen e kujtesës.

Një nga shenjat kryesore të Alzheimerit është formimi në tru i pllakëzave amyloide që e bëjnë trurin të paafte për të funksionuar. Këto pllakëza formohen nga akumulime toksike të copëzave amyloide beta, lloj proteine që ndihmon funksionin e trurit.

Shkencëtarët në universitetin Uashington në



Saint Luis, në Misuri, gjetën të dhëna të reja se nivelet e këtyre copëzave të quajtura “peptide” ndikohen nga sasia e gjumit. Ata matën nivelet e proteinës amyloid beta dhe zbuluan se përqendrimet e pllakëzave peptideve janë më të larta kur njerëzit shpenzojnë më shumë kohë zgjuar sesa në gjumë.


Drejtori i departamentit të Neurologjisë, doktor David Holzman, thotë se kjo gjendje duket se kushtëzohet me shtimin e veprimtarisë së trurit dhe shpjegon përse niveli i peptideve është më i

lartë gjatë kohës kur njeriu është zgjuar sesa kur është në gjumë.

Shkencëtarët zbuluan se minjtë në laborator që mbaheshin pa gjumë treguan një rritje prej 25 për qind të nivelit të proteinës amyloide. Këto të dhëna, i bëjnë shkencëtarët të mendojnë se njerëzit që vuajnë nga ndërprerja e gjumit, e njohur si apnea, janë në rrezik më të lartë për t’u prekur nga sëmundja e Alzheimerit, sepse truri i tyre nuk çlodhet sa duhet.

Në kocka gjendet sekreti i sëmundjes së diabetit

Në kockë mund të gjendet zgjidhja për diabetin, sëmundja e shekullit, e cila së bashku me Obezitetin, është e shtrirë më shumë në vendet e pasura. Një proteinë e rëndësishme që shërben për të rregulluar qarkullimin e indeve kockore (për të zëvendësuar indin e përdorur me një të ri) ndihmon në kontrollin e glicemisë. Kështu kockat mund të kenë një rol në zhvillimin e diabetit. Lajmi është publikuar në revistën e Columbia University Medical Center.





I-Care mobile, pajisja që do të mbrojë fëmijët nga celularët



Quhet ICareMobile dhe është një aparaturë, e cila do të mbrojë të miturit nga përdorimi i telefonave ce-

lularë.

Projektuar nga Këshilli Kombëtar i Kërkimit që ndër të tjera ofron: bllokimin e mesazheve me përmbajtje të përshtatshme për fëmijët, kontrollin mbi video dhe foto të postuara online me sistemin e telefonit celular dhe një sistem. Ky i fundit, do të arrijë të bëjë të mundur gjetjen e këtij aparati që mund të jetë vjedhur ose të ketë humbur.

Ai është i pajisur nga një filtër që bën të mundur kontrollin e programeve që konsiderohen si “të rrezikshëm”.


Letër antibakteriale prej grafeni për të mbrojtur ushqimet

Në të ardhmen një letër antibakteriale prej grafeni, vdekjeprurëse për bakteret, por e padëmshme për njerëzit, mund të përdoret për të ruajtur ushqimet dhe ndoshta edhe për ti bërë këmbët më të pastra. Kjo sugjerohet nga një studim në Chinese Academy of Sciences (Shangai, Kinë) i drejtuar nga profesor Chunhai Fan dhe botuar në “ACS Nano”.

Materiali i letrës së re është përgatitur duke përdorur grafen, një shtresë e hollë karboni që është testuar për përdorime të ndryshme (sidomos për elementet diellorë, si dhe në fushën e informatikës (kompjuterët dhe censorët).

Ekipi i Akademisë kineze ka kërkuar të provojë efektet e saj edhe në organizmat e gjallë.

Për këtë qëllim, studiuesit kanë përgatitur fletë grafeni, të cilat u vendosën në sipërfaqe të qelizave të nje-



riut dhe baktereve. Nga studimi është vërejtur se bakteret nuk ishin në gjendje të rriteshin, ndërsa qelizat e njeriut kanë lulëzuar, me pak efekte anësore.


Studiuesit besojnë se karta antibakteriale mund të përdoret për të ruajtur ushqimin dhe shmangur depërtimin e baktereve. Gjithashtu, mund të përdoret në këpucë, për të hequr erën e keqe, shkaktuar nga bakteret në këmbë.

Mijëra dosje sekrete të luftës në Afganistan publikohen në Internet

Themeluesi i “Wikileaks”, sajti i internetit ku janë botuar 92 mijë dokumente që sjellin një tjetër panoramë të luftës në Afganistan, ka deklaruar se dokumentet mund të përmbajnë fakte për kryerjen e krimeve të luftës. Julian Assange tha se materiali ushtarak flet për mijëra krime që mund të jenë kryer në Afganistan. Në një konferencë për shtyp që dha në Londër, ai deklaroi se “është në dorë të gjykatave për të vlerësuar nëse ka apo jo dokumente që mund të cilësohen si krime. Ajo që do të donim, është që i gjithë materiali i botuar të merret në konsideratë në mënyrë shumë serioze, të hetohet nga qeveri të ndryshme dhe politika të reja të hartohen si pasojë”, ka deklaruar Julian. Ndër të tjera, ai tha se kishte edhe rreth 15 dokumente të tjera dhe premtoi se do t'i publikonte edhe ato shumë shpejt gjatë javëve në vazhdim. Sipas tij, vendimet duhet të merreshin edhe në lidhje me ndikimin dhe impaktin e mundshëm që do të kishin materialet ndaj sigurisë. Ai kundërshtoi edhe pretendimet e administratës amerikane, sipas të cilave materialet do të vinin në rrezik jetën e ushtarëve. “Ne jemi mësuar tashmë me grupe, të cilave u kemi publikuar abuzimet që kanë kryer dhe bëhet fjalë gjithmonë për reagime që kërkojnë t’ia tërheqin vëmendjen publikut nga thelbi i mesazhit. Edhe në këtë rast nuk shohim asnjë ndryshim mes reagimit të Shtëpisë së Bardhë dhe grupeve të tjera që ua kemi nxjerrë të palarat. Ndërkaq, mund të them se jemi përpjekur të sigurohemi për materialet që kemi publikuar, në mënyrë që ato të mos shkaktojnë ndonjë dëm. Të gjitha materialet janë 7 muaj të vjetër dhe nuk kanë pasoja operationale në terren”, ka deklaruar krijuesi i sajtit dhe njeriu që është vënë në qendër të vëmendjes së shumë shteteve dhe interesave. Ndërkaq, dje Pentagoni është përpjekur të bëjë një vlerësim të dëmit që ka shkakuar publikimi i materialeve. Sipas një zëdhënësi të Pentagonit, do

Wikileaks Afghanistan files: download the key incidents as a spreadsheet
Key incidents from the Wikileaks Afghanistan war logs selected by Guardian writers. As a spreadsheet, with co-ordinates

- [Get this data](#)
- **INTERACTIVE:** [These key incidents mapped](#)
- [Glossary of military terms](#)
- [How our datajournalism project worked](#)



Key incidents from the Wikileaks Afghanistan data mapped

It must be one of the biggest leaks in intelligence history. An archive of almost 90,000 files has come to light thanks to Wikileaks, logging the history of the war in Afghanistan, practically blow-by-blow. We've trawled through these incidents to help you make sense of the key events.

We have reproduced full military logs behind more than 200 of the key events from the database – you can navigate around them. But if you want to download this data to play with it yourself, this is the place to come.

të duhen praktikisht ditë apo edhe javë për të parë të gjitha dokumentet dhe për të vendosur në lidhje me dëmin potencial që u shkaktojnë ato ditëve të ushtarëve që janë në Afganistan. Ndërkaq, Pentagoni nuk ka pranuar që të deklarohet në lidhje me përmbajtjen e materialeve, por ka bërë të ditur se është duke hetuar në lidhje me personat e mundshëm që mund ta kenë bërë të mundur rrjedhjen e këtij informacioni. Pronari i sajtit që publikoi materialet e krahasoi këtë akt me hapjen e arkivave të shërbimit sekret STASI në Gjermaninë Lindore.